

**UNIVERSITETI I SHKODRËS**  
**“Luigj Gurakuqi”**

**BULETIN SHKENCOR**

**Seria e shkencave shoqërore**

**Viti LXXIV i botimit**

**Nr. 74**

Shkodër, 2024

## **REDAKSIA**

*Kryeredaktor : prof. dr. Artan HAXHI*  
*Anëtarë : prof. dr. Nertila LJARJA, prof. as. dr. Arben PRENDI,*  
*prof. as. dr. Orjeta BAJA, dr. Bresena KOPLIKU,*  
*prof. as. dr. Edlira BUSHATI*  
*Sekretar shkencor : dr. Zamira SHKRELI*

**DREJTOR I REVISTËS**  
*Prof. dr. Tonin GJURAJ*

**Korrektori dhe punoi në kompjuter: Arta Bajrami**

---

***Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”***

---

Adresa e redaksisë:      Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”  
Redaksia e revistës “*Buletin shkencor*”  
(seria e shkencave shoqërore)  
E-mail : qsa@unishk.edu.al

## PASQYRA E LËNDËS

### • Gjuhësi

**Artan HAXHI, Tefë TOPALLI**

Terminologjia si sistem

*Terminology as a sistem*

*(Dictionary of linguistic terms)*.....5

**Orjeta BAJA**

Figurat e stilit

*The figures of the style*.....21

**Valbona SINANAJ, Zamira SHKRELI**

Rëndësia e moshës në përvetësimin e gjuhës

*The importance of age in language acquisition*.....27

**Karmen LAZRI**

Përkthyesi si ndërmjetës etik në epokën e inteligjencës artificiale:

qasje, përgjegjësi në praktikat dhe teoritë bashkëkohore të përkthimit

*The translator as an ethical mediator in the age of artificial intelligence:*

*approaches and responsibilities in contemporary translation practices*

*and theories*.....35

### • Letërsi

**Behar GJOKA**

Pjetër Budi – përkthyes, përshtatës apo poet?

*Pjetër Budi – translator, adapter or poet?*.....49

**Vilma PROKO - JAZEXHIU**

Fjalë të urta nga areali arbëresh

*Proverbs from the Arbëresh area*.....63

**Valjeta GJYLBEGAJ**

Shkodra në shënimet e disa autorëve

*Shkodra in the notes of some authors*.....75

**Andreas DUSHI, Gjovalin SHKURTAJ**

Marcia, romani i parë në gjuhën shqipe

*Marcia, the first novel in the Albanian language*.....87

• **Histori**

**Sereta KOPERAJ, Bendis KRAJA**

Lëvizja kaçake gjatë Luftës së Parë Botërore (në vitet 1916-1918).

Lufta dhe diplomacia me austro-hungarezët

*The Kaçak movement of Azem Galica during the First World War (in the years 1916-1918). War and diplomacy with the Austro-Hungarians*.....97

• **Gjeografi**

**Sokol AXHEMI**

Lëvizjet migruese dhe dinamika e zhvillimit të zonave rurale në Shqipëri.

*Migratory movements and the dynamics of development of rural areas in*

*Albania*..105.....105

**JETA SHKENCORE:**

I Veprimtari shkencore

*Scientific activity*.....117

II Botime

*Publishing*.....125

III Gradat dhe tituj e fituar

*Degrees and titles earned* .....127

Artan HAXHI  
Tefë TOPALLI

## TERMINOLOGJIA SI SISTEM

(Fjalor i termave të gjuhësisë)

(vijon)

### *analitike*

**Analitike** quhet ajo gjuhë në të cilën çdo fjalë përbëhet vetëm nga një morfemë. Një përkufizimi të tillë sipas modelit ideal i afrohet vetëm gjuha vietnameze, në të cilën p.sh. në sistemin përemëror ndryshimi i numrit nga njëjës në shumës i është besuar një fjale autonome dhe të pandryshueshme (*chúng*) dhe jo një morfemë të veçantë: kështu, gjejmë *tôi* (unë) dhe *chúng tôi* (ne).

Gjuhët që paraqesin forma leksikore të përbëra nga më shumë se një morfemë (si gjuhët e vjetra indoevropiane) janë në mënyrë të dukshme larg këtij tipi morfologjik. Ato quhen gjuhë sintetike, p.sh. në një fjalë në greqisht, si *ánthropos* dallohen lehtësisht katër morfema: një morfemë leksikore (e përfaqësuar nga rrënja *ánthrop* - “njeri”) dhe tri morfema gramatikore të shprehura nga mbaresa *-os*, që tregojnë në të njëjtën kohë rasën (emërore), numrin (njëjës), gjininë (mashkullore).

Klasifikimi tipologjik i gjuhëve natyrore në bazë të parametrave morfologjikë realizohet nëpërmjet vendosjes së gjuhëve sipas një shkalle në ekstremet e së cilës gjenden gjuhët *analitike* dhe ato sintetike. Asnjë gjuhë nuk mishëron saktësisht njërin apo tjetrin tip në mënyrë të pastër. Shpesh parametra të veçantë gjenden të kombinuar në strukturën morfologjike të të njëjtit sistem gjuhësor. Kështu, gjuha shqipe nga ana strukturore sot paraqitet si një gjuhë sintetiko-analitike, me një mbizotërim të tipareve sintetike dhe me prirje drejt analitizmit. Prirja për thjeshtimin e sistemit gramatikor me anë të krijimit të formave analitike e ka shndërruar shqipen nga një gjuhë sintetike, ku rolin kryesor e luanin format me mbaresa, në një gjuhë sintetiko-analitike, ku një rol të rëndësishëm luajnë format gramatikore analitike, të cilat përbëhen nga dy a më shumë elemente, që janë të ndarë nga njëri tjetri, por funksionojnë si një formë e vetme gramatikore (p.sh. tek folja format kohore të kryera, format e pashtjelluara të foljes, mbiemrat e nyjshëm etj.).

### *analog*

Janë klasifikuar si **analoge** ato gjuhë që rendin e fjalëve e kishin relativisht fiks, si p.sh. frëngjishtja. Kjo ishte një analogji me atë që ata besonin se

ishte rendi logjik.

### *analogji*

**Analogji** (nga greq. ἀναλογία - *analogía* “përpjesëtim”) është një term, i cili në traditën e gramatikës perëndimore nënkuptonte marrëdhënie të ngjashmërisë dhe të korrespondencës ndërmjet elementeve që bashkëndajnë disa tipare. Termi *analogji* përcakton procesin diakronik përmes të cilit një fjalë ndryshon formë në pikëpamje fonologjike dhe morfologjike, për t'u bërë më shumë e ngjashme me një fjalë tjetër tashmë e pranishme në gjuhë. *Analogjia* është një proces, i cili në rrjedhën e historisë së një gjuhe redukton gradualisht disa forma që fillojnë të ndjehen si të parregullta dhe i riformulon ato sipas modelit më të zakonshëm (atij që konsiderohet si “*i rregullt*”). Ajo vepron në fusha të ndryshme të gjuhësisë, duke filluar nga fonetika e deri tek gramatika. *Analogjia* është një prirje e zakonshme në gjuhët natyrore. Ajo është përgjegjëse për rregullimin e fleksionit foljor dhe të atij emëror. Përmes saj mënjanohej ato forma që përputhen me modele flektive që nuk përdoren, duke i zëvendësuar me të tjera që ndjehen më shprehëse dhe më të rregullta.

*Analogjia* ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në evolucionin e strukturës morfologjike në gjuhën shqipe. Në fushën e eptimit ajo ka bërë që të rrafshohen mjaft dallime formale në bazë të një gjedheje, e cila, ose për shkak të dendurisë së përdorimit të saj, ose për shkak të aftësisë shprehëse, ka ushtruar një ndikim rrafshues (përngjasues) mbi një apo disa forma të së njëjtës paradigme ose të një paradigme tjetër të ngjashme me atë të gjedhes vepruese. Kështu, p.sh., mënjanimi i formës së rrjedhores së shquar e të pashquar të tipit *male-sh-it*, *male-sh* nga forma e dhanores *male-ve-t*, përkatësisht *male-ve*, i detyrohet veprimi rrafshues të analogjisë brenda së njëjtës paradigme<sup>1</sup>.

### *analogjik*

Quhet ndryshim **analogjik** ai evolucion i gjuhës, i cili mund të shpjgohet me anë të fenomenit të analogjisë. P.sh. në gjuhën shqipe shtimi i mbaresës rasore *-je*, përkatësisht *-ve*, *-sh*, të format përemërore *me-je*, *te-je*, *so-je*, përkatësisht *ne-ve*, *ne-sh*, *ju-ve*, *ju-sh*, *kësi-sh*, *këso-sh* etj. i detyrohet veprimi rrafshues të formave rasore gjegjëse të emrave, d.m.th. veprimi të një klase tjetër fjalësh, që kuptimisht dhe gramatikisht kanë pika takimi me përemrat vetorë e dëftorë.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Demiraj, Sh. (1985), *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, “8 Nëntori”, Tiranë, fq. 77.

<sup>2</sup> Demiraj, Sh. (1985), *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, “8 Nëntori”, Tiranë, fq. 77.

***analogjistët***

**Analogjistët** janë dijetarë që ndjekin metodën analogjike. Termi lidhet kryesisht me gramatikanët grekë të shkollës së Aleksandrisë (Aristofani i Bizantit, Aristarku i Samotrakës etj.), të cilët pretendonin për një shkrimje të përsosur të formave gramatikore me format logjike të mendimit, pra, uniformitetin e formave për të njëjtat kategori, rregullsinë, qëndrueshmërinë (koherencën) dhe simetrinë e tyre në gjuhë.

***anaptiks***

**Anaptiks** (nga greq. ἀνάπτυξις - *anaptyxis*, “shpalos”), ndryshe edhe tingull shtesë, është dukuria e ndërftjes së një zanoreje midis bashkëtingëlloreve, me qëllim që ta bëjë një fjalë të shqiptohet më lehtë, por pa i ndërruar kuptimin.

***anaptitik***

Vështirësia që krijohet nga ndeshja e bashkëtingëlloreve gjatë eptimit të një fjale mund të shmanget me ndërftjen e një zanoreje, që është quajtur zanore **anaptitike**. Zanorja e shtuar në këtë rast luan të njëjtin rol si bashkëtingëlloret që zhdukin hiatin. Në gjuhën shqipe fonemat që përdoren për këtë qëllim, janë zanoret -ë- dhe -i-. Kjo e fundit, në të njëjtat kushte si tek emrat, ashtu edhe tek foljet këmbëhet me zanoren -u-.<sup>3</sup>

***anartri***

**Anartri** (nga greqishtja e vjetër ἀναρθρία - *anarthria*, “dobësim, zbutje”), ndryshe edhe *keqnyjtim* ose *dizartri*, janë disa raste të deficiteve gjuhësore, që vijnë si rezultat i dëmtimit në mënyrë të izoluar të një procesi të trurit, siç është rasti i dëmtimit të programimit motor të artikulimit. Anarthria e pastër shpesh quhet edhe *sindromë e shpërbërjes fonetike*.

Veçantia e këtij çrregullimi është se ajo shoqërohet nga të kuptuarit e plotë të prodhimit gojor ose atij me shkrim, ndërsa rezulton i komprometuar prodhimi gojor i çdo lloji (bisedë spontane, emërtim, përsëritje, lexim me zë të lartë).

Anartri është edhe emërtimi që i jepet *afazisë së shprehjes*, i karakterizuar nga një çrregullim në realizimin e fonemave dhe në vazhdimësinë e tyre.

***anasjellë***

**Anasjellë** (ndryshe edhe *inversion* apo *anastrofë*), është dukuria e ndryshimit të rendit të zakonshëm të fjalëve në fjali për të theksuar

<sup>3</sup> Topalli, K. (2007), *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, “Dituria”, Tiranë, fq. 220.

kuptimin e një fjale ose për t'i dhënë fjalisë forcë më të madhe shprehëse. *Anasjella* është dukuri gjuhësore ku një rend i pritshëm i fjalëve, i zakonshëm ose i konsideruar si normal, është zëvendësuar nga një rend tjetër. Pra, kemi të bëjmë me një ndërtim të anasjellë, mbasi ai përftohet nga përmbysja e rendit normal të elementeve të një fjalie me qëllim arritjen e efekteve të veçanta shprehëse. Është i përdorur sidomos në poezi. Kështu, kallëzuesi mund të dalë para kryefjalës, përcaktori para fjalës së përcaktuar etj., p.sh.:

*Gjithmonë e dashur për mua ishte kjo kodër e vetmuar  
I natyrës gazmend shihej*

N. Mjeda "Vorri i Skanderbegut"

Në fjalinë *I lartë është mali*, kemi përmbysje emfatike të rendit të gjymtyrëve të fjalisë. Kjo ndodh për shkak të kërkesës për shprehësi, ndërkohë që rendi i zakonshëm, stilistikisht asnjës, do të ishte *Mali është i lartë*. Njihet gjithashtu edhe përmbysja e rendit të përemrit të përdorur si kryefjalë në fjali (subjekti pas foljes), në rastet kur një fjali dëftore kthehet në fjali pyetëse:

*Ai vjen.*

*Vjen ai ?*

#### ***anastrofë***

**Anastrofë** (nga greq. ἀναστροφική - anastrofhē, "përmbysje") ose *antepozicion* është një figurë e retorikës që ka të bëjë me përmbysjen e rendit të zakonshëm sintaksor të një ose më shumë fjalëve në periudhë. P.sh. :

*Me të madhe shpejtësi vraponte.*

*Një ndihmesë e madhe ishte këshilla e tij.*

#### ***andronim***

Andronim (nga greq. ανδρωνύμιο) - andronym(io), "pseudonim, nofkë") është emri i një gruaje që rrjedh nga emri ose mbiemri i bashkëshortit të saj ose mbiemri i formuar nga emri i burrit (Matzouranaina: gruaja e Matzouranit etj.). Kjo është një dukuri që ndeshet edhe në gjuhën shqipe.

#### ***aneksim***

**Aneksim** (nga latinishtja e vonë *annexiōne*) është dukuria e ndajngjitjes ose e të shtuarit e një elementi në një tërësi (grup).

1. *Aneksimi* është një formë morfologjike e emrit në gramatikën e disa gjuhëve afro-aziatike, veçanërisht në disa prej degëve të saj, si: në gjuhët semite (sidomos në arabishte dhe hebraishte), në gjuhët



berbere dhe në gjuhën e lashtë egjiptiane. Në gjuhët semite emri e merr këtë formë kur është i ndjekur nga një plotës, pra, gjendet automatikisht i përcaktuar. Në gramatikën arabe aneksimi është quajtur *al-'idāfah* (الإضافة - “*duke shtuar*”). Ai mund të konsiderohet si një nga tri gjendjet e mundshme të përcaktimit të emrit, dy të tjerat janë i pacaktuar dhe i caktuar.

2. *Aneksimi* quhet ndryshe edhe *adjunksion* (*shih adjunksioni*). Është një figurë e retorikës që ka të bëjë me vendosjen e një foljeje në krye ose në fund të të çdo fjalie në një periudhe me shumë pjesë. Është dukuri e përfutur gjatë evolucionit të një gjuhe dhe vjen kryesisht si pasojë e ndikimit nga gjuhët e huaja.

#### *anësor*

**Anësore** quhet një bashkëtingëllore mbylltore (oklusive), për artikulimin e së cilës kontakti ndërmjet organit aktiv (zakonisht gjuha) dhe organit pasiv (dhëmbët ose qiellza) bën që ajri në zgavrën e gojës të shmanget në njërin anë (i njëanshëm) ose në të dyja anët (i dyanshëm) e vendit ku është krijuar pengesa, duke krijuar një zhurmë të dobët të shkaktuar nga fërkimi i ajrit kundrejt mureve anësore të gojës.

Zakonisht, bashkëtingëlloret anësore janë të zëshme, por mund të kenë edhe korrespondente të shurdhëta, të cilat karakterizohen nga një lloj turbullire (turbolence), ndaj ata janë klasifikuar shpesh si tinguj fërkimorë (frikativë).

Ato mund të paraqiten edhe si alofone (të shpeshta në gjuhë të caktuara pas mbylltoreve të shurdhëra, të treguara në transkriptim me anë shenjave të veçanta diakritike, dmth [l̥]; shurdhim) ose si fonema autonome (të transkriptuara si [l]); por paraqiten edhe si një fakt patologjik, në subjekte që vuajnë nga e ashtuquajtura "kockë". Në gjuhën shqipe *l* dhe *ll* janë bashkëtingëllore anësore.

#### *anglicizëm*

**Anglicizëm** quhet një term, shprehje apo konstrukt i gjuhës angleze, që ka hyrë në një gjuhë tjetër qoftë në formën origjinale (*lider* për *udhëheqës*), qoftë i përshtatur (*tramvaj*). Gjithashtu, mund të jetë edhe një fjalë e përdorur me domethënie që ka në anglisht (*leksion* nga *lecture*).

#### *anketë*

**Anketa** gjuhësore është mbledhja e informacionit mbi prodhimet gjuhësore të një bashkësie, thënë ndryshe, tërësia e procedurave përmes së cilave gjuhëtari nxjerr nga folësit informacione gjuhësore, por edhe

jashtëgjuhësore, të cilat do të jenë objekt i analizës së tij dhe mbi bazën e së cilës do të arrihet në përfundime e përgjithësime. Ajo është rezultat i një procesi të gjerë që mund të përfshijë rrugë ose procedura të ndryshme.

### *ankorim*

**Ankorimi** (nga lat. *ancora*; “spirancë”) është procesi i krijimit të një ndjesie, e cila vjen si pasojë e një nxitjeje të brendshme. Me fjalë të tjera, ai është një stimul i aftë për të ndikuar në gjendjen mendore dhe emocionale të një personi.

*Ankorimi* realizohet duke shfrytëzuar një stimul ndijor të memorizuar për të çuar në një ndryshim të gjendjes shpirtërore. Në mënyrë të pandërgjegjshme çdo ditë ne krijojmë *ankorime* dhe i kuptojmë ato kur aktivizohen në mënyrë të pavullnetshme, duke nxjerrë në pah një ndjesi që evokon një përvojë të kaluar. Kur njohim një aromë, që dikur lidhej me një kujtim (qoftë i këndshëm apo jo) ose kur dëgjojmë një këngë etj., automatikisht aktivizohet kujtesa. Të gjithë këta janë shembuj të *ankorimit* të krijuar në trurin tonë në mënyrë spontane.

*Ankorimi* është një teknikë e rëndësishme e përdorur në shkollat e psikologjisë konstruktiviste përmes teorisë së programimit neuro-linguistik (PNL), e zhvilluar nga Richard Bandler dhe John Grinder.

### *anomali*

**Anomali** (nga gr. ἀνωμαλία - *anomalía*, “*anormale, jonormale*”) është një parregullsi apo mospërputhje me rregullin e përgjithshëm, me një strukturë a me një lloj që konsiderohet normal. Ai është një term i cili ka përdorime të ndryshme:

1. Tek gramatikanët **grekë të** shekullit II p.e.s., fjala *anomali* në përgjithësi paraqiste parregullsitë e gjuhës (e kundërta e *analogji*) dhe, në një kuptim më të gjerë, çdo punë që nuk mund të shpjegohet duke ndjekur rregullsi të një lloji të caktuar. Mbështetur te anomalia është krijuar teza anomalistëve, e cila argumentonte se në gjuhët natyrore rëndësia e përjashtimeve ishte më e fortë se ajo e rregullsive, pra, ***parregullsitë në marrëdhëniet ndërmjet elementeve gjuhësore i konsideruan si parim themelor të gjuhës.***
2. Në gjuhësinë moderne një frazë është quajtur *anomale* kur paraqet dallime përkundrejt rregullave të gjuhës.  
Për *anomali gramatikore* disa studiues përdorin më shumë termin agramatikalitet apo shkallë e gramatikalitetit, duke e përdorur termin *anomali* për të përshkruar devijimin semantik. Kështu, fraza *Ai dëgjon muzikë që shkëlqen në këpucët e saj* është kuptimisht (semantikisht) *anomale*, sepse subjekti që *shkëlqen* (në këtë rast *muzika*) duhet të ketë

karakteristika të veçanta (duhet të jetë në gjendje të marrë dhe të reflektojë dritën); prandaj ajo nuk është e interpretueshme veçse si një metaforë, domethënë, në modifikimin e tipareve semantike të foljes. Dallimi në mes *anomalisë* dhe agramatikalitetit ndryshon sipas teorive të ndryshme gjuhësore.

### *anomalist*

Në mesin e gramatikanëve grekë anomalistët, në dallim nga analogjistët, theksonin rëndësinë e parregullsive në gjuhë, duke vënë në dukje numrin e madh të tyre. Gramatika e konceptuar prej tyre në këtë mënyrë shihej para së gjithash si një tërësi përjashtimesh (kështu, për nyjen greke mashkullorja ishte *ho* dhe femërorja *hê*, por asnjani dilte *to*).

Për anomalistët gjuha nuk ishte produkt i një marrëveshjeje njerëzore, burim i rregullsisë, por më tepër i natyrës. Për këtë arsye, sipas tyre, në hartimin e gramatikave duhet të merret në konsideratë përdorimi i gjuhës, shumë më tepër se sa skemat logjike.

### *antecedent*

**Antecedent** (nga lat. *antecedere*; ante 'para' + *cedere* 'shko') në kuptimin *paraprijës*. Në gramatikën e përgjithshme një fjali në përbërje të frazës është antecedente (paraprijëse), kur ajo është e vendosur para pjesëve përbërëse të saj ose menjëherë pas pjesës që merret si bazë referimi. Ata janë mbi të gjitha fjali të varura, që vendosen para fjalisë drejtuese (kryesore). Kështu, në fraza të tilla, si : *Nëse ai vjen, ti do të ndjehesh më mirë*; fjalia e varur kushtore *Nëse ai vjen* është quajtur antecedente (pasi paraprin pasardhësen). Në gramatikë antecedent quhet edhe emri ose përemri që i paraprin një përemri lidhor dhe me të cilin lidhet, p.sh në frazën: *Ai nuk e ka pëlqyer filmin që i kisha këshilluar*, fjala *filmin* është antecedente (paraprijëse) e përemrit lidhor që.

### *anticipim*

**Anticipim** (nga lat. *anticipātiōn* “paragjykim, nocion i paramenduar”) në përgjithësi ka kuptimin *veprim i realizuar përpara një tjetri*.

1. Në fonetikë **anticipim** quhet veprimi regresiv i ushtruar nga një fonemë mbi një fonemë të mëparshme (sinonom me *asimilimin regresiv*); kështu, *p* e latinishtes tek *capsa* është asimiluar në *s* nga anticipimi i kësaj të fundit, duke dhënë *chasse* në frëngjisht.
2. Në gjuhësi (sinonom me *prolepsë*) **anticipimi** është një figurë retorike e tipit sintaksor, e cila ka të bëjë me paravendosjen e një gjymtyre të fjalisë apo të një pjese të periudhës ndaj një tjetre, në mënyrë që të

nxjerrë në pah atë fjalë apo atë fjali. Kjo ndodh p.sh., kur në një periudhë një fjali e varur vendoset para kryesores (drejtueses) me qëllim që ta theksojë atë. P.sh. *Ajo që doja të thoja është kjo, që ... ..* Fjalë e nënrenditur *që doja të thoja* paraprin kryesoren *është kjo*. Në këtë rast paravendosja bëhet për të theksuar atë që do të thuhet më pas. Po kështu edhe fjala “*kjo*” është në përdorim proleptik. Në vend që të përdorej *kjo* mënyrë të shprehuri mund të thuhej thjesht “*Doja të thoja që ...*”

### *anticipues*

**Anticipues** (nga lat. *anticipāre* “*parashikoj*”) përdoret në kuptimin paraprijës.

1. **Anticipues** (në kuptimin *paraprijës*) quhet një përemër kur luan rolin e një paraprijësi në një sintagmë emërore që do të realizohet menjëherë në të njëjtin kontekst ose frazë. Kështu, përemri pyetës luan rol anticipues në fjali: *Kush ka ardhur? Një mik*; Ai zëvendëson një sintagmë emërore, duke nënkuptuar një përgjigje që do të ishte një emër personi. Pra, sintagma emërore e përgjigjes është paraprirë kështu nga përemri pyetës *kush*.
2. Në fonologji, **anticipues** është asimilimi apo disimilimi i ushtruar nga një fonemë mbi një tjetër paraardhëse. P.sh. një asimilim regresiv ka ndodhur në latinisht tek fjala *summus* nga \**supmos*, (shih. *superior*); ose një disimilim regresiv në fjalën latine *meridies*, e cila zëvendësoi formën më të vjetër *medidies*.

### *antifrazë*

**Antifraza** (nga greq. ἀντί - antí, “*kundër*” dhe φράσις - frásis, “*shprehje*”) është një figurë e retorikës. Ajo mund të jetë një fjalë, një sintagmë apo një frazë që përdoret me një domethënie të kundërt nga ajo që ka në të vërtetë. Zakonisht shoqërohet me ndryshimin e intonacionit e të tonit të zërit. P. sh.:

*Ah, çfarë pune të madhe keni bërë.*

Kjo shprehje e shqiptuar me një ton dhe intonacion të veçantë mund të thotë edhe të kundërtën e asaj që shpreh në të vërtetë. Është e përdorur në ironi dhe në litotë, si dhe ndeshet edhe në disa emërtime eufemistike.

### *antimentalizëm*

**Antimentalizmi** është një teori sipas së cilës gjuha është një sjellje, e cila nuk mund të kuptohet veçse duke u nisur nga kushtet e jashtme të prodhimit të saj. Ajo është një nga karakteristikat e shkollës së Jalës, ku përfaqësuesi më në zë është L. Bloomfield. Në gjuhësi kjo teori përfaqëson

aspektin ekstrem të pozitivizmit.

Bloomfield formuloi dy hipoteza mbi kuptimin:

1. Një përshkrim i plotë shkencor i shenjave gjuhësore do të jetë i nevojshëm për të përcaktuar përdorimin që folësit u bëjnë fjalëve korresponduese.
2. Kuptimi i të gjitha fjalëve mund të përshkruhet në të njëjtat kushte.

Por ky është një objektiv i largët dhe jashtë fushës së gjuhësisë.

Kështu, domethënia e një forme është situata në të cilën folësi e përdor atë dhe reagimi që ajo ngjall te dëgjuesi. Ajo nuk varet nga subjektiviteti i subjektit folës (mënyra e tij e të menduarit), kurse fjala për të nuk është efekt i të menduarit. Në këtë mënyrë, kjo analizë është *antimentaliste* dhe e bazuar në bihevizim.

L. Bloomfield e ka paraqitur domethënien në termat e stimulit dhe të përgjigjes sipas skemës: **S. r. s. R.**

Një stimul i jashtëm (**S**) e detyron dikë të përdorë gjuhën, të flasë (**r**); kjo përgjigje gjuhësore e folësit për dëgjuesin përbën një stimul gjuhësor (**s**), i cili shkakton një përgjigje praktike (**R**).

**S** dhe **R** janë të dhëna jashtëgjuhësore, ndërsa **r** dhe **s** janë elemente të aktit gjuhësor:

Kështu, tek Poli "*lind*" dëshira për të ngrënë një copë tortë, kjo është një dëshirë që simbolikisht shënohet **S**; Poli, duke mos qenë në gjendje të përgatisë vetë tortën, ia kërkon nënës së tij, ky është akti gjuhësor **r**; që "*i përgjigjet*" këtij stimuli **S**; **r** vepron si stimul gjuhësor **s** mbi nënën, që e përgatit tortën (ose nuk përgatit) **R**.

Nga ky këndvështrim, ekziston një marrëdhënie në mes të ndarjes së punës dhe zhvillimit të gjuhës.

Gjuhëtarët bihevizistë dhe *antimentalistë* merren kështu vetëm me ngjarje të kapshme nga të gjithë vëzhguesit (të dhëna të vëzhgueshme), vetëm me fakte të përcaktuara nga koordinatat e kohës dhe të hapësirës, vetëm me mekanizma që përfshijnë veprime reale dhe të sakta. Qëllimi është një përshkrim i formalizueshëm, jopsikologjik, rigoroz dhe koherent i fakteve gramatikore.

### *antinomi*

**Antinomi** (nga greq. ἀντί - *antí* "kundër" dhe νόμος - *nómos* "ligj") është një lloj i veçantë i paradoksit që tregon bashkëpraninë e dy pohimeve kontradiktore që mund të jenë të dy të provuara ose të justifikuara. Emanuel Kant ishte i pari që e përdori fjalën *antonimi* në ligjërimin filozofik. Ndërsa në gjuhën Humboldi ishte i pari që trajtoi konceptin. Ai e mori dhe e zhvilloi tezën e Platonit mbi natyrën komplekse të gjuhës. Gjuha

sipas Humboldt ka natyrë të dyfishtë. Ajo është **ergon** dhe **energeia** njëkohësisht, duke pohuar se këto pole janë të kundërta dhe plotësuese të njëri-tjetrit në të njëjtën kohë. Kjo antinomi e gjuhës u zhvillua më pas nga F. De Saussure nëpërmjet dikotomisë gjuhë-ligjërimit.

#### *an(ti)ontiv*

**An(ti)ontiv** është një term, i cili, sipas gjuhëtarit frëng Lusien Tesnier, paraqet vetën e tretë të foljes. Ajo përputhet me përemrat vetorë aktualë të gramatikës gjenerativiste: *ai, ajo, ata, ato*.

#### *antirezonancë*

**Antirezonanca** (nga latinishtja *anti* “kundër” dhe *resonantia* “jehonë”) është një dukuri karakteristike për një sistem akustik, që vërtetohet kur frekuenca e madhësisë së alternuar akustike që e shkakton atë, përcakton një përgjigje minimale të shpejtësisë së rrjedhjes së fluksit të ajrit, në krahasim me frekuencat e afërta (fqinjje). Të ashtuquajturat antirezonanca përfaqësojnë pasojën kryesore akustike të hundorëzimit apo të bashkimit të rezonatorit të hundës me atë orofaringal. Ata prodhojnë një mbyllje që përcakton një ngushtim më të vogël të shtegut të kalimit të ajrit apo edhe zhdukjen e saj tërësore.

#### *antitezë*

**Antiteza** (nga gr. ἀντίθεσις - *antíthesis*, “kundravendosje”) është një figurë stilistike që mbështetet në kundërvënien brenda së njëjtës fjali të dy fjalëve apo të grupeve të fjalëve me kuptim të kundërt. Ajo përdoret për të vënë përballë ide, situata e aspekte të ndryshme të jetës, duke përdorur fjalë a fraza me kuptim të kundërt. Baza leksikore e saj janë antonimet.

P.sh. *Ju ngjiteni në pemë për të zbritur më pas.* Ka antitezë ndërmjet *ngjiteni* dhe *zbrisni*.

Ajo mbështetet jo vetëm në pranëvënien e fjalëve, por edhe të koncepteve të kundërta, të cilat marrin rëndësi më të madhe nga afërsia apo vendosja simetrike. Ajo mund të përftohet qoftë duke pohuar një gjë e mohuar së bashku të kundërtën e saj, qoftë duke vënë në kontrast dy fakte të kundërta:

Anës detit i palarë,  
anës dritës i paparë,  
pranë sofrës i pangrënë,  
pranë dijes i panxënë

(*Anës lumejve*, F.S.Noli)

**antologji**

**Antologjia** (nga gr. ἀνθολογία – *anthología*, “mbledhje e luleve”; e përbërë nga ἄνθος - *ánthos* “lule” dhe -λογία - *logía* “zgjedh”) është një përmbledhje e poezive, tregimeve, këngëve, artikujve apo e pjesëve të tjera letrare të zgjedhura nga një hartues. Mund të jenë pjesë të zgjedhura nga krijimtaria e një autori ose e autorëve të ndryshëm, nga krijimtaria e një vendi apo e vendeve të ndryshme. Antologjia më e madhe e njohur në kohë të vjetra është “*Antologjia greke*”, e hartuar më 923 nga greku bizantin Konstantin Cefalas<sup>4</sup>. Në letërsinë shqiptare mund të përmendim: “*Shkrimtarët shqiptarë*” (1940-41), “*Antologji e letërsisë shqipe*” (Dh. Shuteriqi, 1955), “*Antologji e lirikës shqiptare*” (E. Koliqi, 1963) etj..

**antonim**

**Antonime** (nga greqishtja ἀντόνυμο - *antónymo*; e përbërë nga ἀντί - *antí* “kundër” dhe ὄνομα - *onimo* “emër”) quhen njësitë leksikore (fjalë apo lokucione) me kuptim të kundërt. Janë antonime me njëra-tjetrën fjalët: *i vogël - i madh, i bukur - i shëmtuar, i ftohtë - i nxehtë, afër - larg, lart - poshtë, hyj - dal* etj..

Antonimet mund të jenë dy llojesh: antonime leksikore (në të cilat çifti përbëhet edhe nga fjalë etimologjikisht të ndryshme: *i mirë - i keq, i fortë - i butë, qaj - qesh* etj.) dhe antonime gramatikore (në të cilat kundërvënia është arritur me ndihmën e një parashtese: *i drejtë - i padrejtë, i qepur - i shqepur, armatos - çarmatos, palos - shpalos, vesh - zhvesh* etj.).

Në një kuptim më të gjerë, tek antonimet futen edhe çiftet e termave që konsiderohen si “*plotësuese*” (të tilla që pohimi i njërit zakonisht përfshin përjashtimin e tjetrit, si: *mashkull - femër, i martuar - i pamartuar*) ose ndërmjet të cilave marrëdhënia është më tepër e “*kundërshtisë*” ose e “*reciprocitetit*” (p.sh.: *burri - grua, blej - shes* etj)..

**antonimí**

**Antonimí** quhet raporti në mes të dy shenjave gjuhësore me kuptim të kundërt, të quajtura antonime, si: *i mirë - i keq, dashuri - urrejtje* etj.. Quhen të kundërta fjalë të tilla, si: *i bardhë - i zi* ose *i nxehtë - i ftohtë*, të cilat mund të nënkuptojnë edhe zgjidhje të ndërmjetme (“*gri*”, për çiftin e parë, “*e ngrohtë*” për të dytin), ndërsa quhen “*kontradiktore*” fjalë të tilla, si: *i vërtetë - fallco, i gjallë - i vdekur* etj., të cilat, ndryshe nga të parat, nuk janë të shkallëzuara, pra, nuk lejojnë zgjidhje të ndërmjetme. Në gjuhën shqipe antonimia mund të krijohet edhe me anë të krijimit të fjalëve të reja

<sup>4</sup> F. Leka “*Fjalor i termave të letërsisë*”, Infbotues, Tiranë, 2013, fq. 37.

me anë të parashtesave me kuptim mohues, si: *pa-*, *mos-*, *jo-*, *z-*, *ç-*, *kundër-* etj., p.sh.: *e palogjikshme*, *i paedukatë*, *mosbesim* etj..

### ***antonimik***

Që ka të bëjë me antoniminë (shprehje antonimike, çift antonimik).

### ***antonomazi***

**Antonomazia** (nga greq. ἀντονομασία - antonomasía, “*thërras me një emër tjetër*”; e përbërë nga ἀντο - *anto*, “në vend të” dhe νομάζω - *nomázo*, “emër”) është një figurë retorike e semantikës, e cila bazohet në zëvendësimin e emrit të një objekti ose personi me një emër të përgjithshëm ose një mbiemër, *i cili tregon një karakteristikë të tij, origjinën ose, në rastin e njerëzve, vendin e lindjes*, pra, nënvizon një nga karakteristikat e tij të veçanta. Për shembull:

poeti suprem, një antonomazi që i referohet Dantes; poeti kombëtar, i referohet Gjergj Fishtës; planeti i kuq, një emër për Marsin, që të kujton ngjyrën e tij karakteristike; shpëtimtari, një antonomazi, që sipas besimit të krishterë i referohet Jezu Krishtit etj..

Gjithashtu flitet për *antonomazi* edhe në rastet kur ndodh procesi i kundërt, domethënë, kur një fjalë e zakonshme zëvendësohet me emrin e një personi ose të një objekti specifik, që konsiderohet si përfaqësues i atij koncepti. Kujtoni përdorimin në gjuhën e zakonshme të Shën Toma (Sh’Toma) - për të treguar dikë që u beson vetëm provave; Ajnshtajni - mbiemri i fizikantit më të famshëm të shekullit XX, për të emërtuar dikë që shquhet për inteligjencën e tij; Ciceroni - është pikërisht elokuenca e Marcus Tullius Ciceronit, oratorit të famshëm romak, që bëri që të gjithë udhërrëfyesit të tregoheshin me këtë emër; Papparac - emri i një personazhi në filmin “*La dolce vita*” i regjizorit italian F. Felini, që shërben për të emërtuar fotografët që pushtojnë jetën private të njerëzve të famshëm; Vandal - në këtë rast antonomazia e ka origjinën në emërtimin e një populli barbar, duke treguar ata që dëmtojnë atë që i rrethon me qëllime keqdashëse.

Prandaj mund të thuhet se *antonomazia* funksionon me një logjikë të ngjashme me sinekdokën, pasi është një emërtim që kalon nga e përgjithshmja në të veçantën dhe anasjelltas.

### ***antroponim***

**Antroponime** (nga greqishtja ἀνθρωπος – *ánthrōpos*, “njeri” dhe ονύμα – *ónyma*, “emër”) në gjuhësi janë emrat e përveçëm të njerëzve. Në shumicën e kulturave emri i përveçëm i atribuohet një individi të caktuar që nga lindja dhe ka funksion identifikimin e dallimin e tij brenda një bashkësie të caktuar shoqërore.



***antroponimi***

**Antroponimi** (ose *antroponomastikë*) është një degë e onomastikës, që merret me studimin e antroponimeve, domethënë, me studimin e domethënies dhe të origjinës së emrave të përveçëm të njerëzve.

***antroponimik***

Që ka të bëjë me emrat e personave ose që i referohet antroponimeve: *anketime, hulumtime, studime antroponimike*.

***anunasik***

**Anunasik** (nga sanskritishtja अनुनासिक - *anunāsika* në kuptimin *një shkronjë*) i referohet një tingulli, i cili prodhohet nga kalimi i njëkohshëm i rrymës së ajrit nëpër zgavrën e gojës dhe të hundës. Kalimi i ajrit nëpër zgavrën e hundës i jep tingullit timbër hundor (nazal). Në gjuhën shqipe kemi bashkëtingëllore hundore (*m, n, nj* dhe në dialekt *ŋ*) dhe zanore hundore (*ã, õ, ù, ĩ, ě, ŷ*). Quhet ndryshe edhe hundorëzim pasues.

***anusvarë***

**Anusvara** (nga sanskritishtja अनुस्वारः - *anu-svāra* në kuptimin “*pas tingullit*”) është një shenjë diakritike e përdorur në shkrimet brahmi për të treguar hundëzimin. Në varësi të gjuhës në të cilën përdoret dhe të vendndodhjes së *anusvarës* në fjalë, shqiptimi i tingullit mund të ndryshojë shumë.

Në kontekstin e sanskritishtes *anusvara* mund t'i referohet edhe vetë tingullit hundor.

Në shkrimet Devanagari *anusvara* shënohet me një pikë (bindu) mbi shkronjën përkatëse (p.sh. ऋ). Në Alfabetin Ndërkombëtar të Translitterimit Sanskrit (IAST), simboli përkatës është **ṁ** (m me një pikë nën shkronjë), kurse disa transkriptime të tjera shënohet me variantin **ṡ** (m me një pikë mbi shkronjë).

***aorist***

**Aoristi** (nga greqishtja e vjetër ἀόριστος - *aóristos* “i pacaktuar”) është një kohë e foljeve në disa gjuhë indoevropiane, si: në greqishte, sanskritishte, persishte e mesme, armenishte, gjuhët sllave jugore etj., e cila paraqitet e ndërtuar nga bashkëngjitja e disa mbaresave specifike (të vetës dhe të numrit) me një temë ose të përbërë nga një ndajshtesë **-s-** që i shtohet rrënjës (aoristi sigmatik), ose me një rrënjë pa ndajshtesë dhe shpesh në shkallë të reduktuar (aoristi asigmatik). Kuptimi kryesor i kësaj forme është të tregojë një veprim që është kryer në një çast të caktuar të së shkuarës. Aoristi, që i kundërvihet kohës së tashme (aspekti i pakryer) dhe kohës së

kryer (aspekti i kryer), e paraqet veprimin në zhvillimin e tij në lidhje me kryefjalën e fjalisë. Vlera aspektore e tij është ajo e një veprimi të pavarur në lidhje me kryefjalën e fjalisë (aoristi është i papërcaktuar në raport me kohën e veprimit).

Në gjuhën shqipe format foljore, që përfshihen në kohën e së kryerës së thjeshtë, për nga kuptimi, në vija të përgjithshme i përgjigjen aoristit të gjuhëve indoevropiane. Edhe për nga tipi i ndërtimit format foljore të kësaj kohe e kanë ruajtur në njëfarë mase kundërvënien e hershme midis aoristit sigmatik e aoristit asigmatik; k.h.s. dha-sh-ë, pa-sh-ë, la-sh-ë dhe hap-a, dol-a, puno-v-a.

Por do pasur parasysh se format gramatikore të së kryerës së thjeshtë të gjuhës shqipe historikisht janë formime të ndryshme, që pjesërisht janë vazhdimi i së kryerës (perfektit) dhe pjesërisht janë rindërtime relativisht të reja. Kështu, forma e vetës së parë njëjës e tipit *dha-sh-ë* është mbeturinë e aoristit sigmatik, kurse format apofonike të tipit *vol-a*, *mor-a* janë mbeturina të së kryerës së vjetër sintetike, që janë përzier prej kohësh me format e aoristit, duke humbur ato të parat kuptimin e së kryerës e duke marrë atë të aoristit<sup>5</sup>.

Formanti **-sh-** që ndeshet kryesisht në vetën e parë njëjës të së kryerës së thjeshtë te një numër i kufizuar foljesh të trashëguara (dha-sh-ë, pa-sh-ë, qe-sh-ë, la-sh-ë, tha-sh-ë, de-sh-a), mendohet ta ketë burimin te prapashtesa e njohur indoevropiane **-s-** e këtij tipi aoristi, që del edhe në disa gjuhë të tjera, si : në sanskritishte, greqishte etj.<sup>6</sup>

#### *aparati*

**1. Aparati i dëgjimit** përbëhet nga një seksion periferik dhe një seksion qendror. Sistemi periferik i dëgjimit, përbëhet nga veshi i jashtëm, veshi i mesëm dhe veshi i brendshëm, kurse aparati qendror i dëgjimit përbëhet nga nervi akustik (vestibuli koklear ose nervi i tetë kranial) dhe korteksi temporal (zona e trurit përgjegjëse për perceptimin e zërit).

Aparati i dëgjimit është i pari nga pesë organet shqisore që zhvillohet tek fetusit (duke filluar nga muaji i gjashtë) dhe e lehtëson kontaktin me mjedisin e jashtëm.

Sistemi i dëgjimit, si dhe sistemet e tjera shqisore, ka katër funksione themelore:

- mbledh stimuj që vijnë nga bota e jashtme në formën e një energjie akustike;

<sup>5</sup> Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë “8 Nëntori”, 1985, f. 778.

<sup>6</sup> Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë “8 Nëntori”, 1985, f. 778.

- konverton energjinë akustike në një seri impulsesh nervore;
  - mbar impulse nervore në zonën përkatëse të trurit;
  - analizon informacionin që përmban sekuenca e impulseve nervore për të identifikuar stimulin.
2. **Aparati i të folurit** përbëhet nga të gjitha organet e trupit të njeriut që marrin pjesë në prodhimin e tingujve të të folurit. Procesi fiziologjik me të cilin artikuloen tingujt realizohet përmes organeve që e përbëjnë aparatin e të folurit. Ai përfshin:
- aparatin e frymëmarrjes,
  - laringun (që përmban elementet vibruese dhe sistemin rezonator),
  - zgavrat e mbilaringut,
  - sistemin nervor.
- Aparati i të folurit përbëhet nga organe që lëvizin në zgavrën e gojës (organe aktive të aparatit të të folurit), si: buzët, gjuha dhe uvula dhe organe që nuk lëvizin (organe pasive të aparatit të të folurit), si: dhëmbët, alveolat dhe qiellza.
3. **Aparati kritik** është mjeti me të cilin filologu shqyrton variantet e teksteve të traditës. Ai është seksioni i botimit kritik që i kushtohet dokumentimit të gjendjes së traditës së një teksti, duke dhënë një pasqyrë të zgjedhjeve të bëra nga redaktori në përbërjen e vetë tekstit. Aparati kritik i tregon lexuesit pikat në të cilat teksti i botuar (i shtypur) ndryshon nga dorëshkrimi. Gjithashtu ai gjatë realizimit të një analize të plotë të varianteve të një teksti ofron edhe mjetet e nevojshme që lexuesi të gjykojë mbi zgjedhjet e botuesit apo të redaktorit.

## BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë.
- Beccaria, Gian Luigi (2004), *Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*, Piccola Biblioteca Einaudi.
- Belluscio, Giovanni & Rrokaj, Shezai (2011), *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*, Arbëria, Tiranë.
- Demiraj, Shaban (1985), *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, “8 Nëntori”, Tiranë.
- Dubois, Jean & Giacomo, Mathee & Guespin, Louis & Marcellesi, Christiane & Marcellesi, Jean-Baptiste & Mével, Jean-Pierre (2001), *Dictionnaire de linguistique*, Larousse, ISBN 2-03-532047-X.

- Dubuc, Robert (1992), *Manuel Pratique de terminologie*. Linguatex: Brossard.
- Jakobsòn, Romàn (1963), *Saggi di linguistica generale*, Parigi, cit. te Marchese, cit., lemma *Assi del linguaggio*.
- Fodor, Jerry A. & Katz, Jerrold J. (1963), *The Structure of a semantic Theory*, in Id., *The Structure of Language*, Prentice Hall, Englewood Cliffs N. J. 1964.
- Leka, Ferdinand (2013), *Fjalori i termave të letërsisë*, INFBOTUES, Tiranë, ISBN 978-9928-173-11-9.
- Topalli, Kolec (2011), *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Botimet albanologjike, Tiranë.
- Topalli, Kolec (2007), *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, “Dituria”, Tiranë.
- Vendler, Zeno (1967), Dubuc, R. (1992), *Manuel Pratique de terminologie*, Linguatex: Brossard.
- Vendler, Zeno (1967), *Verbs and times*, in *Linguistics in Philosophy*, Ithaca (New York).

### **TERMINOLOGY AS A SISTEM (Dictionary of linguistic terms)**

#### **ABSTRACT**

This article comes is a continuation of the articles with the same title which was published in the previous publications. In it, 37 language terms have been explained, which we come across in the field of literature, both in contemporary and traditional one. In our explanations, we have tried to preserve the particular characteristics that often reflect the original value they have, according to different linguistic theories or which might be revised by the Science of Albanian Language to different concepts.

Orjeta Baja

## FIGURAT E STILIT

(Fjalor terminologjik shpjegues)

### *Shkronjat* **R, S, T, Z**

- vijon -

**reduplikacion, -i m.** nga lat. *reduplicatio*, “dyfishim” (*fr.* reduplication, *it.* reduplicazione) → **përsëritje, -a**

Figurë morfo-sintaksostilistike që konsiston në përsëritjen e një fjale a të një pjese të saj, kryesisht me qëllim intensifikimin e kuptimit të njësisë së përsëritur për qëllime shprehëse. Lidhet me disa kategori leksiko-gramatikore, në veçanti me mbiemrat dhe ndajfoljet. Është figurë e zakonshme në letërsi, ku përdoret për të rritur intensitetin emocional ose për të krijuar një ndjenjë ritmi, si: forma “*shpejt e shpejt*” përdoret për të theksuar intensitetin ose shpejtësinë e veprimit. Kjo teknikë ndeshet në shumë gjuhë dhe mund të përdoret për të shprehur, përveç se intensifikim, edhe zvogëlim, shumësi a vazhdimësi të kuptimit.

**reticensë, -a f.** nga lat. *reticentia*, “heshtje” (*fr.* réticence, *it.* reticenza) → **rilutanca, apoiopeza**

Figurë sintaksostilistike që konsiston në ndërprerjen e një fjalie pa përfunduar shprehjen e mendimit, me qëllim që lexuesi a dëgjuesi ta përqendrojë vëmendjen mbi fenomenin e nënkuptuar, për të arritur vetë të konkluzioni, duke e plotësuar me mend sipas imagjinatës së tij atë që u la pa u thënë. Fjalja lihet e papërfunduar për të krijuar tek marrësi një përshtypje të veçantë e të gjallë. Kjo ndërprerje e zhvillimit sintaksor paraqitet tipografikisht me tri pika (...) (p.sh.: “*Po unë i fola durimit: prit dhe pak / Mbahu pas meje... ku ta dish... te ky park... / Dy silueta... si një trup i vetëm.... nëpër natë.*” [Xh. Spahiu]). Thuhet: Përgjigjem me reticensë; Flas pa reticensë, haptas.

**redondancë, -a f.** nga lat. *redundantia*, “fjalëtepri” (*fr.* redondance, *it.* ridondanza) → **pleonaz/më, -mi**

Figurë stilistike që përftohet nga përsëritja e fjalëve, shprehjeve a frazave në një tekst, që në thelb përsërisin të njëjtin kuptim dhe nuk shtojnë ndonjë informacion të ri. Kjo teknikë përdoret shpesh për të shtuar forcën

shprehëse, për të theksuar ndjenjat e mendimet, duke krijuar ritëm e duke nxjerrë në pah një ide të rëndësishme që autori dëshiron të përcjellë. Ndonjëherë mund të konsiderohet edhe si një gabim gjuhësor, nëse bëhet pa qëllim. Kjo figurë gjendet në lloje të ndryshme tekstesh në prozë e poezi.

**simbolizmi tingullor** (*fr.* symbolisme phonique, *it.* simbolismo fonico)

Figurë fonostilistike që lidhet me shoqërimin tingull-kuptim, kur përftohet me qëllimin për t'u bërë burim shprehësie në një tekst. Më shpesh, simbolizmi tingullor arrihet nëpërmjet grumbullimit të disa tingujve që krijojnë një lidhje simbolike me një ide a atmosferë të caktuar, e që, përmes tingëllimit, ata mbështesin ose e bëjnë dëgjimisht të perceptueshëm kuptimin që japin fjalët. Kjo përftesë bën që disa fjalë, të cilave mund të mos ua dimë kuptimin, të na ngjallin një përshtypje dhe emocion me tingëllimin e tyre (p.sh., në vargjet: “*Shushurijnë shëlgjet në fushë, shushurijnë / Mërmërijnë mizat në mritz, mërmërijnë*” [Xh. Spahiu], autori sugjeron zhurmën e pemëve e të insekteve nëpërmjet disa tingujve që përsëriten).

**sinekdok/ë, -a** *f.* nga gr. *synekdoché*, “të kuptuarit së bashku” (*fr.* synecdoque, *it.* sineddoche)

Figurë semantostilistike që përftohet nga kalimi i kuptimit të një fjale në një tjetër, përmes përdorimit të një lekseme emërtuese me kuptim më të gjerë a më të ngushtë nga ai që ka në të vërtetë, duke përmendur pjesën për të tërën ose të tërën për pjesën, njëjësën për shumësin, individin për llojin, vendin për banorët e tij etj., si: “*shqiptari*” në vend të “*shqiptarët*”: “*besa e shqiptarit*”; “*fshati*” në vend të “*fshatarët*”: “*erdhi i gjithë fshati*”; “*stina e trëndafilave*” në vend të “*pranvera*”: “*erdhi stina e trëndafilave*”. Gjithashtu në vargjet: “*Prej mjesnatet e n'pikë t'zhegut / Shqyptarija rri tui shfrye / Tui derdhë lot e tui vojtue.*” [Nd. Mjeda]).

**sinestezi, -a** *f.* nga gr. *synaísthesis*, “perceptim bashkë” (*fr.* synesthésie, *it.* sinestesia)

Figurë morfostilistike që konsiston në shoqërimin e dy fjalëve (zakonisht: emër e mbiemër) nga sfera të ndryshme perceptimi, duke përftuar një imazh të vetëm nga afrimi i tyre, që në një raport reciprok interferues japin origjinën e përftesës (p.sh.: “*Të ecësh me krahun mbi supet e tua / E të harrosh oshëtimën e kaltër / Limonat mbi krye / Peshkarexhat si zjarre të natës?*” [Xh. Spahiu]). Sinestezia ndeshet më tepër në gjuhën e përditshme, si në këto sintagma: “*ngjyrë e nxehtë*” - ku perceptimi pamor mbi emrin “*ngjyrë*” është bashkuar me një ndjesi

prekjeje nga mbiemri “*e nxehtë*”; “*zë i qartë*” - ku perceptimi dëgjimor “*zë*” është bashkuar me perceptimin pamor “*i qartë*”.

**sinonimi, -a** *f.* nga gr. *synonymía*, “ngjashmëri kuptimore” (*fr.* synonymie, *it.* sinonimia) → **metabola, ekspolicioni**

Figurë semantostilistike që përftohet nga përdorimi pranë në një tekst i dy a më shumë fjalëve a shprehjeve që shprehin përafërsisht të njëjtën ide, të njëjtin koncept, të njëjtin kuptim, apo, të paktën, një bërthamë semike të përbashkët; rimarrja e të njëjtit argument nën forma të ndryshme, me qëllim që t’i japë atij më tepër forcë (p.sh.: “*Po nis qan Zonja Shërmëri / Aty në syt’ e mi / I rrjedhin lotët në shami / Pa nis dhe unë edhe qaj / Vajtoj - vajtoj me vaj.*” [M. Kuteli]). Shkrimtari që do të japë nuancat më të holla të mendimit e të ndjenjave, zgjedh me kujdes sinonimet, duke ruajtur vetitë specifike e nuancën stilistike të tyre. Përdorimi i fjalëve dhe i shprehjeve sinonimike e ndihmon atë të ketë një gjuhë më të pasur, më të larmishme dhe të mënjanojë përsëritjet. E kundërta: **antonimia**.

**suspens, -i** *m.* nga lat. *suspensum*, “mbajtje pezull” (*fr.* suspense, *it.* suspense)

Figurë sintaksostilistike e përftuar nga kalimi në fund të frazës i një grupi sintaksor të nevojshëm e të pritur, shprehja e të cilit është vonuar nga ndërfitja e shënimeve të dorës së dytë, përmes enumeracioneve, digresioneve, parantezave etj. Kjo figurë përdoret për të krijuar tension apo pritshmëri, duke vonuar zbulimin e informacionit kyç në një fjali ose në një tekst, Kjo vonesë krijon një ndjenjë misteri ose pritjeje te lexuesi ose dëgjuesi. Zakonisht përdoret në letërsinë artistike, veçanërisht në tregimet apo romanet me ngjarje të tensionuara (p.sh.: “*Isha duke ecur ngadalë drejt derës. Zemra po më rrihte fort, dhe në çastin kur e hapa, pashë ... një siluetë të njohur që më priste në errësirë.*”).

**shkallëzim, -i** *m.* (*fr.* gradation, *it.* climax) → **klimaks, -i**

Figurë sintaksostilistike që përftohet duke e paraqitur mendimin me fjalë të njëpasnjëshme përherë e më të fuqishme, që vijnë duke ia shtuar forcën shprehjes (p.sh.: “*Oh vaj! Oh kob, Oh marre e turp për ne! / Sot sheklli mbarë prir synin drejt shqiptarëve / Me pa si përkujdesemi për Atdhe / E si u dëshmojmë me punë na kundërshtarëve / Se jemi t’zotë me u lidhë me besë e fe / Edhe vetë me sundue vendin e t’Parëve*” [Gj. Fishta]). Si një nga mjetet më të fuqishme të sintaksës poetike, shkallëzimi përdoret shpesh në poezi, por jo rrallë edhe në prozë (p.sh.: “*Në fillim i ngriu*

buzëqeshja në buzë, *pastaj* iu rrudhën vetullat, *pastaj* u nxi i tëri dhe *sytë nisën t'i zmadhohen*” [Dh. Xhuvani]. Ekziston edhe një shkallëzim zbritës (antiklimaks) i këtij lloji, si: “*thërriste, lutej, përgjërohej ...*”

**tautologji, -a** *f.* nga gr. *tautologhía*, “përsëritje e asaj që është thënë” (*fr.* tautologie, *it.* tautologia)

Figurë sintaksostilistike që lidhet me përsëritjen e së njëjtës përmbajtje, të po atij mendimi, të po asaj ideje, me fjalë të njëjta a të afërta për nga kuptimi, si: *hiç fare, sonte në mbrëmje, plot e përplot, unë vetë, jetë e plotë dhe e lumtur* etj. Thuhet: Gjuhë plot tautologji. Është tautologji. Shpie në tautologji.

**tmez/ë, -a** *f.* nga gr. *tmésis*, “ndarje, prerje, këputje” (*fr.* tmèse, *it.* tmesi)

Figurë morfostilistike e metrike që përftohet kur një fjalë a togfjalësh ndahet në mes nga ndërputja e një fjale tjetër për të krijuar një efekt stilistik a emfatik. Është përftesë tipike e gjuhës poetike. Takohet mjaft në letërsinë tonë gojore (p.sh.: “*O n’e hëngri, u shëroftë / Trimi u trashë-moj-goftë.*” [Folklor]).

**trop, -i (tropet)** *m.* nga gr. *trópos*, “devijim, shmangie” (*fr.* trope, *it.* tropo)

Figura semantostilistike që shprehin shmangie nga emërtimi i drejtpërdrejtë, duke bërë përshtypje të fortë, sidomos kur janë origjinale. Ato nuk janë dukuri të kuptimit të fjalëve të veçuara, por të lidhjes së tyre. I ndeshim më tepër në letërsi, ku fitojnë edhe vlera artistike; por edhe në rrethana të ndryshme nga njerëz të zakonshëm, kur përpiqen të thonë diçka jo në mënyrë të zakonshme, por me fjalë a shprehje me kuptim të figurshëm, që i japin ligjërimin fuqi shprehëse më të madhe, me forcë ndikuese e tërheqëse. Shkrimtarët, nëpërmjet tropeve, i bëjnë më të kapshme mendimet e ndjenjat. *Metafora, metonimia, sinekdoka, antifraza, hiperbola* janë lloje tropesh.

**zeugm/ë, -a** *f.* nga gr. *zêugma*, “lidhje” (*fr.* zeugme, *it.* zeugma)

Figurë sintaksostilistike që përftohet në ato raste kur fjalitë kanë të përbashkët gjymtyrën kryesore (kallëzuesore), duke munguar kjo në fjalitë vijuese; lidhja e dy a më tepër subjekteve me një folje (predikat) (p.sh.: “*Si të velur nga kjo botë njëri ndërroi jetë buzë-vjeshte, dy këtij dimri, edhe disa në prenverë, kur rin bari.*” [M. Kuteli]). Kjo figurë më së shumti përdoret me qëllim satirik (p.sh.: “*Njëri i bie gozhdës, tjetri patkoit.*”).



**BIBLIOGRAFI:**

- **Beccaria, Gian Luigi** (Direzione scientifica), *Dizionario di linguistica (e di filologia, metrica, retorica)*, "Piccola Biblioteca Einaudi", Torino, 2004.
- **Belluscio, Giovanni – Rrokaj, Shezai**, *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë* (shqip - italisht - frëngjisht - anglisht), "Arbëria", Tiranë, 2011.
- **Dubois, Jean – Giacomo, Mathée – Guespin, Louis – Marcellesi, Christiane – Marcellesi, Jean-Baptiste – Mével, Jean-Pierre**, *Dictionnaire de linguistique*, "LAROUSSE", Paris, 2001.
- **Patota, Giuseppe** (Direzione scientifica), *Il Dizionario medio Garzanti della lingua italiana*, Dizionario Interattivo Garzanti, De Agostini Scuola S.p.A., "Stabilimento di Lavis (TN)", 2010.
- **Baja, Orjeta**, *Terma të përbashkët të gjuhësisë me letërsinë (në funksion stilistik)*, në revistën "Buletini shkencor", nr. 9-3, Ulqin (Mal i Zi), 2017.
- **Topalli, Tefë – Baja, Orjeta**, *Glosar - (100 terma gjuhësorë-stilistikë e retorikë)*, në revistën "Buletin shkencor" (Seria e shkencave shoqërore), nr. 58, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, 2008.
- **Leka, Ferdinand**, *Fjalor i termave të letërsisë*, "INFBOTUES", Tiranë, 2013.
- **Fromilhague, Catherine**, *Les figures de style*, "Nathan", Paris, 2000.
- **Reboul, Olivier**, *Introduction à la rhétorique*, "PUF", Paris, 1998.

**ABSTRACT**

2. Roli i përkthyesit komplikohet nga paradoksi i padukshmërisë dhe dukshmërisë. Ashtu siç sugjeron Venuti, qasja tradicionale ka pritur shpesh që përkthyesi të mbetet i padukshëm, duke siguruar që përkthimi të lexohet natyrshëm dhe rrjedhshëm në gjuhën e synuar. Megjithatë, kjo pritshmëri mund të çojë në zhdukjen e aspekteve të rëndësishme kulturore dhe ideologjike të tekstit origjinal, duke rezultuar në një përfaqësim etnocentrik që zvogëlon autenticitetin e veprës burimore. Në të kundërt, pranimi i një roli më të dukshëm lejon përkthyesit të ruajnë elementet e huaja të tekstit, duke nxitur një kuptim më të pasur dhe respektues të kulturave të ndryshme.

3. Besnikëria ndaj tekstit burimor mbetet një nga aspektet më të diskutueshme të përkthimit. Siç është shqyrtuar në këtë punim, mbajtja e besnikërisë absolute nuk është gjithmonë e mundshme ose e dëshirueshme,

veçanërisht kur bëhet fjalë për tekste të pasura me nuanca kulturore, historike dhe filozofike. Qasja hermeneutike e Eco-s thekson se përkthimi është një akt interpretimi, që kërkon nga përkthyesi të angazhohet thellësisht me kuptimin e tekstit në kontekstin e tij origjinal. Ky proces përfshin në mënyrë të pashmangshme një nivel subjektiviteti, pasi përkthyesi duhet të bëjë zgjedhje që pasqyrojnë kuptimin e tij të tekstit, duke marrë parasysh gjithashtu pritshmëritë dhe njohuritë e audiencës së synuar.

4. Globalizimi ka ndërlikuar më tej dimensionet etike të përkthimit. Ndërsa kulturat ndërveprojnë gjithnjë e më shumë, roli i përkthyesit si një urë midis komuniteteve gjuhësore bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Megjithatë, kjo ndërthurje sjell gjithashtu rrezikun e homogjenizimit, ku zërat e ndryshëm kulturorë mund të zhduken brenda tregimeve dominuese. Kjo rrezikshmëri nënvizon përgjegjësinë etike të përkthyesit për të vepruar si një mbrojtës i diversitetit kulturor, duke siguruar që zërat e marginalizuar të mos heshten ose keqinterpretohen gjatë procesit të përkthimit.

5. Shfaqja e inteligjencës artificiale dhe veglave të përkthimit automatik sjell sfida dhe mundësi të reja për fushën e përkthimit. Nga njëra anë, inteligjenca artificiale ka potencialin të bëjë përkthimin më të aksesueshëm dhe më efikas. Nga ana tjetër, varësia nga AI sjell me vete shqetësime të rëndësishme etike, veçanërisht në lidhje me saktësinë, ndjeshmërinë kulturore dhe paragjykimet e mundshme të përfshira brenda përkthimeve të krijuara nga makina.

6. Në dritën e këtyre sfidave, roli i përkthyesit mund të shihet si një përgjegjësi e thellë etike. Përtej saktësisë gjuhësore, përkthyesit shërbejnë si ndërmjetës kulturorë, të ngarkuar me ruajtjen e integritetit dhe pasurisë së tekstit burimor, duke e bërë atë të kuptueshëm dhe të rëndësishëm për një audiencë të re. Kjo përgjegjësi shtrihet në njohjen dhe respektimin e konteksteve kulturore, historike dhe filozofike, duke siguruar që përkthimi të bëhet një akt i shkëmbimit kulturor dhe jo një formë e përvetësimit kulturor.

Në përfundim, përkthimi është shumë më tepër sesa një ushtrim teknik; ai është një akt kompleks interpretimi që kërkon ndërgjegje të lartë etike dhe ndjeshmëri kulturore. Siç është treguar në këtë punim, përkthyesit nuk janë thjesht kanale për transferimin gjuhësor, por pjesëmarrës aktivë në formësimin e mënyrës se si kulturat komunikojnë dhe kuptojnë njëra-tjetrën. Sfida etike që ata përballen, qoftë në lidhje me besnikërinë, dukshmërinë, apo integritetin e teknologjive të AI, kërkojnë një përkushtim të vazhdueshëm për ruajtjen e integritetit të zanatit të tyre.

**BIBLIOGRAFI**

1. Venuti, Lawrence. *The Translator's Invisibility: A History of Translation*. Routledge, 1995.
2. Eco, Umberto. *Dire quasi la stessa cosa: Esperienze di traduzione*. Bompiani, 2003.
3. Eco, Umberto, *Lector in Fabula: La Cooperazione Interpretativa nei Testi Narrativi*, Milano, Bompiani, 1979.
4. Eco, Umberto, *Opera Aperta: Forma e l'Indeterminazione nelle Poetiche Contemporanee*, Milano, Bompiani, 1962.
5. Venuti, Lawrence. *The Scandals of Translation: Towards an Ethics of Difference*. Routledge, 1998.
6. Munday, Jeremy. *Introducing Translation Studies: Theories and Applications*. Routledge, 2016.
7. Spivak, Gayatri Chakravorty. "The Politics of Translation." In *Outside in the Teaching Machine*, Routledge, 1993, pp. 179-200.
8. O'Hagan, Minako. *The Routledge Handbook of Translation and Technology*. Routledge, 2020.
9. Kenny, Dorothy. *Machine Translation and Global Research: Towards Improved Machine Translation Literacy in the Scholarly Community*. Routledge, 2022.
10. Dionigi, Ivano. *Le parole che allungano la vita*. Mondadori, 2017.
11. Ivano Dionigi, *Il presente non basta: La lezione del latino*, Milano, Mondadori, 2016.
12. Primo Levi, *A është, vallë, njeri...*, përkthyer nga Genci Pjetri ,Tiranë: Pegi, 2012.
13. Gabriel García Márquez, *Njëqind vjet vetmi*, përkthyer nga Ilir Baçi, Tiranë, Botimet Toena, 2002.

**The translator as an ethical mediator in the age of artificial intelligence: approaches and responsibilities in contemporary translation practices and theories**

**ABSTRACT**

The translator, as an ethical mediator between languages and cultures, plays a crucial role in preserving cultural authenticity by ensuring that the original text's message is conveyed accurately. This article examines the ethical responsibilities of the translator in various contexts, including literature, law, science, and audiovisual translation, focusing on challenges such as fidelity to the original text, localization of the translated text, retention of foreign elements, and the growing impact of technology on

translation practices. Drawing on the theories of Umberto Eco, Ivano Dionigi, and Lawrence Venuti, the article provides a comprehensive framework for understanding ethical dilemmas in translation. It also explores the translator's role in relation to human rights and globalization, emphasizing the social, political, and cultural consequences of translation choices. Finally, a reflection on machine translation and artificial intelligence underscores the increasing importance of ethics in contemporary translation practices.

**Keywords:** translator, ethical mediator, translation theories, globalization, artificial intelligence, ethics.



Behar GJOKA

## PJETËR BUDI – PËRKTHYES, PËRSHTATËS APO POET?

Shqyrtimet gjuhësore dhe letrare, tashmë e kanë dhënë përgjigjen mbi shkrimin letrar të Budit dhe gjurmët e pranishme të poetit e të prozatorit, si tekst dhe vlerë. Sjellja në vëmendje e përcaktimit të Selman Rizës, të bërë në mesin e viteve '60 të shekullit të njëzetë, ndihmon për të kuptuar se si është trajtuar më herët trashëgimia poetike: *“Si për nga risia e temave dhe gjinive, ashtu edhe nga aftësia kompozicionale, gjithashtu për nga fuqishmëria e shprehjes Pjetër Budit kurrsesi nuk mund t'i mohohet cilësia jo vetëm e të parit lavrues frymëgjatë të poezisë letrare shqipe, por njëherazi edhe të parit poet shqiptar...”*<sup>[1]</sup>

Megjithatë, mëdyshja e treguar herë pas herë ndaj poezisë së autorit, duke shpërfillur hapur aftësitë e poetit, madje në shumicën e herëve pa e lexuar si tekst, sidomos në Shqipëri, e cila ngahera rishfaqet si hije gërryese e vlerave letrare që bart, kërkon një verifikim më të pranshëm tekstologjik të gjithë materies poetike. Ligjërata e pashmangshme e përcaktimit të trefishtë të natyrës së poezisë së Pjetër Budit, pra, si e përkthyer, e përshtatur dhe origjinale, nuk është se largon dhe zgjidh çështjet e trajtimit të trashëgimisë poetike në kohë dhe hapësirë të autorit themelhedhës të shkrimit poetik të kultivuar të shqipes, aq më tepër me libër me poezi. Ndërmjet tyre, si më thelbësore, në optikën e hedhjes dritë në këtë proces kompleks dhe tejet të ndërlikuar, ndonëse të përqendruar për një kohë të gjatë në shtjellat jashtëtekstore, janë:

- A. Marrëdhënia e lëndës përkthimore dhe autoriale, e cila nuk është parë dhe trajtuar ndamazi, por si një bashkëshkrirje e tyre, pa kufijtë e pranishëm të analizës dhe interpretimit të secilës anë shkrimore, në katër librat e shkrimtarit.
- B. Lënda poetike dhe prozëshkrimi, që dëshmon praninë e vlerave letrare të endura nga shkrimtari, ku ndërkaq poezia ka njohur një botim të trashëgimisë poetike të të tre librave, përkatësisht në vitin 1986, nën përkujdesjen e Rexhep Ismajlit, kurse proza gjendet ende vetëm në librat e botuar nga Propaganda Fide. Pra, ende jemi pa një tekst integral, ku të bashkëlidhen të gjithë faqet në prozë që trashëgojmë prej shkrimtarit.
- C. Metodot e studimeve letrare, për ta analizuar dhe vlerësuar qenësinë artistike të letërsishkrimit të autorit, të poezisë dhe të prozës, më tepër si një qasje jashtëtekstologjike, si dhe duke hulumtuar antifetaren dhe

fetaren, por përgjithësisht duke lënë jashtë verifikimit dhe interpretimit shenjat letrare, duke u bazuar në parimet e poetikës së letrares.

- D. Papërcaktueshmëria e lëndës poetike dhe modelet e leximit të teksteve të Budit dhe të letërsisë së hershme, si fakt gjuhësor që nuk ka lidhje me shenjzimet artistike, e cila formalisht, bazuar në praninë e vargut dhe të strofës, po kaq të figurave dhe shprehësisë, nuk jep dorë me lënë pezull një situatë të identifikuar të shkrimit të vargjeve.

Katër librat e Pjetër Budit, që ndërkaq kanë shpëtuar nga mugullimat e kohërave, përkatësisht *“Doktrina e Kërshtenë”*(1618), *“Pasqyra e t’rrëfyemit”*, *“Rituali Roman”* (ku gjendet edhe libri *“Kush thotë meshë këtë kafshë* (libër - B. Gj.) *i duhet me shelbuom”* në vitin 1621, në hapësirat e veta kanë të përfshira:

- Lëndën e përkthyer, *“Doktrina e Kërshtenë”*, nga vepra homonime e Roberto Belarminos; *“Pasqyra e t’rrëfyemit”*, nga libri *“Specvlum confessionis”* të Emerio de Bonis; *Rituali Roman, një kodifikim ritesh, ceremonish e lutjesh fetare*, ku vihet re se materia tekstologjike e këtij libri vjen e ndërthurur me tekstet e autorit, e cila përbën pjesën më të madhe të teksturës që trashëgojmë prej Budit. Përgjithësisht, nga sa reflektohet në studimet gjuhësore dhe letrare, materiali i përkthyer është përdorur si pasqyrë për të analizuar tekstet e autorit në gjuhën shqipe, pa hyrë shumë në analizën e sjelljes në gjuhën shqipe të akteve të ceremonialeve fetare, madje duke lënë në hije të dyja anët e medaljes, përkthimin si akt dhe praninë e shenjave letrare origjinale. Materia e përkthyer, sidomos për dy librat e parë të shkrimtarit, është parë si fakt gjuhësor dhe dëshmi e ceremonialeve fetare, kryesisht pa e hetuar ende modelin përkthimor të autorit a gjurmët vetjake të pasazheve të përshtatura ose të rishkuara. Andaj, kur përmendet koncepti i pranisë së shenjave të përkthimit, së pari duhet analizuar dhe shqyrtuar lënda që përmendëm më sipër, për të hetuar dhe verifikuar aftësitë e përkthimit të Budit, si dhe për ta përfshirë në kontributin e shkrimtarit, e mandej të hamendësohet se ka gjasa që edhe në shkrimin autorial, të ndeshen stilema ose episode të përkthyer.
- Materia poetike, që përbëhet nga faqet e fundit të librit të parë *“Doktrina e Kërshtenë”*, ku gjenden 19 poezi, e librit tjetër *“Pasqyra e t’rrëfyemit”*, ku ndodhen tri poezi dhe e *“Rituali Roman”*, ku ndodhet vetëm një poezi. Së bashku janë 23 poezi gjithsej, me 3139 vargje në gjuhën shqipe, e organizuar nëpërmjet tetërokëshit trokaik, vargut më të përhapur të poezisë shqipe, si dhe strofës katërshe/kuaternës, me përjashtim të poezisë së vetme që gjendet te *“Rituali Roman”*, e cila ndryshe nga poezia tjetër e autorit, derdhet

me vargje monokolonë, si dhe me tetërokësh të dyzuar, pra me gjashtëmbëdhjetërokësh, një varg që do ta hasim më vonë në vargjet e poemës “*Bagëti e bujqësi*” të Naim Frashëtrit, si dhe në disa poezi të Lasgush Poradecit.

- Materia e prozës së Pjetër Budit, e cila përbëhet nga parathënie, pasthënie dhe sidomos proza epistolare/letërkëmbimi (më i përhapur si shkrim), mbërrin në rreth 170 faqe, e shtrirë në të tre librat, si dhe në lëndën e librit më vete “*Kush thotë meshë këtë kafshë i duhet me shelbuom*”, që është analizuar dhe madje theksohet se si me këto tekste ka zënë fill proza shqipe, ndonëse nuk ka mbërritur në duart e lexuesit, ashtu si poezia e botuar në vitin 1986.

Pamja e librave të shkrimtarit, e lëndës përmbamëse të secilit sosh, më në fund na kthjellon se Pjetër Budi ka përkthyer dy libra, si dhe disa tekste rimesh, gjë që është pohuar si fakt, por shkalla e shqyrtimit të teksteve të përkthyer, të materies së përkthyer, është në nivele fillimtare, me përjashtim të pohimeve të bëra nga studimet gjuhësore dhe ndonjë hamendësim i përkthyesve, që realisht nuk e njohin letërsinë e hershme, po kaq edhe veprat e Budit, se nga janë marrë si tekste, gjithnjë duke mbetur në rrafsh hipotetik. Në mesin e përkthyesve që janë marrë me përqsasjet ndërtekstore, do të veçoja Robert Elsie, për rropatjet e tij për të përqsasur një poezi të Budit, me poezinë Thomaso a Celano (1200: 1255), për të cilin në librin *Poetika e Budit*, botuar në vitin 2002, nga ana ime është bërë një interpretim mbi pamundësinë e lidhjes së vargjeve të Budit, sepse ai vetë në parathënien e librit *Doktrina e Kërshtenë*, pohon se i ka marrë te Pal Hasi, e jo në tekstin latinisht që përmend Elsie. Për më gjatë, përqark kësaj situatë, mundet të konsultohet libri, ku është dhënë një përgjigje mbi një krahasim qartësisht të hamendësuar. Vijimi i të tjerëve, në këtë hulli të pagjasshme, në rastin e kësaj poezie, nuk është se zgjeron gjasat e përkthimit të poezisë së autorit tonë, e prandaj nuk meritojnë vëmendje për të ripohuar të njëjtën rrethanë, që nuk ndërlidhet me rrethanat dhe kontekstet shkrimore me vargjet e poezisë së Budit<sup>[2]</sup>. Materia e përkthyer, e pranishme në librat e shkrimtarit, ende pret që të përfshihet në trashëgiminë përkthimore të shqipes, po kaq të ndihmesës së dhënë prej Budit në lëmin e përkthimit. Rrethana e pranisë së lëndës së përkthyer, në bashkëlidhje me tekstet e shkrimtarit, ka gjasa që të jetë bërë shkas edhe për “shpjegimin” e pamjaftueshëm të natyrës së poezisë së autorit, madje për pohime që nuk zbehin praninë e poezisë, por vënë në dyshim rrafshet e leximit të saj, prej atyre që vënë në dyshim shenjat origjinale të poezisë së Budit, duke projektuar më tepër hamendësimet e shqyrtuesve.

Përcaktimi si vlerë letrare i teksteve me poezi dhe prozë, ka bërë udhë të gjatë, madje ka njohur kurba uljengritjesh, të cilat kanë krijuar jo pak mjegullnajë, sikur kemi më tepër një hartues librash të përkthyer dhe jo një autor origjinal, madje duke këmbëngulur në pamundësinë e hartimit të poezive prej autorit, gjithnjë si shqyrtime jashtëtektore. Përqark kësaj “tymnaje”, të ngritur me kontributin e akademizmit të botëkuptimit antifetar, si dhe të disa përkthyesve që lëvizin në hipoteza, larg tekstit dhe kontekstit shkrimor të Budit, pra pa e lexuar gjithë poezinë e tij, e cila ngahera duket dhe zhduket në skenën e studimeve albanologjike, me interes është pohimi i bërë nga Zef Skiroi, njëri prej njohësve të parë të librave të Budit, i cili shprehet pa asnjë ekuivok: “... është e çuditshme se prej atyre që kanë thënë, ndoshta edhe me mospërfillje olimpike, ndonjë fjalë rreth Doktrinës së Budit askush të mos ketë ndjerë detyrën (përgjegjësinë) për të vënë në rëndësinë e duhur faktin që 110 faqet e fundit të saj përmbajnë 2884 vargje, pothuaj gjithnjë të zbritshme, të rradhitura në 721 kuartina me rimë të alternuar...”<sup>[3]</sup>

Megjithatë, pavarësisht rrethanës rastësore, që me letrarësinë e teksteve të letërsisë së hershme, por edhe të trashëgimisë letrare, në poezi dhe prozë të Budit, janë marrë më së shumti filologët, mbase për shkak të vështirësive të rrafshit filologjik që bartin librat e asaj periudhe, asnjëherë nuk janë përjashtuar mundësitë e shenjave artistike në librat e shkrimtarit, pra edhe në shkrimin e poezive, në mënyrë të posaçme. Nëse për prozën, nga studimet e mëparshme, qysh me Mario Rok, Gaetano Petrotta, Gunar Svane, Faik Konica, Zef Skiroi, Kolë Ashta, Selman Riza, Eqerem Çabej, Mahir Domi, Dhimitër Shuteriqi etj., janë hedhur mendime të qarta, shpesh të shoqëruara me argumente, mbi ndonjë element artistik, trashëgimia poetike, e cila gjendet në tre librat e autorit, përkundrazi është parë me mëdyshje, madje në kohët e vona, është vënë në dyshim origjinaliteti i poezive të shkrimtarit, duke notuar në situatën e përkthimit dhe të përshtatjes, si një hipotezë që mbetet larg tekstologjisë së shkrimit të poezive, pavarësisht mbizotërimit të ngjyresave fetare.

Më herët, dritëhijet e trajtimit të poezisë së Pjetër Budit, marrin përgjigje të plotë në një punim mbi poezinë e autorit, në vitin 1949, nga Henrik Lacaj, ndonëse kjo qasje e thelluar studimore ende nuk ka mbërritur te lexuesi. Më vonë, shqyrtimi dhe vlerësimi i poezisë së Budit përplotësohet me shqyrtimet e S. Rizës, I. Rugovës, R. Smjalit, S. Hamitit, Z. Neziri, M. Hysës, A. N. Berishës etj. Alternativa e përcaktimit të poezisë, e pranisë së shenjave estetike, që trashëgohet nga librat e Pjetër Budit, përsëri mbeti në një situatë të përzier, që është përkthyes dhe përshtatës më shumë sesa poet. Për të hedhur dritë, mbi dyshimin e

mungesës së plotë të origjinalitetit në poezinë e shkrimtarit, paraqet interes verifikimi i metodave të përdorura për leximin dhe interpretimin e teksteve me poezi. Në qasjen ndaj poezishkrimit të Budit kanë mbizotëruar këto mënyra:

- Leximi i trashëgimisë poetike vetëm si fakt gjuhësor dhe historik, sidomos në momentet e para të rënies në gjurmët e librave të autorit, gjë që lidhet ngushtësisht me rrethanat e zbulimit dhe të pranisë së tyre në jetën e shqiptarëve dhe po kaq edhe në dëshmitë e pranisë së letërsisë shqipe. Kjo situatë e paragjykimit, institucional dhe jashtëtekstor, të shenjave artistike të poezishkrimit rimerret edhe pas viteve '50 të shekullit të kaluar, kohë që përkon me fillimin e goditjes së variantit të gegnishtes dhe arbërishtes, e cila kulmon në vitet '76, kur vihet në dyshim dhe përjashtohet çdo shenjë vlerash artistike në shkrimin e poezisë së P. Budit, udhëhequr kryesisht nga botëkuptimi përjashtues i fetares.
- Leximi antifetar, që ka mbizotëruar për shumë kohë në mjediset akademike dhe universitare, për shkak të karakterit të tematikës fetare në këto libra, veçanërisht me vendosjen e sistemit monist në Shqipëri, që nxjerr krye në analizën e poezisë së tij, e cila zhvleftësohet pa asnjë argument. Në tekstin "*Historia e Letërsisë Shqiptare*", botim i Akademisë së Shkencave, ku duket se merr udhë përfundimtare kodifikimi i leximit me kufizime ideore të shkrimit poetik të Budit, po ashtu të letërsisë së hershme shqipe, në mes tjerash nënvizohet: "... duke mos qenë shprehje artistike e një qëndrimi të caktuar ideor emocional ndaj jetës, nuk mund të quhet letërsi në kuptimin e mirëfilltë të fjalës."<sup>[4]</sup>, duke vendosur vulën përfundimtare të qëndrimit zyrtar ndaj poezisë së Budit, e cila nxjerr jashtë loje përfundime që merren nën hijen e betejës së monizmit, se feja është opium. Po në këtë tekst, kinse shkencor, me kahje të zbatimit të platformës përjashtuese të letërsisë së shkruar në gegnisht, kemi edhe pohimin që shërben si një optikë zyrtariste, për mënyrën se si duhet lexuar dhe trajtuar krijimtaria letrare e Budit: "*Veprat e Budit janë në pjesën më të madhe përkthime të lira dhe përshtatje.*"<sup>[5]</sup> Formulim unik në llojin e vet, për të lënë në hije shkrimin poetik të autorit, si një hipotezë që nuk ka asnjë lidhje me librat e Budit, lëshuar nga mendimi shkencor zyrtar, bazuar në shkencën e monizmit, që fetaren e shihte si antivlerë, e cila zbulon rrënjët kohore dhe ideore se kur ka nisur mëdyshja e vënies në dyshim të pranisë së vlerave artistike në shkrimin poetik të Budit. Kjo situatë institucionale, madje e nivelit më të lartë të mundshëm, e verifikimit dhe shqyrtimit të akademizmit të lidhur më

idologjinë komuniste, nuk lë shumë hapësirë për të kuptuar semantikën e përjashtimit të secilës vlerë të veprave të autorit, parashikuar nga dogma e realizmit socialist dhe botëkuptimi zyrtar, i cili fetaren e shihte si opium që shkatërron vetëdijen e njeriut.

- Leximi filobiblik, që ka mbizotëruar në studimet letrare në Kosovë, i cili kohëve të fundit u projektua edhe si shkolla filobiblike, një shtjellim i gjerë, kinse akademik, që megjithatë vjen pa argument të plotë bindës prej Sabri Hamitit, për të gjithë periudhat letrare. Nga ana tjetër, lidhur me periudhën e parë dhe vetë historinë e letërsisë shqipe, pavarësisht pikësnyimeve të prekshme didaktike, kryesisht për nevoja utilitare të shkollës së lartë, problematika është më hipotetike. Përcaktimet e bëra, sidomos sa i përket natyrës së shkollës filobiblike, më tepër vijnë në formë të përgjithshme, si dhe të bën përshtypje lënia jashtë këtij formulimi veprën e Buzikut, Matrëngës. *Në këtë shkollë letrare, teksti letrar në shqip, në fakt, është derivim i tekstit biblik, që është universal, prandaj edhe emërtimi karakterizues filobiblike. Madje tekstet letrar zakonisht janë mbrenda librave doktrinarë të krishterë, duke krijuar një shfaqje tjetër të doktrinës. Autori shenjohet, mirëpo statusi i tij ndërron nga përkthyesi, te rikrijuesi e krijuesi. Ligjërimi thuret simbas gjedhes së retorikës e të moralitetit biblik të krishterë. Po ashtu, tematikat zotëruese janë biblike (Besëlidhja e Vjetër e Besëlidhja e Re).*<sup>[6]</sup>

Megjithëse leximi filobiblik i lëndës shkrimore të letërsisë së hershme, ku Sabri Hamiti ka përfshirë veprën e P. Budit, P. Bogdanit dhe të J. Varibobës, krahasimisht me leximin antifetar që përjashtonte çdo element të pranisë së shenjave artistike, shkon më pranë teksteve, përsëri vijon që ta trajtojë fakturën letrare të letërsisë së hershme, kryesisht në këndvështrim tematik, duke i lënë sërish në gjysmëterr shenjat letrare, ato që reflektojnë vlera edhe në poezinë e Budit.

Papërcaktueshmëria e natyrës së poezisë së autorit, madje endja në mëdyshjen e trefishtë dhe hipotetike, të përkthyesit, përshtatësit dhe poetit, është objekti kryesor i ligjëratës, që ka si pikësynim rivënien në fokus të pranisë së poetit në tekstet me poezi. Përpjekja serioze për të gjetur shtegun formal dhe logjik, është e ndërvarur vetëm se nga të mbërrimet e interpretimit të teksteve të poetit, e po kaq në hetimin e gjurmëve të poetikës vetanake, të projektuar në hapësirën e poezive. Me gjithë mundësitë për ta njohur dhe lexuar, shqyrtuar dhe vlerësuar poezinë e autorit, thellimi i qasjeve ndaj trashëgimisë së Budit, më pranë tekstit dhe “vlagës” letrare që përlindet në të, kulmon në vitet ’80 të shekullit të kaluar e në vijim. Krahas shqyrtuesve të hershëm të librave të Budit, të cilët kanë hulumtuar mbi vlerat gjuhësore dhe poetike, për fatin e poezisë së tij, e

rivlerësimit të shenjave poetike, ndikuan dy-tre momente:

**Së pari:** Botimi në vitin 1986 në Prishtinë, i trashëgimisë poetike të Budit, të pjesës së shkruar në gjuhën shqipe, nën përkujdesjen e Rexhep Smajlit. Ky botim, ndërkaq ka njohur edhe botime të tjera, në vitin 2006 dhe 2016.

**Së dyti:** Analiza e hollësishme, interpretimet e gjera tekstologjike, varësisht metodikave dhe teorive të reja, të analizës së letërsisë së mesjetës, si dhe me rëndësi është përfaqësuar me barokun religjioz e poezive të librit “*Doktrina e Kërshtenë*”, nga Zeqirja Neziri në vitin 1995.

**Së treti:** Shqyrtimi i vlerave të poezisë dhe prozës në një situatë përbashkuese të thelluar në të dy shenjat letrare, që përçojnë librat e shkrimtarit, të cilat e vendosin në një ekuilibër të trajtimit të dy anëve të shqiptimit letrar të krijimtarisë së autorit, në vitin 2015, nga Anton N. Berisha.

Në atë qarkëzim të verifikimit dhe vlerësimit të shkrimit poetik të Pjetër Budit dhe Pjetër Bogdanit, të autorëve të letërsisë së hershme, veçohen trajtesat e I. Rugovës, S. Hamitit, A. N. Berishës, M. Hysës etj., gjithnjë jashtë Shqipërisë, të cilat hedhin dritë me argumente të plotësuar mbi aspekte të ndryshme të poezisë së Pjetër Budit, madje duke përmendur e zbërthyer praninë e vlerave artistike në vjershërinë e këtij poeti. Në shekullin e njëzet e një, veçmas të tjerëve, në shqyrtimet e Anton Berishajt, Kujtim M. Shalës, Anton N. Berishës, e ndonjë tjetri, sidomos duke e ndërlidhur vjershërimin e Budit me rrafshet e intertekstualitetit biblik (rikëndimit të biblës), më së shumti dëshmohet qenësia e poetit, si dhe prania e “prushit” të bariut shpirtëror, të shqiptuar përmes fjalës shqipe. Megjithatë në botime dhe interpretime të ndryshme, më tepër si akt jashtëtekstor, si një prirje më e theksuar kjo në Shqipëri, me shumë gjasa një bartje e verifikimit zyrtar, ende nuk e kanë shmangur mëdyshjen nëse Pjetër Budi është poet, madje edhe në shekullin e njëzet e një, mbahet si tezë zyrtare e rëndësishme. Shtrimi i kësaj pyetjeje, lidhet me rrafshet konceptuale dhe me mënyrat e interpretimit të tekstit poetik, veçmas të letërsisë së hershme, në vlerën e një marrëdhënie të komplikuar të tekstit letrar dhe kontekstit shkrimor, të cilat janë të ndërthurura më tepër në bashkëjetesë dhe kundërvënie. Përpara studimeve letrare dhe gjuhësore, jo vetëm për shkrimin letrar budian, por për epokën përlindëse të letërsisë shqipe, e cila shenjëzon plejadën e Buzukut, Matrëngës, Bardhit dhe Bogdanit, të analizës dhe shqyrtimit të librave të tyre, sërish mbetën vjerrë tri momente:

- Bindja e studimeve letrare (e di se në cilën metodikë dhe teori letrare është mbështetur) e të gjithë hapësirave, sipas së cilës poezia e mirëfilltë në letrat shqipe zë fill me Jeronim de Radën dhe Naim Frashërin, duke

lënë anash dhe të shmangur prej hartografisë themelhedhësit e saj, Budin, Bogdanin dhe Matrëngën, ndonëse ky i mbrami me një këngë të përshpirtshme.

- Ende nuk është braktisur situata e verifikimit dhe e trajtimit të shkrimit letrar të periudhës, si tipologji e leximit antifetar të poezisë së Budit, ndonëse ka rënë sistemi monist, që e ka lënë të varur idenë fiktive, sipas së cilës autori, më tepër është përkthyes e përshtatës, sesa poet, duke lënë në mjegull, qoftë aktin e përkthimit, po kaq edhe situatën e teksteve autoriale.
- Deri kur do të funksionojnë “muret prej xhami”, në rrafshet e shqyrtimeve albanologjike, të cilat i kemi ngritur ndërmjet vedi, aq sa edhe gjuha e letërsia, shqyrtimet mbi veprat letrare, të lënë përshtypjen se më shumë janë “republika letrare autonome”, që më shumë ndërkomunikojnë rastësisht, larg bazamentit gjuhësor të shqipes së përbashkët.

Trajtimi ndërkohor dhe hapësinor i poezisë së Budit, që është shoqëruar me uljengritjet e veta, tashmë ka krijuar dy linja të qarta, që megjithatë janë të përkundërta dhe shumë larg njëra-tjetrës, të cilat shkojnë deri në kundërvënie, duke vënë përballë argumentet bazuar në interpretimin e teksteve, me mungesën e leximit të teksteve me poezi të autorit. Linja e parë, e cila rimerr në konsideratë përfundimet e mëparshme të nxjerra nga ana e studiuesve mbi poezinë e shkrimtarit, e shqyrtimit të tekstit, të materies poetike të shkrimtarit, që shfaqet në fillimin e shekullit të njëzetë, shënon një pikë reference të përfillshme në 400-vjetorin e lindjes së Budit, në vitin 1966, e cila bashkëshoqërohet me analiza të thelluara nga filologët dhe studiuesit e letërsisë. Linja e dytë, që ndërkaq shënon dukshëm braktisjen e së parës, e cila formësohet si qëndrim zyrtar mbi poezinë e P. Budit, sidomos në vitin 1976, e cila pason ndalimin e gegnishtes dhe arbërishtes në Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972, rikthen situatën e mosshqyrtimit të teksteve letrare të shkrimtarit, gjë që zbulohet në pohimin e bërë nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë: *“Budi, në shumicën e rasteve, i kushtoi pak kujdes punës me vargun e strofën. Vjershat e tij vuajnë nga mungesa e teknikës në ndërtimin e tyre, nga përdorimi i shpeshtë i fjalëve të tepërta që e rëndojnë stilin. Po nuk duhet harruar se jemi në fillimet e vjerëshërisë artistike shqiptare.”*<sup>[7]</sup>

Kjo rrethanë e leximit të pastër antifetar të vargjeve të Budit, mbase e leximit dogmatik të materies letrare, ndihmon që të kuptosh se në këtë përfundim të pazakontë të Akademisë ka vetëm mohim dhe injorim të mëtesave shkrimore të poetit, që nuk duhet të shpëputen nga kontekstet e kohës së shkrimit, për të hetuar dhe vlerësuar praninë e secilës vlerë. Në



këto përcaktime zyrtare dhe pa argument të thelluara, nuk ka asnjë konsideratë për shkrimin poetik, madje më tepër kemi të bëjmë me një ligjërim jashtëtekstor, pra pa lidhje formale me vjershërimin e Budit. Në anën tjetër, si një shpalim i analizës dhe i interpretimeve të teksteve me poezi të autorit, pasojë e njohjes dhe vlerësimit të shenjave letrare, që sugjerojnë praninë e vlerës letrare në poezishkrimin e tij, kemi vlerësimet e jo pak personaliteteve në kohë dhe hapësirë, të cilët artikulojnë vlerësimin për shkrimin poetik të Pjetër Budit.

Kështu, Mario Rok, njëri ndër njohësit e letërsisë së hershme shqipe, ndër të tjera, shkruan edhe për: "... *shqetësimet intelektuale në poezitë e tij...*"<sup>[8]</sup>, që duket se përcjell një prani të autorit me shtesimet e veta, e rrokshme në hapësirën e teksteve. Selman Riza, njëri nga gjuhëtarët më të shquar, si ndër njohësit e letërsisë së hershme, të veprave të autorëve përfaqësues të saj, të studiuara dhe vlerësuara në të gjithë treguesit, si një kundërshti ndaj qëndrimeve të mbajtura, thekson me forcë: "*Mendimin e ndonjë kritiku se Pjetër Budi paska qenë vjershërues i thjeshtë e jo njëherazi edhe vjershëtor i mirëfilltë shkruesi i këtyre radhëve e gjen të papërpiktë.*"<sup>[9]</sup> Mahir Domi, një filolog i spikatur i bashkëkohësisë, si dhe ndër njohësit e vlerave që përçon e gjithë periudha e letërsisë së hershme, ndër të tjera shprehet: "*Duke qenë edhe autori i parë i prozës origjinale shqipe e po ashtu lëvruesi i parë i vjerëshrisë shqipe...*"<sup>[10]</sup> Në këtë formulim të bërë në vitin 1966, M. Domi nënvizon hapur qenien e Budit si autori i parë i prozës shqipe, por sa i përket materies poetike, më tepër lë një gjendje mjegullësie, duke e lënë pezull shenjimin e vlerës së shkrimit poetik, nga ku duket se merr udhë mendimi i mëvonshëm, për të përjashtuar çdo vlerë artistike, në poezishkrim.

Henrik Lacaj, përkthyesi veprës madhore të Virgjilit, poemës "*Eneida*", si dhe studiuesi më zelltar dhe skrupuloz për të ndriçuar vlerësinë e poezisë së Budit, përveç punimit të detajuar për poezinë (shkruar në vitin 1949 dhe që ka mbetur ende në dorëshkrim, pa mundur që të bjerë në duart e lexuesit), duke e shoqëruar me shqyrtime tekstologjike të përimitësuara, sa i përket figurës dhe pranisë së vlerës në poezi, ka shprehur edhe këto mendime: "... *vendin e një shkrimtari të tillë nuk e la të zbrazët pikërisht Pjetër Budi i cili, përveç një lande aq të vëllimshme në prozë, na la edhe 707 strofa katërshe me rime të alternueme në **Doktrinën e Kërshtenë**, 41 strofa në **Pasqyrën e t'rrëfyemit** dhe një vjershë prej 38 vargjesh me tetërrokësh të dyfishtë në **Ritaulin Roman.***"<sup>[11]</sup>

Martin Camaj, shkrimtari që la Shqipërinë për shkak të kushteve të mbrapshta politike dhe kulturore, me një trashëgimi letrare të vyer në poezi,

prozë dhe dramatikë, si dhe me punime të zgjeruara gjuhësore, në vitin 1966, që përkon me 400-vjetorin e lindjes së Budit, në revistën *Shejzat*, ku qe kryeredaktor dhe pati për editor Ernest Koliqin, shkruan: “*Budi asht poet jo me shumë talent, por asgjamangut farkues i mirë i vargut tetërrokësh.*”<sup>[12]</sup>

Parashtrimi këtu i të dyja linjave, pra që e sheh si poet dhe, që nuk pranon asnjë dëshmi poetike në vargëzimin e poetit, së paku në këtë ligjëratë nuk ka për qëllim evidentimin e pengesave ose numërimin e mungimeve të vëna re në leximin dhe analizën e poezishkrimit të shkrimtarit, porse vetëm nxitjen e thellimit të njohjes dhe të argumentimit se në poezinë e autorit ka materie letrare, ku gjellin fryma origjinale e shkrimit poetik. Po ashtu, të marrin fund hipotezat dhe hamendësimet e ndryshme, që hidhen në shtypin letrar, pa lexuar librat e shkrimtarit, ku gjellin poezi dhe proza autoriale. Prania e magjisë së gjurmëve të shkrimit vetanak, me dëshmi të vlerave artistike, në prozë dhe poezi, ka mundësuar që të hyjë në historinë e letërsisë shqipe si poeti dhe prozatori i parë i shkrimit të kultivuar në letrat shqipe, gjithnjë e shenjuar me katër libra të shkrimtarit. Ligjërata jo pak e gjatë, pohuese dhe kundërshtuese, nihiliste dhe pa sjellë argument, aq më tepër që përbën vetëm se një kujtesë të rimarrë nga trajtimet e mëhershme, sidomos të rrethanave dhe konteksteve të leximit antifetar, ka mundësuar idenë mbizotëruese se leximet e pranishme jashtëtektore, vijojnë që ta mbajnë vjershërimin e Budit jashtë rrjedhave të poezisë së kultivuar, ende në shekullin e njëzet e një. Koncepti hipotetik dhe pa shpjeguar asgjë mbi këtë qasje, i përcaktimit të poezisë, kinse të mirëfilltë në letrat shqipe dhe, që gjoja zë fill me veprën poetike të De Radës dhe të Naim Frashërit, duke lenë shtegun djerrë, sikur paska edhe poezi të pamirëfilltë, që do të vinte në dyshim jo vetëm dijen letrare, por edhe praktikën e leximit të letërsisë dhe poezisë. Emërtimi për poezinë e mirëfilltë, duke qenë një pistë zyrtare dhe akademike, detyruese e vepruese, për mjediset universitare dhe shkencore, prej kaq kohësh ka krijuar pasoja:

- Pa asnjë argument të analizës tekstologjike dhe stilistike, të dijes dhe praktikës së receptimit të shkrimit, përjashton nga leximi dhe verifikimi vlerat letrare të thurura në librat e Buzukut, Matrëngës, Budit, Bardhit, Bogdanit, aq sa janë, pa shtuar dhe hequr asgjë nga shenjat tekstologjike. Kështu, me këtë optikë të “ndalimit dhe përjashtimit” të librave të kësaj periudhe, lë jashtë historisë së dëshmimeve letrare periudhën e parë të letrave shqipe, si dhe humbet nga gjurmët e letrares shekujt 16-17-18, duke i kapërcyer ato në shekullin 19.

- Vë në zgrip ekzistencial shtegtimin e gegnishtes, variantit përlindës të gjuhës shqipe, e dokumentuar me libër me “*Mesharin*” e Gjon Buzukut, po

kaq edhe të arbërishtes, që zë fill me E mbasme e Kërshtenë, të Lek Matrëngës, gjë që lë hapësirë të pamatshme, të ndarjes së vlerave gjuhësore të këtyre dy varianteve të shkrimit të gjuhës shqipe.

Në anën tjetër, mbajtja në fuqi e hipotezës se Budi është më tepër përkthyes dhe përshtatës, sesa poet, duke lënë kështu në hije qasjet dhe interpretimet e mëparshme, të gjuhëtarëve dhe studiuesve më në zë të letërsisë së hershme, të vlerave të shumëfishta, tashmë duhet kapërcyer, më shumë për shenjat letrare të sendërtuara në gjuhën shqipe, sesa për vetë autorin. Ky qëndrim në marrëdhëniet me tekstet e shkruara, do të ndikonte për të shkuar në cakun e fillimit të letërsishkrimit, për ta bërë pjesë të panteonit të letrave shqipe. Shkrimi i gjuhës shqipe, në shekullin e 16 me librin e Buzukut “Meshari” dhe të Matrëngës “E mbsuame e Krështerë”, në shekullin e 17, me librat e Budit, Bardhit dhe Bogdanit, dëshmon se e kemi një njësi unike të shqipes, si një bashkëshkrim, të faktit gjuhësor dhe historik, që përçon edhe vlerat letrare dhe përkthimore, që duhet vendosur në ato kontekste, dhe mbi të gjitha duhet lexuar dhe interpretuar duke u bazuar në diskurin letrar, që në të gjitha rastet diskurin fetar nuk e përjashton si vlerë, përkundrazi e kundron si njëri ndër rastet që konfirmon praninë e shenjave letrare. Nëse Bibla është libri i librave, për secilin njohës të atij teksti, si mundet që të kemi drojën për ta parë, lexuar dhe zbuluar, shenjat e tilla, në librat e shkrimtarëve tanë, të shekujve të mesjetës së vonë, që morën shkas nga Dhjata e Vjetër dhe e Re, duke indentifikur ekzistencën e gjuhës shqipe, si gjuhë e shkruar, si gjuhë e letërsisë dhe kulturës!

## PËRFUNDIME

Varësisht mbërrimeve të studimeve gjuhësore dhe letrare, për të përçuar bindjen se ligjëratat pati si funksion vetëm me qartësuar sadopak fatin e poezisë së shkrimtarit, si dëshmi e vlerave artistike, të enduara nga poeti në tekstet e shkruara, mund të formulojmë ndonjë konkluzion:

- Në rastin e shkrimit poetik të Budit, kemi një situatë poetike vërtet komplekse dhe të ndërthurur, të teksturës origjinale dhe të rishkuar (term i Selman Rizës), e cila nuk është se e përjashton përkthimin ose përshtatjen, por mbetja e prurjes së shkrimit poetik, vetëm në këto dy rrethana, që përjashtojnë praninë e poezisë origjinale, është e papranueshme për vetë situatën e poezive të autorit.
- Forma më tipike dhe më e shtrirë në vjershërimin e Budit, por edhe të shkrimtarëve të tjerë të letërsisë së mesjetës së vonë, është hartimi i poezisë si rikëndim i Dhjatës së Vjetër dhe të Re ose si një modelim vetanak, që bart shenjat e origjinalitetit, si frymë e asaj tipologjie në

ndonjë poezi tjetër të librave të shkrimtarit. Për këtë tip poezie, pra si rikëndim i materies së huamarrë nga Bibla, interes të veçantë zgjon këndvështrimi i Anton Berishajt, e cila shtejllohet gjerësisht në librin *Letërsia Performative*, për letërsinë e vjetër, kur mes tjerash thekson: “... tekstualiteti i letërsisë së vjetër shqipe me dimensionin e tij polisemik, si një diskurs religjioz dhe si program tekstual që qëndron në themel të Letërsisë.”<sup>[13]</sup>, çka përpos rivlerësimit të lëndës shkrimore të kësaj letërsie, ndërkaq tepër e rëndësishme është situata kur në mes tjerash, pa asnjë ekuivok, sugjeron kodin e verifikimit të kësaj letërsie, po kaq edhe të poezisë së Budit, si një mënyrë e hetimit të gjurmëve letrare.

- Prania e poezisë origjinale të Budit, e cila nuk ka asnjë shans për ta ndërldhur me situatat e përkthimit, megjithatë shpaloset në disa poezi të autorit, të rrokshme në të tre e autorit. Fillimisht po përmendim poezinë 17 të “*Doktrinës së kërshenë*”, me 150 vargje gjithsej, ndër të cilët:

*Tu 'pam gjithë të keqtë  
Aqë idhunë e helumom  
Ke nd'arbënë shtiu leqtë  
Dialli i mallëkuom.*<sup>[14]</sup>

Te këto vargje, të shkëputura nga materia e kësaj poezie, sidomos nëpërmjet përmendjes së fjalës *arbënë*, pra që shoqërohet me përcaktimin e vendit, ku ndodh kataklizmo e konvergimit fetar të dhunshëm, dëshmohet për një situatë të qartë të hartimit të një poezie autoriale, nga ana e P. Budit. Po ashtu, në poezinë e tetëmbëdhjetë, me titullin e hapur, *Për ndihmë të gjithë kërshënimit Arbënit*, me 145 vargje, ndeshet problematizimi i kësaj gjendje, dhe mbi të gjitha vihet re se udhët e ndryshimit kërkohen me anë të fjalës, të librit që shërbën si një pasqyrë, ku ndeshim edhe thirrjen:

*N'dorë e merri, e këndon  
Iu qi dini me kënduom  
Vini veshët e ndëgjoni  
Iu qi dini me ndëgjuom.*<sup>[15]</sup>

ku ndërkaq kalohet në një moment tjetër, që ka të bëjë me fatin e krishtërimin në Arbëni, por edhe ku përcillet mesazhi i rëndësishëm të librit, i nevojës për ta vlerësuar dhe përthithur atë, sidomos në kuaternën e përveçuar, që e sollëm në këtë ligjëratë, si fakt të lavrimit të poezisë unike të poetit.

Në poezinë e nëntëmbëdhjetë të librit të parë që trashëgojmë nga shkrimtari, e cila ka vetëm 23 vargje, kemi edhe situatën e mëposhtme, e cila thëllon praninë e rrafshëve të subjektivitetit të gjurmëve të poetit:

*Qi më dhe kaqë hir  
Këtë kafshë me mbaruom,  
Si e paçë zanë fill  
Gjithë herë tue shkruom,<sup>[16]</sup>*

Në këto vargje të hapura si kumt ndeshim një linjë të shqiptimit të pastër të marrëdhënies së poetit me aktin e shkrimit, të poezisë që shqipton shestimet e poetit, të shqiptimit të ngasjeve kreative thelbësisht subjektive, e cila mundëson projektimin e ngjyresave personale. Një situatë e afërt ligjërimore shfaqet në vargjet e poezisë së tretë, që gjendet te libri “*Pasqyra e t’rrëfyemit*”, e përbërë nga 117 vargje gjithsej, ku ndër të cilët veçiam:

*Nd’ Arbënë me ua dërguom  
Sikur një pasqyrë,  
Ndë të cit tu shukuom,  
Të nçilen ma mirë,<sup>[17]</sup>*

Kuaterna e kësaj poezie të njëmendtë si shenjzim autorial, sërish vendos pika kontakti me vendin/Arbënë, si dhe me dobinë e kundrimit të librit/vargjeve, si një pasqyrë e shoqëruar, me përdhyerje shëmbëllimi, që përpos të tjerash ndikon fuqishëm për ta kuptuar botën përqark. Te poezia e vetme që gjendet në “*Rituali Roman*”, me 39 vargje 16-rrrokëshe apo me 8-rrrokësh të dyzuara, ndërkohë që aty rimerret shqetësimi i autorit për besimin në Arbëni:

*Këtë kafshë me mbaruom: qi e paçë për detyrë  
Natë e ditë tue shkruom: zemëra më gjet’ të lirë,  
Shokëvet me ua dërguom: sikur një pasqyrë,<sup>[18]</sup>*

Në vargjet e kësaj poezie, nga më të veçantat në trashëgiminë poetike të Budit, e cila përçon dy ndryshime thelbësore në poetikën shkrimore, si mënyrë vargëzimi, me shkrimin e vargjeve monokolorë, si dhe kapërcimin e stilems së tetërrokshit në tetërrokësh të dyfishtë ose të një stileme poetike me 16-kësh, rimerret situata e vlerësimit të librit/poezive, që e ndeshim edhe në poezitë e librave të tjerë.

Pra, nga sa vihet re, prej shtjellimit vetëm në rrafshin e poezive origjinale, që nuk kanë asnjë lidhje me përkthimin apo përshtatjen, vihet re se pesë poezi dhe 475 vargje janë të Budit, madje në mënyrë të padiskutueshme. Trashëgimia tjetër, e shkrimit poetik, që gjendet në tre librat e autorit, e huamarrë apo e përkthyer, si një pistë hipotetike, që deri më tani nuk ka marrë përgjigje të argumentuar, është rishkruar në poetikën e tetërrokshit trokaik, duke mishëruar kështu tiparet e poetikës së shqipes së autorit. Në këtë logjikë, e gjithë trashëgimia poetike në gjuhën shqipe, me gjasë e përkthyer/e rikënduar nga motivet e Biblës, Dhjatës së Vjetër apo asaj të Re, vjen e shqiptohet më tepër si e rijetësuar, madje që bartet në

të gjithë pentagramin e poezisë shqipe të mëvonshme, veçmas si poetikë e tetërrokëshit.

#### BIBLIOGRAFI

1. Selman Riza: *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Tiranë, Toena, 2002, f. 91.
2. Behar Gjoka: *Poetika e Budit*, Tiranë, Albas, 2002, f. 160-161.
3. Gaetano Petrotta: *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*, Palermo 1932, faqe 27.
4. *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë 1976, f. 4.
5. *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë 1976, f. 26.
6. Faqe internet, *Shkollat letrare shqipe*, Sabri Hamiti, <https://ëëë.scribd.com/.../SHKOLLAT-LETRARE-SHQIPE-Albanian-literary-school...f.3>.
7. *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë, botim i Akademisë së Shkencave, 1976, f. 27.
8. Mario Rok: *Gjurmime mbi Tekstet e Vjetra Shqipe e shkrime të tjera*, Shkodër, Botime Françeskane, 2011, f. 27.
9. Selman Riza: *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, (shkruar në vitin 1964 fillimisht si tekst universitar), botuar në 1996 në Prishtinë dhe në vitin 2002 Toena, Tiranë f. 178.
10. Mahir Domi: *Pjetër Budi*, Tiranë, botim i Muzeut Historik Kombëtar, 2008, f. 206.
11. Henrik Lacaj: *Pjetër Budi*, Tiranë, botim i Muzeut Historik Kombëtar, 2008, f. 217.
12. Marin Camaj: *Pjetër Budi*, Tiranë, botim i Muzeut Historik Kombëtar, 2008, f. 115.
13. Anton Berishaj: Anton, *Letërsia performative*, Prishtinë, Buzuku, 2010, faqe 39.
14. Pjetër Budi: *Poezia*, Prishtinë, Rilindja, 1986, f. 241.
15. Pjetër Budi: *Poezia*, Prishtinë, Rilindja, 1986, f. 253.
16. Pjetër Budi: *Poezia*, Prishtinë, Rilindja, 1986, f. 263.
17. Pjetër Budi: *Poezia*, Prishtinë, Rilindja, 1986, f. 277.
18. Pjetër Budi: *Poezia*, Prishtinë, Rilindja, 1986, f. 281.

#### Pjetër Budi – translator, adapter or poet?

##### ABSTRACT

This article delves into the literary legacy of Pjetër Budi, exploring the longstanding debate over his identity as a poet, translator, and adapter. Through examining Budi's poetic and prose contributions, particularly his works "Doktrina e Kërshtenë," "Pasqyra e t'rrëfyemit," and "Rituali Roman," the study highlights his role in pioneering Albanian literary expression. The analysis considers the layered interpretations of Budi's texts, emphasizing his influence on the Albanian language and literature amid religious and cultural constraints. The article also critiques previous interpretations that either minimized Budi's originality or reduced his literary value to translation and adaptation. By reevaluating the artistic and poetic qualities present in Budi's oeuvre, this research reaffirms his position as a foundational figure in Albanian literature and challenges reductive perspectives influenced by historical and ideological biases. The discussion is supported by recent philological studies, intertextual analyses, and a broader context within Albanian and medieval literature.

Vilma PROKO-JAZEXHIU

## FJALË TË URTA NGA AREALI ARBËRESH

Fjalët e urta janë thënie të shkurtra e zakonisht të figurshme që shprehin në mënyrë të ngjeshur mendime e gjykime të nxjerra nga përvoja popullore për ngjarje, dukuri e çështje të ndryshme. Në letërsinë folklorike quhen edhe *proverba*, njihen edhe si *fjalë të moçme*. Fjalët e urta e shprehin mendimin në forma të ndryshme si përfundim logjik, si parim, si ligj, si këshillë etj., duke përgjithësuar praktikën shumëshekullore të punës e të jetës, ato paraqiten si të vërteta me vlerë të përhershme. Repertori i tyre lëviz bashkë me mendimin popullor, të kushtëzuar historikisht. Tematika e fjalëve të urta është shumë e gjerë dhe e larmishme dhe përmban një lloj kodi të moralit dhe të enciklopedisë së filozofisë popullore. Sintetizmi, karakteri përgjithësues, mënyra figurative e disa herë e tërthortë e shprehjes bëjnë që ato të përdoren edhe me shumë kuptime.

Dihet që mbledhësi i parë i fjalëve të urta shqiptare është Frang Bardhi me proverbat e botuara në *Fjalorin latinisht-shqip*, 1635, të cilat janë edhe përpjekja e parë që njihet për mbledhjen e folklorit shqiptar, ndërsa botimi më i rëndësishëm ka qenë dhe mbetet “Fjalë të urta të popullit shqiptar”, botuar në Tiranë më 1983.

I. Në këtë trajtesë do të përiqemi të sjellim një kontribut modest, sadoqë minor, për rinxjerrjen në pah, mbledhjen, sitemimin dhe përhapjen e arealit të pasur të provervave arbëreshe, të cilat përbëjnë begati të folklorit dhe të kulturës arbëreshe, përmes të cilave Arbëreshët ruajtën dhe zhvilluan tharmin e tyre të stërlashtë iliro-shqiptar. Fjalët e urta përbëjnë visare dhe dëshmi vijimesie të gjallimit gjuhësor dhe vreshtar-verëtar-enogastronomik arbëresh, - thotë prof. Andrea Shundi në librin *E(t)nogastronomia arbëreshe*<sup>1</sup>, - shprehin urtësinë dhe mishërimin e këtyre veprimtarive ekonomike, jetësore dhe begatuese të arbëreshëve; për më tepër, mjeshtërinë dhe kulturën e punës e të jetesës së tyre, e filozofojnë dhe e ndriçojnë më tej.

Temat kryesore që trajtojnë fjalët e urta arbëreshe janë: atdheu, karakteristikat e arbëreshit, morali, puna dhe mjeshtëritë, familja, marrëdhëniet shoqërore, dukuritë meteorologjike etj. Studimi i prof. F. Altimarit “Proverba meteorologjike të arealit arbëresh”<sup>2</sup> na jep dije të plota

<sup>1</sup> A. Shundi, *E(t)nogastronomia arbëreshe*, "Vilamasi", Tiranë, 2016. f. 370.

<sup>2</sup> F. Altimari, *Proverbi meteorologici di area arbëreshe*, në: “Francesco Altimari - Studia Linguistica Italo - Albanica. Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian”. ASHAK, Libri 51. Prishtinë, 2014, f. 236.

për fjalët e urta dhe thëniet që kanë të bëjnë me parashikimet e dukurive atmosferike të lidhura me besimet popullore, bestytnitë dhe magjinë tipike e një realiteti, historikisht me një konotacion të fortë fshatar dhe pjesërisht baritor, si ai arbëresh, me origjinë ballkanike, por që për më shumë se pesë shekuj ka qenë në kontakt të ngushtë gjuhësor e kulturor me realitetin jugor italian. Përmes analizës së tyre, duke u përqendruar kryesisht në zonën e Kalabrisë, e cila është edhe më kompakte dhe më e shumta për nga numri i komuniteteve arbëreshe (25 nga 50) dhe numri i shqipfolësve (afërsisht 50,000 krahasuar me 100,000 shqipfolës të pranishëm në Itali, sipas F.A.) bëhen krahasime edhe me zonat shqipfolëse të krahinave të tjera të Italisë së Jugut, si dhe me komunitetet arvanite të Greqisë.

Një varg fjalësh të urta që lidhen me veprimtarinë enogastronomike arbëreshe ndeshim në librin *E(t)nogastronomia arbëreshe*, ku shtjellohen edhe 625 receta gjellësh dhe ëmbëlsirash<sup>3</sup>. Sa mbushullim fjalësh të urta dhe zakonesh për një veprimtari të caktuar, - do të shprehej prof. Emil Lafe në veprimtarinë e përrurimit të kësaj monografie në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave, në vitin 2017, - që janë ruajtur e janë përpunuar më tej nga një bashkësi vetëm prej disa qindra mijë Arbëreshësh në Itali!<sup>4</sup>

Studiuesi Shundi i ka mbledhur me kujdes dëshmitë e ndryshme historike për traditën e vreshtarisë tek Arbëreshët e Kalabrisë gjatë tri ekskursioneve hulumtuese në vitet 2011-2013. Më pas ka gjurmuar e ka studiuar një varg artikujsh, librash e dokumentesh arkivore, nga të cilat ka mbledhur një lëndë të pasur. Puna ka vijuar duke shkelur me këmbë ngulimet arbëreshe, duke dëgjuar me kujdes rrëfimet e atyre që merren me punët e vreshtit, të verës e të gatesave dhe duke prekur me dorë e duke ngjerruar nga pak ato që pastaj i ka përshkruar në libër.

Përbën interes për studimin tonë kreu IX që përmban fjalë të urta e zakone të Arbëreshëve të Kalabrisë e të Sicilisë për vreshtarinë, verëtarinë dhe enogastroniminë (rreth 720 njësi), si: *Duhi mir si buka e vera! Dhria isht mbretëresha e pemëve. Oj e bukura si vera! Grur shum e ver shum. Pa ardhur gushti, nuk piqet mushti.*

Në pjesën e dytë të librit gjejmë qëmtime dhe mbledhje anekënd e me thellime studimore, lidhur me fondin terminologjik që përdoret në veprimtarinë enogastronomike arbëreshe, si edhe ndërlihdjet e huazimet e ndërsjella të tij me gjuhën shqipe dhe me gjuhën italiane. Në to, krahas pasurisë gjuhësore dhe folklorike (terma, sinonime, fjalë të urta e thënie<sup>5</sup>,

<sup>3</sup> A. Shundi, *E(t)nogastronomia arbëreshe*, "Vllamasi", Tiranë, 2016.

<sup>4</sup> E. Lafe, *Shëjzat S.n.* 2017, nr. 1-2, f. 280-283.

<sup>5</sup> Po aty, “Fjalë të urta dhe zakone arbëreshe që lidhen me vreshtarinë, verëtarinë, enogastroniminë”, f. 369-377, si edhe 600 fjalë të urta dhe thënie arbëreshe në faqet



tradita e zakone etj.), shqyrtohet dhe pasuria gjenetike (kultivarë dhe ekotipa hardhie), duke i parë në vështrimin filologjik dhe enogastronomik.

Meqë para pak kohësh profesori i nderuar Andrea u nda nga jeta gjej rastin që në nderim të tij të risjell në vëmendje një fragment të një kumtese që kam mbajtur në vitin 2021: Me këtë vepër prof. Andrea Shundi ka hyrë në familjen dhe në kuzhinën e vëllezërve arbëreshë; ushqehet me ta në tryezën e miqve; pi verë nga rrushi i vreshtit arbëresh; bashkëkuvendon dhe bashkëpunon me homologët arbëreshë në mënyrë që të fuqizohen studimet dhe botimet në fushën e gjuhës, kulturës e traditave arbëreshe, në kushtet e sotme të një rreziku potencial bjerrjeje të arbërishtes dhe shpreson që enogastronomia arbëreshe të jetë lartësuar siç i takon "në qelqe të verës dhe në ajkën e gatimeve"<sup>6</sup>.

II. Në vijim të kësaj parashtrere po paraqes një kontribut modest me një tufë proverbash arbëreshe të vjela nga revista "Shêjzat" (1957-1974) e Koliqit, për t'i shërbyer sadopak nismës së vlefshme për mbledhjen dhe evidentimin e proverbave arbëreshe, të ndërmarrë nga prof. Emil Lafe prej disa vitesh, si edhe nga disa studiues arbëreshë, anëtarë të FAA (Federazione Associazioni Arbëreshe).

Për herë të parë te numri i parë i vitit 1957 hasim nënrubrikën *Kokrra krype arbnore*, e cila vijon deri te numri 3-4 i vitit 1959. Në numrin 7-8 të vitit 1959 hasim nënrubrikën *Kokrra krype arbreshe* (ndryshon mbiemri *arbnore* me *arbreshe*), në numrin 9-10 të vitit 1959 këtë nënrubrikë e ndeshim në trajtën *Fjalë t'urta arbreshe* (ndryshon togfjalëshi *kokrra krype* në *fjalë t'urta*); nga numri 9-10 i vitit 1961 e deri te numri 9-10 i vitit 1961 e gjejmë në trajtën *Fjalë e thënie të urta*; ndërsa në numrin 9-10 të vitit 1962 në trajtën *Fjalë t'urta t'Arbreshvet të Kalabris*.

---

378-394. Sipas autorit, në shënimim e fq. 394 marrim dijeni që në to përfshihen edhe fjalë të urta arvanitase dhe fjalë të urta arbënore nga Diaspora shqiptare në Dalmaci.

<sup>6</sup> Kumtesë e mbajtur në konferencën XXV vjetore "Gjuhët e rrezikuara dhe diaspora. Studimet dhe stadi i arbërishtes si gjuhë e rrezikuar", organizuar nga Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët&Fondacioni për Gjuhët e Rrezikuara (FEL), mbajtur në Tiranë më 16-19 dhjetor 2021. (V. Proko-Jazexhiu, *Konsiderata të shkurtra për termat e e(t)nogastronomisë arbëreshe, si pasqyrim i forcës së gjuhës – (Reflektime mbi monografinë "E(t)nogastronomia arbëreshe" e Andrea Shundit, botuar në: "Continuum", Revistë e studimeve arbëreshe (e përvitshme). Numër special: Gjuhët e rrezikuara dhe diaspora. Studimet dhe stadi i arbërishtes si gjuhë e rrezikuar. (Pjesë nga Aktet e Konferencës Vjetore XXV. Fondacioni për Gjuhët e Rrezikuara). QSPA&FEL, Viti II, nr. 2. Tiranë, 2022, f. 182-190).*

### 1. *Kokrra krype arbnore*

Gjykò, pa vra.  
 Dalë ngadalë aguridhja bëhet mjaltë.  
 Mâ mirë në vorr se gjallë për hor.  
 Paraja vihet, por nderí s'vihet.  
 Mâ mirë një i marrë taman se një i meçem përgjysë.  
 (“*Shêjzat*” 1957, nr. 1, f. 18)

Kur m’u dogjen mullarët, njofta ndrikullat e kumbarët<sup>7</sup>.  
 Fjal’ e thënë, gur i shtënë.  
 I përtuari, i mjeruari.  
 Kush qoftë i zoti, mos i shkoftë i zí moti.  
 Besa e burrit, pesha e gurit.  
 S’bëhet vreshti me urata, por me shata e me lopata.  
 (“*Shêjzat*” 1957, nr. 2–3, f. 63)

Syni i lig shef keq gjithmonë.  
 Kurrkush nuk të kruen si dora e jote.  
 Mishi prej thonit s’dahet.  
 Në një krue qi pi, mos pështyej kurr.  
 Duaj që të duan.  
 Goja bîr e goja nxîr.  
 Hunda në lis e morri në kurris.  
 I lagti për shí s’ka gajle.  
 Jo kur zbardhen flokët, por kur nxîhet zêmra vjen pleqnija.  
 (“*Shêjzat*” 1957, nr. 4–5, f. 122)

Kur s’fola, kurr s’gabova.  
 Kush duron, fiton.  
 Kush ep mejherë, ep dy herë.  
 Luen muri, por jo burri.  
 Mâ mirë shue se horue.  
 Mâ mirë një mik se një çifilik.  
 Miqsija e mirë hesapin e dliirë.  
 Mundi i qindrueshëm e puna e pa dá, rrxojnë një kalá.  
 Kali ku rrxohet, aty çohet.

<sup>7</sup> E hasim edhe te “*Shêjzat*” 1958, nr. 5–6, f. 181.

Kush trazonet në shum punë më në fund mbetet pa gunë.  
*(“Shêjzat” 1958, nr. 5–6, f. 181)*

As s’âsht fiksa me një fik, aq s’âsht niri me një mik.  
 Puno i rí, qi të gëzojsh në pleqni.  
 Kah del fjala, del shpirti.  
 Gjarpni nuk i kallzon kâmbët.  
 Hekuri rrihet sá të jetë i xetë.  
 Ku dhemb dhâmbi, aty shkon gjuha.  
 Kush lot kâmbët, lot dhâmbët.  
 Mos e prek gjarpnin në bisht, se të xên në gisht.  
 Lisin, sá mâ nalt të jetë, aq mâ fort e rreh era.  
 Peshku qelbet prej krejet.  
 Kúr thehet qerrja, gjinden shtigjet.  
 Kërmilli shán breshkën. (Piana degli Albanesi).  
*(“Shêjzat” 1958, nr. 7–8, f. 253)*

Kush hjek âsht mjek.  
 Lype e s’t’a jep; merre e s’të thotë gjâ.  
 Vjen me t’gjetë, e s’t’lên me fjetë.  
 Janë bâ bashkë byk e bërgajna.  
 Teshat i a bán gjeli, krenín s’i a çon qerri.  
 Mos e ngue grêthin me krânde, se ké ngucun të zezën t’ânde.  
 Idhnimmin e mbrâmjes lêne për nadje.  
 Kashata e madhe të zén fytin.  
 Kush âsht i zoti, mos i kjoftë i zí moti.  
 Nuk janë të tânë gishtat barabar.  
 Qênit kallxoi shkopin.  
 Kush e lypë, e gjên.  
 Kush rrin nën dardhë, i han kokrrat.  
 Lisi bën mëkatën e dega e lá.  
*(“Shêjzat” 1958, nr. 9–10, f. 344)*

Grueja âsht e pabesë si uji.  
 I ushqyem me qumësht lepuri (frigacak).  
 Sá pjell nata, s’pjell moti.  
 Hjek si krymbi nën gúr.  
 Mica qi flên nuk zên mij.  
 Ujku mjegull don.  
 Guri rândon mâ shum në vendin e vet.

E pret si korbi shín (me dishír të madh).  
 Dy shalqij në një dorë s'mbahen.  
 Nuk ecë gjithmonë kungulli mbí új.  
 Me kërkue qiqra në héll (gjâ e pamundun).  
 Mâ mirë të daltë syni se nami.  
 Sheh rrushi rrushin e skuqet.  
 Gomarin vetëm i zoti e nxjerr nga balta.  
 Po t'erdhi vdekja, bân gatí vorrin.  
 Mos i trego babës arrat.  
 Si kau pas qerres.  
 Nuk lën dy gurë njëjtë.  
 Gruen, kân e parmendës dhe kafshën e punës merri prej vendit t'and.  
 Çdo kuvend ká rend.  
 Gjën shesh e bân përsesh.  
 ("Shêjzat" 1958. nr. 11–12, f. 397)

Kúr çilë mrina, xehet shpina.  
 Dimni strukë delet, vera zdërhallë majmunat.  
 E bukur si bota e mend si çota.  
 S'ká gëzim pa idhnim.  
 Fmijt e plakut, vaji i sokakut.  
 Kúr shkoi amvisja në kjuer, s'pat ç'me prekë me duer.  
 ("Shêjzat" 1959, nr. 1–2, fq. 17)

Fmija i joshet nânës, i vogli i joshet të madhit.  
 Borxhi i mënuar del në vit të shtrenguar.  
 Thngilli i mlue të djeg e t'shue.  
 Mâ se rri kál e gomár pa shalue, aqi rri djal e gocë pa martue.  
 Rreziku te i ligu.  
 Janë një bathë e një kokërr.  
 U poqën bobet e thanat e ti s'u poqe.  
 Zâ-pelë e shtat-murrelë.  
 S'dahet thoni prej gishtit.  
 T'a jep vén pa të kuq.  
 Me shkue si qëni në rrush.  
 Gjysa e dheut si bagtija e Ndreut.  
 Njëni thumbit, tjetri patkonit.  
 Punët qi zgjaten, bâhen bollë.  
 Si të bijë lodra, duhet kcyë.

Me folë kodër mbas bregut.

I vetmi — i treni.

(“*Shêjzat*” 1959, nr. 3–4, f. 107)

**2. *Kokrra krype arbreshe.*** Mbledhur nga Gilda Occhionero, Montecilfone-Molise.

Pë patrugin ka të varëç qenin. (Për të zotin duhet të respektosh qenin.)

Si isht dhia, kështu vin kaciqi.<sup>8</sup>

Bën mirë e harò, bën keq e kujtò.

Mos ha sa ké, mos thujë sa din.

Kur dardha isht e bënur, vete e bije vetëm e vetëm.

(“*Shêjzat*” 1959, nr. 7–8, f. 283)

**3. *Fjalë t’urta arbreshe.*** Mbledhur nga Jozefina Giampietro, Shën Mitër-San Demetrio Corone.

Fjala e ljikë vret një gadhúr, fjalja e mirë çan një gúr.

Si krimbi ha dru’n, kështu pensjeri (mendimi) thán njerín.

Kur buti rrjoth, të gjithë miqt i mbiorth; kur buti shtërpoi, të gjithë miqt i largoi.

Mjeri i zí kush ngë ka njerí.

Dejti më ka e më don.

Kur dimri dimron, vera veron.

Si është dhija, vjen kaciqi.

Derku ha lamën e shlon koriten.

T’i shloç koljendra derkut.

Rroç e paç e sempre mirë bëç.

Edhe pjaku pa ngulí, kërren e ljuan kur verën pi.

Si ké vullnetadën<sup>9</sup>, paç uratën.

Si më do, të paça.

S’mirës ng’i mungon e mira.

Ndë unazit ranë, gjishtit janë.

(“*Shêjzat*” 1959, nr. 9–10, fq. 317)

Ku janë grá shumë, jesin buljerat pa új.

Kush nuk i bân sherbim kalit, e bân udhën në kâmbë.

Gojë gojë bâhet çarapi.

<sup>8</sup> kec.

<sup>9</sup> vullnetin.

S'ngrofen voet jashtë furrikut.  
 Djalli s'ka dele e shet lesh.  
 I keqi t'a bân të keqen.  
 Njeri i keq e zeza e vendit.  
 Kapedani i mirë në furtunë njifet.  
 Kushtrimi del për të ligështin, pse trimi kujtohet vetë.  
*("Shêjzat" 1960, nr. 1-2, f. 19)*

Kush s't'a dron armën vjerrë, s't'a dron as në krah.  
 Burri jà të falë, jà të vret.  
 Mâ mirë një kojshí (fqî) të mirë se një vëllá të largët.  
 Grues i dhemb ashti e nânës palci.  
 Kalit futi të hajë e vëni të bajë.  
 S'prishë punë këmisha e arnueme, po qe zêmra e gëzueme.  
 Delen e vetme e han ujku.  
 Besa e njerit, çilsi i nderit.  
 Nji gisht nuk bâhet grusht.  
 Zogun qi dahet prej kllukës e han shqipja.  
 Prej nji fjalet tunden malet.  
 Anmiku të shikjon ndër kambë e miku të veshtron ndër sy.  
 E mira edhe e liga me shok e miq kalohen.  
*("Shêjzat" 1960, nr. 9-10, f. 333)*

Rrëna e bân vegshin por s'i a vën kapakun.  
 Mâ e nevojshme krypa se mjalta.  
 E vërteta të bân me hjekë keq por nuk të lëshon.  
 E vërteta hollohet por nuk këputet.  
 J'à heret j'à vonë e drejta e gjên të zo'n.  
 Po shkove rrugës drejt nuk të gjên gjâ.  
 Dijet e mëdhá janë në fjalë të shkurtëra.  
 Kur erdhen mëndt treten dhënt.  
 Fjal' e keqe, rrëzon male.  
 Nji fjalë të vret, nji fjalë të ngjallë.  
 Shpata e njerit âsht gjuha.  
 Pika gremis murin, fjala vret burrin.  
 Deshte pëmë? Mos prish lulet.  
 Lësho vrapin sa ké hapin.  
 Kur t'a flasish, ta bâjsh.  
 Shit kalin e mëso djalin.

Gjykomë, pa vramë.  
Deti kos u bâ, për mue lugë s'u gjet.  
Ai qi âsht i pasun ep nga teprica, ai qi s'ka ep nga zêmra.  
(*"Shêjzat" 1960, nr. 9-10, f. 335*)

Me folë pa mendue âsht si me shtî pa synue.  
Kur gabon i mêçmi, çuditet i marri.  
Mâ mirë i vogël e mendtak se i madh e torollak.  
Njeriu qi nuk din turbullon ujin që pin.  
Për gjith vend ké pleq me mend.  
Qetësija e mendes, darsëm e përherëshme.  
Fjala e mirë çân edhe gurin.  
Fjala fjalën s'e mûn, por shtaga shtagen.  
Fjala bán kâmbë, ecë e gjithkush e ndigjon.  
Nji fjalë të vret, nji fjalë të ngjallë.  
(*"Shêjzat" 1961, nr. 1-2, f. 17*)

Ku âsht bashkimi, atje âsht ngadhnjimi.  
Besa e njërit, çelsi i nderit.  
Një gisht nuk bëhet grusht.  
Nuk mbahet shtëpija me nji shtyllë.  
Të shumë me një fjalë tundin malë.  
(*"Shêjzat" 1961, nr. 1-2, f. 28*)

Në magaze të barit të gjêjsh gjylopânën.  
Âsht bâ me i thirrë dërrit dajë.  
Gardhi ká veshë e fsha ká sý.  
Janë brum i njij mielli.  
Shka ndjell zogla, bjen prendvera.  
I gjalli e ká dermanin.  
Darsëm pá mish nuk bâhet.  
T'a ep arrën pá thalb.  
Më pré pá matë (me folë pá mendue).  
Kush ka gojë, ndán dejtín.  
Peshku i madh e han të voglin.  
(*"Shêjzat" 1961, nr. 3-4, f. 107*)

Din më shum i vuajturi se sa i mësuari.  
Njeriu i lik s'bëhet mik.  
Shoqi i lik prish.

Bashkë kuvendojmë, ç'thomi s'kupëtojmë.  
 Plak zëmra e s'plak moti.  
 E drejta është e drejtë, por s'hec pa të shtëme.  
 Nga një dele dy lëkura s'dalin.  
 Pushka sa ká birën ká nafakën.  
 Mos shikò se ç'thotë, por shikò ç'bën në botë.  
 Mbytet në një lug ùj.  
 Parja e botës prishet kollaj.  
 Besa e njerit, çelsi i nderit.  
*"Shêjzat" 1961, nr. 5–6, fq. 177.*

**4. Fjalë e thënie të urta të Ururi-t e Portocannone-s.** Mbledhur nga Teresa De Rose.<sup>10</sup>

Ndë dele bëhe, të ha ujku.  
 Kush peshkun dot e hár', — këmbët kat lagënjë.  
 Ngini këmbë — ke hani dhëmbë.  
 Ç'ishët e mira buka e vera — ç'ishët e liga shubërtira.  
 E para, e dita, e treta: e fërteta!  
 Ku pështinjën shumë, lehet një lumë.  
 Mishët e thuoq ngë ndahen.  
 Vloj bukën e bardhë pë ditët e zeza.  
 Mbajë verën e pijë ujët.  
 Vloj bukën e bardhë pë ditët e zeza.  
 Mbajë verën e pijë ujët.  
 Kush kërkon, gjënë.  
 Gjaku ngë bëhet ujë.  
 Fjalët e pendët shprishen e ngë ngjidhen.  
 Koçën e that e njomën guri.  
 Bjeri prakut ke gjegjën dera.  
 E keqja të qen ka dera huojë.  
 Kusija pa ujë ngë zjen kura.  
 Ujku ngë lot kura bashkë me delet.  
*("Shêjzat" 1961, 9–10, f. 360)*

Ka del fjala del shpirti.  
 Mbaj fjalën, se ké nderë.

<sup>10</sup> "Detti e proverbi" di Ururi e Portocannone.



(“*Shêjzat*” 1962, nr. 7–8, f. 278)<sup>11</sup>

### 5. *Fjalë t’urta t’Arbreshvet të Kalabris*

Ndë e nxiersh ka triesa, s’ mund e nxjerrsh nga gjaku.

Pecendi ngë ká gjiri<sup>12</sup>.

Kush do gjith, shtier<sup>13</sup> gjith.

Kúr djalli të qasen, do shpirtin.

Kika të vegjëvet e vute shejtëravet mos taks<sup>14</sup>.

Puru<sup>15</sup> pjeshti bën bugo<sup>16</sup>.

“*Shêjzat*” 1962, nr. 9–10, f. 323)

Si është i jati, vjen i biri, si është e jema vjen e bija.

Thujmë me kë rri – e të thom çë di.

Rri me një më të mirë se ti, e jepi të hé<sup>17</sup>.

Bishti është më i liku<sup>18</sup> ndë të rjepurit.

Qen që lehen shumë, zë pak.

Mos zgjo qenin që fje.

Kush ká shumë fjalë, ká pak të bëma.

“*Shêjzat*” 1962, nr. 9–10, f. 347).

Në përfundim të kësaj trajtëse mund të pohohet mbushullimi dhe larmia pa mbarim e fjalëve të urta arbëreshe, të cilat pasqyrojnë jetën, traditën, kulturën dhe ekonominë arbëreshe, ku ka spikatur kallëzimi popullor, por që një pjesë e tyre mund të jetë zbukuruar nga dëshira e mirë dhe fantazia e krijuesve popullorë, madje duke i shndërruar deri në legjenda.

### BIBLIOGRAFI:

1. Altimari, Francesco (2014). “Francesco Altimari – Studia Linguistica Italo-Albanica. Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian”. ASHAK, Libri 51. Prishtinë.
2. “Continuum” (2022). Revistë e studimeve arbëreshe (e përvitshme). Numër special: Gjuhët e rrezikuara dhe diaspora. Studimet dhe stadi i

<sup>11</sup> *Tradizioni popolari Italo-Albanesi*, di Margherita Savojarjo.

<sup>12</sup> I varfri nuk ka armiq.

<sup>13</sup> Humbet.

<sup>14</sup> Mos u premtoni gjëra të vegjëleve e vota shenjtorëve!

<sup>15</sup> edhe.

<sup>16</sup> pluhur.

<sup>17</sup> të hajë.

<sup>18</sup> i vështirë.

- arbërishtes si gjuhë e rrezikuar. (Pjesë nga Aktet e Konferencës Vjetore XXV. Fondacioni për Gjuhët e Rrezikuara). QSPA & FEL, Viti II, nr. 2. Tiranë.
3. Fjalor i Gjuhës Shqipe (2006). Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë. 1252 fq.
  4. Lafe, Emil (2017). "Shêjzat", S.n. Tiranë, nr. 1–2.
  5. "Shêjzat" (1957 – 1962).
  6. Shundi, Andrea (2016). "E(t)nogastronomia arbëreshe" (Shtjellohen edhe 610 receta gjellësh dhe ëmbëlsirash), "Vllamasi", Tiranë, 437 fq.

### Proverbs from the Arbëresh area

#### *ABSTRACT*

The treatment aims at a modest effort to contribute to the evidence of a cultural heritage with early evidence of an abundance and variety of Arbëresh proverbs, through which the Arbëresh people preserved and developed the Arbëresh language, oral literature and tradition, culture and economy, and which reflect their life and identity over the centuries. The main source for this publication will be the collection of Arbëresh proverbs and wisdom words from the magazine "Shêjzat" (1957-1974), along with the study of prof. Francesco Altimari's "Meteorological Proverbs of the Arbëresh Area" and the examination of a rare tradition of the Arbëresh ethnoculture - proverbs related to the Arbëresh enogastronomic activity in the monograph "E(t)nogastronomia Arbëreshe" by prof. Andrea Shundi. This wealth of folklore and culture of the Arbëresh of Calabria and Sicily, and beyond, constitutes a precious and reliable linguistic visa and a multi-element wealth of Arbëresh ethnoculture, and beyond, that of Arberian ethnoculture.

**Keywords:** Arbëresh proverb, wisdom word, meteorological proverb, folk beliefs, viticulture, winemaker, enogastronomy, ethnogastronomy, Arbëresh ethnoculture, "Shêjzat".

**Valjeta GJYLBEGAJ****SHKODRA NË SHËNIMET E DISA AUTORËVE*****Hyrje***

Dëshira e njerëzve për të udhëtuar ka lindur me njeriun dhe udhëtimet datojnë që në kohët e hershme. Njerëzit kanë udhëtuar për qëllime të ndryshme, kryesisht për të eksploruar vende dhe territore të ndryshme, për të njohur kultura dhe tradita të tjera, për të mësuar gjuhë të ndryshme. Kjo formë e njohjes së botës vazhdon sot të përditësohet nga miliona njerëz që përzgjedhin të udhëtojnë në mbarë botën sipas dëshirave dhe interesave, për të relaksuar, për të eksploruar dhe njohur vende të reja. Grand Tour përbën një etapë të rëndësishme historike të turizmit kulturor. Që nga vitet 1600 deri në mesin e viteve 1800, të rinj të ndryshëm evropianë, të cilët i përkisnin një rangu shoqëror të caktuar dhe kishin të ardhura të mira financiare, udhëtonin me mentorët e tyre, drejt shteteve<sup>1</sup>, që shquheshin për vlerat e tyre arkitekturore, kulturore dhe natyrore, si: Italia, Franca, Gjermania etj. Ata udhëtonin në kërkim të njohjes së artit, kulturës, trashëgimisë kulturore dhe gjuhëve të huaja. Hapat e parë të një tradite të tillë të të huajve në Shqipëri datojnë në shekullin XIX, ku udhëtarë, si: Evlija Celebi, Lord Bajron, Edit Durham, Edward Lear dhe shumë të tjerë fillojnë dhe ndërmarrin udhëtime të largëta, për të njohur vendet e Ballkanit, e mes tyre edhe vendin tonë të vogël. Këto udhëtime ndikuan në eksplorimin dhe ekspozimin e bukurive natyrore dhe kulturore të Shqipërisë dhe në veçanti të Shkodrës.

Shkodra ndër shekuj është përmendur dhe njohur si ndër kryeqendrat më me vlerë të Shqipërisë përse i përket kulturës, traditës, ekonomisë dhe vlerave historike që ajo mbart, prandaj dhe prezantimi i Shkodrës përmes turizmit kulturor dhe letrar është një formë tjetër e njohjes së vlerave dhe zhvillimit që ai ka pësuar ndër vite. Qyteti ynë është i pasur me trashëgimi historike dhe kulturore, të cilat e bëjnë atë një destinacion tërheqës për turistët. Shkodra ka ngjallur ndër vite kërkësinë e personaliteteve të ndryshme të fushës së politikës, kulturës, autorëve vendas dhe atyre të huaj, prandaj, duke u bazuar tek shkrimet dhe përjetimet e tyre, mund të rindërtohet imazhi i qytetit të Shkodrës një shekull më parë në përpjekje të ruajtjes së identitetit, në mënyrë që e kaluara e tij të mos harrohet.

---

<sup>1</sup> Timothy, D. J. (2011), *Cultural heritage and tourism: An introduction*, Channel View Publications, fq.2.

Udhëtarët e huaj, të cilët vizituan Shkodrën me qëllime të ndryshme politike, kulturore, tregtare dhe administrative, përjetësuan në veprat letrare apo ditarët e udhëtimit kujtimet dhe përjetimet e tyre nga kontakti me natyrën, peizazhin malor apo bregdetar, me kulturën, arkeologjinë dhe etnografinë kushtuar qytetit tonë. Mbresat dhe përshtypjet e tyre të udhëtimeve, takimet me një vend thuajse të panjohur për Evropën, ata i dokumentuan në forma të ndryshme, duke na lënë materiale të çmuara për të hulumtuar rreth mënyrës se si shihet një vend në sytë e të huajve.

Veprat e udhëtarëve të huaj, por edhe atyre shqiptarë që patën kontakte me botën përtej kufirit, kanë shërbyer si imazhe në negativ duke ruajtur kulturën, traditën, tejçuar trashëgiminë kulturore, e cila transmetohet më së miri përmes letërsisë dhe turizmit letrar, si domosdoshmëri në zhvillimin e shoqërisë tonë, prandaj dhe qëllimi i këtij punimi shkencor është evidentimi i rolit të letërsisë në përgjithësi, të asaj të udhëtimit në veçanti, me një ndikim të madh edhe në rritjen e shoqërisë dhe ekonomisë vendase.

Letërsia luan një rol vendimtar në zgjerimin e imazhit tek lexuesit, duke motivuar dhe frymëzuar turistin vendas apo të huaj, për ta konkretizuar imazhin abstraktiv me realitetin e një vendi tërheqës i cili mund të vizitohet nga afër.

Letërsia dhe tekstet letrare përbëjnë çelësin kryesor të zhvillimit të turizmit kulturor nëpërmjet pasqyrimeve dhe përshkrimeve të qytetit të Shkodrës nga udhëtarë të ndryshëm. Përmes këtyre teksteve ne arrijmë të marrim jo vetëm ndjesitë, përjetimet, por dhe këndvështrimet e tyre, duke dalluar kështu dhe hapat e para të përparimit të qytetit tonë.

Pse ishte i rëndësishëm *Grand Tour*?

Ky tur i madh kulturor dhe arsimor ndikoi në zhvillimin kulturor të Evropës, një përvojë e përmirësuar ndër shekuj, e cila sot ka marrë përmasat e një fenomeni global, i quajtur Turizëm kulturor. Turizmi kulturor dhe trashëgimia kulturore janë dy koncepte të lidhura ngusht me njëri-tjetrin dhe kanë të bëjnë me vlerat dhe shprehjet e kulturës së një vendi, në kontekstin e udhëtimit dhe përvojës turistike. Të dy konceptet përqendrohen në vlerat kulturore, etnografike, historike, të traditave e një vendi ose një bashkësie të caktuar dhe në mënyrën se si ato konkretizohen në një kontekst turistik.

Çfarë është udhëtimi?

Udhëtimi në vetvete nënkupton një aktivitet komercial<sup>2</sup> dhe udhëtimi

<sup>2</sup> McKercher, B., & Du Cros, H. (2002), *Cultural tourism: The partnership between tourism and cultural heritage management*. New York: Routledge, fq. 2.

kulturor përqendrohet në eksplorimin e aspekteve kulturore të një vendi, të mundshëm dhe të arritshëm për t'u vizituar. Kjo përfshin vizitën në monumentet historike, në muze dhe galeritë e artit, shëtitjet në qytetet e vjetra, festivale, aktivitete tradicionale dhe shijimin e kuzhinës lokale. Qëllimi i udhëtimit kulturor është të njihet dhe të përjetojë kulturën dhe traditat e një vendi, duke krijuar një përvojë edukative dhe duke ndikuar pozitivisht në ekonominë dhe kulturën lokale, por edhe ta përçojë atë në arenën ndërkombëtare.

### **Si paraqitet qyteti i vjetër i Shkodrës në këndvështrimin e udhëtarëve të huaj**

Pjesë e rëndësishme e historisë, kulturës dhe traditës së Shkodrës ka qenë edhe Pazari i Vjetër i Shkodrës, që, për fat të keq, sot nuk ekziston më. Të shumtë janë udhëtarët e huaj dhe autorë vendas, të cilët kanë shkruar për qytetin e Shkodrës dhe konkretisht edhe për Pazarin e Vjetër. Studiuesi Agim Parruca shkruan:

*Çdo udhëtari që ka kaluar nëpër Shkodër i ka bërë përshtypje dhe ka folur për të në gjuhë e alfabetë të ndryshme, sikurse me dhjetëra janë botimet e shtypshkronjave të Parisit, Londrës, Venecias, Berlinit, Stambollit, Sofies, Bukureshtit e Sarajevës, të cilët tregojnë për Shkodrën dhe Pazarin e saj, si një ndër pazaret më të rëndësishme të Ballkanit, Turqisë, krahas atij të Stambollit.<sup>3</sup>*

Ky organizim i veçantë arkitekturor, me ndikim lindor, por me detaje dhe elemente etnografike autentike i quajtur *Bexhisteni* ishte një faktor i rëndësishëm në sektorin ekonomik, por edhe atë social, pasi bëhej një vend i rëndësishëm takimesh nga shtresa e komunitete të ndryshme sociale e gjithashtu kishte të bënte edhe me shkëmbimin ndërkulturor me vendet e huaja sidomos me Malin e Zi, Italinë (Venedikun) e Stambollin nga ku shkonin e vinin tregtarët të cilët përçonin traditën tonë e sillnin risi në mentalitet nga vendet që vizitonin. Kleriku boshnjak Lovro Mihaçević, i cili ushtroi për më se një dekadë profesionin e mësimdhënësit në Kuvendin e Troshanit (1883), pati rastin të vizitonte shumë vende nga Shqipëria, por Shkodra do të mbetej e pashlyeshme në kujtesën e tij. Një ndër simbolet e magjepsjes që impononte Shkodra, ishte padyshim Pazari.

*[...]Shkodra ndahet në dy pjesë: pazari dhe qyteti. Pazari gjendet në breg të liqenit, aty ku liqeni derdhet në Bunë, kurse qyteti ndodhet më larg në lindje, nja dy kilometra larg pazarit. Qytetin e lidh me*

<sup>3</sup> Parruca A. (2013). *Shkodra. Bastion i qytetërimit shqiptar*. Shtypshkronja ILAR, fq. 221.

*pazarin rruga, që është e gjerë dhe e rregulluar. Shkodra ka dy ura, njëra ndodhet mbi Dri, krejt nën Kala që bashkon periferinë, Baçallekun, prej të cilit ka emrin dhe ura e Baçallekut me Shkodrën. Këtë urë e ka ngritur me shpenzimet e veta Ahmet Pasha Bushati në vitin 1768 për t'ua lënë pasardhësve të vet kujtimin e bukur për bamirësitë e veta, ashtu siç shkruan në mbishkrimin arab gdhendur në gur.....*

*... mirëpo derisa në qytet është paqe e qetë ai, në Pazar vëlon e gjallëron njërëzia, bisedojnë, bëjnë zhurmë, bëjnë Pazar, goditen e lidhin kontrata, ujdisen e lidhin marrëveshje të ndryshme në Pazar malli është i ndarë e i veçuar, në një krah janë farkëtarët, lëkurëpunuesit, kaanxhinjtë, drithëtarët e pemëtarët etj, në dy a tri vende shitet peshku.*

*Dita e mërkurë është ditë pazari, mirëpo thuhet se çdo ditë është ditë pazari, pasi këtu shitet, blihet e tregtohet, jo vetëm për nevojat e qytetarëve, por edhe për fshatarët e shumtë, që qendërzohen këtu nga Shqipëria dhe Mali i Zi<sup>4</sup>[...]*

Qyteti i vjetër i Shkodrës është një labirint i rrugëve dhe objekteve historike që shtrihet në qendër të qytetit. Kjo pjesë e qytetit është e pasur me ndërtime të vjetra: xhami, kisha, rrugë, kalldrëm, dhe tregje tradicionale. Pazari i Madh ishte vendosur në afërsi të qytetit të vjetër, nga ku ka marrë edhe emrin, në një distancë rreth 2 km me Shkodrën e Re, në një zonë të pabanuar, në një fushë të ulët rrëzë pjesës veriperëndimore të kalasë së Rozafës, në krahun e majtë të burimit të Bunës, që njihet ende me emërtimin Pazari i Vjetër, ku sot nuk ka mbetur asgjë prej tij. Ai funksiononte si një lloj kaleidoskopi nga ku mund të kundroheshin njëri pas tjetrit peizazhet magjepëse hidrofilike e malore që i qëndronin përqark. Ky aset natyror, i cili nuk kalon pa marrë vëmendjen e shumë vizitorëve të asaj periudhe është përjetësuar nga Edward Lear në pikturat e tij, ndërsa dëshmon se “pamja ishte e mahnitshme”, një urë e vjetër e mrekullueshme mbi Bunë (sot nuk ekziston), me harqe të larta me majë, me gjerësi të ndryshme “të cilat dukeshin si kolona katedralesh gotike që papritur kishin vendosur të kalonin lumin, ca me hapa të shkurtra e ca më të gjata”, një tablo madhështore që shtrihej nga shkëmbi i lartë në lindje të Pazarit të vjetër (kodra e Tepes, monument natyre me vlera të veçanta shkencore, didaktike e kulturore) që rrokte kalanë, majat e larta të maleve, rrënojat e

<sup>4</sup> Mihaçeviq, L. (2006), *Nëpër Shqipëri 1883-1907. Mbresa udhëtimit dhe etnografi*. Tiranë: Enti botues “Gjergj Fishta”, fq. 69-70.

qytetit poshtë, lumin që gjarpëronte poshtë urave diku tutje dhe dielli i zhytur në horizont që përflakte anën veriore të këtij peizazhi duke krijuar mrekullinë e pashoqe me “gjethnajat e harlisura dhe ndërtesat xixëlluese nga njëra anë, dhe vargjet e kodrave me ngjyrë të kaltër dhe vjollcë të errët në sfondin e ndriçuar”<sup>5</sup>.

Duke iu referuar Edward Lear, *Ditar Udhëtimesh 1848-1849*, e gjejmë të përshkruar kështu Pazarin e vjetër:

[...] *Shkodra shtrihet në jug të liqenit me të njëjtin emër, një rrip toke midis dy lumenjsh, njëri prej të cilëve, Buna, rrjedh në anën jugore të kreshtës vetmitare ku ngrihet kalaja, e cila ndan fushën nga liqeni dhe që duket sikur e ndan në mes një gropë e thellë në lindje të fortesës.*

*Teksa ngjitesh përtej kësaj skene të shkretuar për tek rrugët e gjata të dyqaneve, që bashkohen poshtë fortesës hijerëndë - sepse këto pazare me organizimin e tyre gjallërojnë gjatë gjithë ditës - gjatë paradites ato janë skena plot jetë por një orë para perëndimit të diellit çdo gjë është e mbyllur. Çdo banor mashkull shkon tek dugaja e vet herët në mëngjes dhe kthehet me aq përpikmëri në atë që është qyteti i vërtetë i Shkodrës (I njohur me emrin Kopshitet)<sup>6</sup>[...]*

Pazari i Vjetër në Shkodër në kohën e lulëzimit të tij, u bë vërtet një qytet i madh tregtar midis pjesës së vjetër dhe asaj të re të qytetit, i shtrirë në 1.8 km gjatësi, ku vlonte tregtia dhe madhësia e tij lejonte të ushtronin aktivitetin aty mbi 10 000 njerëz. Ai bënte bashkë tregtarë nga e gjithë Shqipëria, si ura lidhëse midis Evropës dhe pjesës perëndimore të Perandorisë Osmane deri në krijimin e linjës hekurudhore që bashkonte Evropën me brendinë e Turqisë. Shkrimtari, gazetari e diplomati i njohur serb Nushiq shkruan për Pazarin e Shkodrës: “Aty i sheh malësorët, aty serbët e Vrrakës, aty latinet e bukura [...] aty sheh evropianin me sheshir (republikë), fratin me fytyrën e rruar, hoxhën nën turban dhe priftin nën kamillaf; [...] kjo i jep një hijeshi të veçantë pazarit të Shkodrës.”<sup>7</sup> Gjithashtu, deti, i sillte kësaj qendre tregtare pasuritë e të gjithë botës çfarë reflektohej në mirëqenien e shkodranëve dhe në veshjet e begata të tyre. Sllavisti suedez Alfred Jensen gjatë turit të tij nëpër Ballkanin

<sup>5</sup> Lear, E. (2008), *Edward në Shqipëri. Ditar udhëtimesh 1848-1849*. Tiranë, Plejad, fq.108.

<sup>6</sup> Lear, E. (2008), vep.cit, fq. 100 -101.

<sup>7</sup> Nushiq, Branisllav (2021), *Nga Kosova deri në bregdetin Adriatik. Shënime udhëtimi nëpër viset shqiptare në vitin 1894*, Naimi, fq.181.

Jugperëndimor kaloi vetëm një ditë e një natë në Shkodër dhe kujton se u shoqërua nga një shkodran i ri, i veshur mirë me kostum evropian, që fliste mirë greqisht, italisht, turqisht përveçse shqip, e se nga vendet e vizituara, si kalaja e Rozafatit, një varrezë myslimane, nuk anashkaloi pazarin me lagjet përreth.<sup>8</sup> Aty zhvillohej jeta sociale që nga lindja e deri në perëndim të diellit, për t'u shpërngulur më pas drejt qytetit. Ndërsa në ditët e pazarit, ditët e diela apo të mërkura, aty mund të ishin prezentë më shumë se 30 mijë vetë, çka e tregonte edhe fakti se shkodranët e kanë pasur traditë dhe janë vlerësuar si “mjeshtërit” më të shkëlqyer në tregti. Po aty ishin ngritur magazina të mëdha për hyrje-dalje mallrash, kishte zyra të mëdha doganore si edhe banka. Në të djathtë të Urës së Bunës ka qenë Zyra Doganore, ku kryheshin të gjitha veprimet financiare për import - eksportet e mallrave në Shkodër. Pjesë e rëndësishme e aktivitetit të *Bexhistenit* pasqyrohet në relacionet e Zëvendëskonsujve venecianë që dëshmojnë për vitalitetin e tij si qendër ekonomike, por edhe si stil jetese që tërhiqej nga Perëndimi<sup>9</sup>. Në vitin 1907 konsulli anglez në Shkodër *Th. Ippen* në përshkrimin që i bën Pazarit të Shkodrës shkruan;

[...]Nga godinat më të mëdha, Pazari i Shkodrës ka Bezistanin (*Bexhisteni*) nga koha e Bushatllinjeve, një treg i mbuluar që përdoret në Lindje për mallra, veçanërisht të kushtueshëm. Përreth grumbullohen dyqanet dhe zyrat e tregtarëve të mëdhenj. Më tutje në Pazar shihet dhe një institucion mësimor, medreseja, e cila përbëhet nga një ndërtesë kryesore e madhe dhe shumë e bukur, por e lënë pas dore dhe nje godinë e veçuar, biblioteka [...] <sup>10</sup>

Shumë studiues e paraqesin Pazarin e Shkodrës si treg dhe ekspozitë për shumëllojshmërinë e artikujve që tregtoheshin dhe shumëllojshmërinë e kostumeve, ku zë vend dhe shprehja popullore “kostum e katund”. Madhështore ishte dita e pazarit, pasi aty mblidheshin burra, gra, të rinj dhe të reja me rrobat e tyre më të mira, për të mësuar të rejtat më të fundit, se çfarë ndodhte dhe për t'u takuar me njëri-tjetrin.

Bexhisteni kishte katër dyer të fortifikuara, dy të mëdha që kufizonin gjatësinë e tij dhe dy të tjera anësore. Në mbrëmje tri nga dyert mbylleshin nga brenda, ndërsa njëra mbyllej me një bravë të madhe nga jashtë nga

<sup>8</sup> Qvick, Ullmar (1998), *Shkodra në botimet e vizitorëve suedezë, në “Seminari i dytë ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”*”, 22 - 23 qershor 1995, vëllimi I, fq. 173 - 179.

<sup>9</sup> Lexo: Saraçi, Alvin (2018), *Tregtia adriatike e Shkodrës me Venecien në shekujt XVII dhe XVIII*, Tiranë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë.

<sup>10</sup> Parruca, Agim (2013), *Shkodra. Bastion i qytetërimit shqiptar*. Tiranë: Shtypshkronja ILAR. fq.223



Pazvani (roja i pazarit). Çelësi i kësaj dera peshonte 369 gr, që e mbante Pazvani, i cili e hapte këtë derë në mëngjes dhe e mbyllte në darkë, me një forcë, që thuhej se dëgjohej në lagjet përreth, prandaj dhe përdoret akoma sot në Shkodër shprehja “si me kenë dera e Bexhistenit” për ndonjë derë të madhe.

Sipas konsullit francez në Shkodër Mark Bryer, në fillim të shekullit XIX, popullsia e Shkodrës përbëhej nga rreth 40.000 banorë, shumica e të cilëve jetonin me të ardhurat e veprimtarisë tregtare<sup>11</sup>, ndërsa E. Spencer thekson se “Shkodra ishte një prej qyteteve më të lulëzuara tregtare”.<sup>12</sup> E dëshmon diçka të tillë konstatimi i H.A. Brown 1888<sup>13</sup>: “Në Pazarin e Shkodrës kishte vazhdimisht vizitorë të huaj, tregtarë venedikas, raguzianë, boshnjakë, italianë, algjerianë, sirianë, çifutë etj.”, apo i konsullit francez në Shkodër më 1901, A. Degrand, sipas së cilit “pas pazarit të Stambollit, ia vlen të vizitohet pazari i Shkodrës”<sup>14</sup>.

Dëshmitë e shumë vizitorëve të huaj flasin për këtë qendër tregtare të pazakontë për nga funksioni si për një tipar identifikues të Shkodrës në shekujt e kaluar. Prej dekadash kjo qendër nuk ekziston më. Me tërbim këmbëngulës u shkatërrua Pazarit dhe me po aq fanatizëm u punua sistematikisht për të mos e kujtuar atë të kaluar të ndritur që e mbante Shkodrën lidhur me Lindjen e me Perëndimin, duke zhdukur çdo provë, dëshmi, monument që të mund të sillte në kujtesë atë. Dhe ashtu siç thuhet, një vend që nuk ka kujtesë, nuk ekziston.

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX në Shkodër kishin selitë e tyre pesë konsullata të vendeve evropiane. Prania e përfaqësive diplomatike përkthehet në hop të zhvillimit ekonomik, që reflektohet në modernizimin e jetës së komunitetit, të zhvillimit urbanistik, të ndryshimeve të gjeografisë sociale të qytetit (pasurimin me komunitetet e huaja). Konstatohet prania e komunitetit relativisht të gjerë italian, komunitetit të të krishterëve ortodoksë nga Korfuzi, mes të cilëve edhe dy figura të shquara për historinë dhe kulturën e Shkodrës, si: Pietro Marubi e Kol Idromeno.

Historia e veprimtarisë diplomatike të asaj kohe në Shkodër është fragmentare. Sado e studiuar të jetë nga personat e interesuar për këtë fushë, ajo mbetet e tillë që në momentin që nuk ka njohuri të unifikuar për vendndodhjen e selive të përfaqësive diplomatike të kohës. Natyrisht që ato u vendosën në të ashtuquajturën qendër të qytetit për kohën, siç ndodh

<sup>11</sup> Parruca, Agim. (2013). vep.cit, fq.222.

<sup>12</sup> Parruca, Agim. (2013). vep.cit, fq. 88.

<sup>13</sup> Parruca, Agim. (2013) vep.cit, fq. 88.

<sup>14</sup> Parruca, Agim. (2013) vep.cit, fq. 88.

rëndom për natyrën e veprimtarisë që zhvillojnë. Kureshtarë për faktin u informuam pranë disa guidave turistike nëse e ofronin si itinerar turistik bllokun e ndërtesave të selive diplomatike. Përgjigjja ishte negative. Dhe jo vetëm që nuk ka përpjekje për ta dëshmuar këtë fakt, por edhe vendndodhja e tyre në burime të ndryshme nuk është e saktë. Studiuesi Lucian Bedeni<sup>15</sup> ka mundur të identifikojë fotot e selive diplomatike të mundësuar në Muzeun Kombëtar të Fotografisë “Marubi” në Shkodër.

Pesë seli të përfaqësive diplomatike të vendosura në Shkodër në gjysmën e dytë të shekullit XIX ceken në dorëshkrimin e Giacinto Simini-t, *Një patriot leçez në Shqipërinë osmane*<sup>16/ 17</sup>. Ato janë konsullata franceze (nuk ekziston sot), e vendosur në qendrën e atëhershme dhe të tanishme të qytetit, në rrugën pedonale (piaca), godina e ish- “Grand hotel” ose siç njihet nga shkodranët ish- “Turizmi i vjetër”. Vendi ku ngrihej godina gjatë viteve të diktaturës u kthye në lulishte birrari e sot akoma ofron shërbime sociale bar e restorante. Vendndodhja e ish - hotel Turizmit është trashëguar gojariisht, asnjë shënim, tabelë që të mund të rievokojë diçka nga e kaluara, duke qenë se godina kishte domethënie për historinë e Shkodrës. Përballë saj ekziston një rrugë, e quajtur Rruga e Etërve Jezuitë në hartën britanike (1913) dhe në atë të Etënve Jezuitë (1923), rruga e Kafes së Madhe në vitet e monizmit, ku ndodheshin konsullata e Austrisë, në shpinë të saj ajo e Rusisë, pranë së cilës u sistemua Pietër Marubi<sup>18</sup> në fillimet e jetës së tij shkodrane, i ngarkuar për zbulimin e kishës ortodokse ndërtuar në truallin ngjitur saj (1861), e për të cilën kishte kontribuar me një dhuratë, ikonë të çmuar, familja e Romanovëve. Godinat e selive ekzistojnë edhe sot, kanë qenë shtëpi banimi, por për funksionet e mëparshme informacioni i besohet memories individuale.

Në pjesën fundore, djathtas rrugës, shtrihej kompleksi i Jezuitëve (seminari Papnor, Kolegji Saverian, orfanotrofi) dhe në shpinë të tyre Konsullata e Italisë. Në rrugicën e Sumajve, thuajse përballë kompleksit Jezuit me të cilin ndaheshin nga rruga kryesore që lidhte Pazarin me pjesën lindore të qytetit, ndodhej Konsullata Britanike<sup>19</sup>, ngjitur me shtëpinë ku

<sup>15</sup> Bedeni, Lucian (2021), *Foto-Studio "Marubbi" shpi themelue në 1856: (Pietro Marubbi dhe lindja e studios së parë fotografike në Shqipëri)*, Tiranë, fq.320, disertacion i konsultueshëm në sallën e Bibliotekës Kombëtare Tiranë.

<sup>16</sup> Simini, Giacinto (2021), *Një patriot leçez në Shqipërinë osmane*, përkth. nga origj. Alma Hafizi, Tiranë, Berk.

<sup>17</sup> Hafizi, Alma, *Shkodra e Siminëve gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX*, në “Revista FGJH” revistë shkencore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, nr.5/2022, ISSN 2664-7346, fq.95-106.

<sup>18</sup> Sipas studiuesit Bedeni, L., vep.cit.

<sup>19</sup> Ndodhej në Shtëpinë e të binjëve të Kolë Heqimit, e shpallur shtëpi muze për bukuritë

banonte patrioti Pashko Vasa, i punësuar pranë saj e më pas edhe dhëndri i familjes Bonatti (u martua me vajzën e madhe të konsullit britanik Spiridone Bonatti). Familjet e konsujve banonin në të njëjtat shtëpi që funksiononin edhe si seli diplomatike. Ato ishin ndërtime të stilit perëndimor dhe oriental, tepër mbresëlënëse për nga bukuria dhe madhështia, me pronarë të përmendur për mirëqenien e tyre ekonomike. Përfaqësitë diplomatike në Shkodër, në kohë të ndryshme kanë ndërruar seli, por ne u refrohemi viteve 1853- 1880 për të cilat flitet në dorëshkrimin e Simini-t.

Nga hartat e lartpërmendura<sup>20</sup> mund të vihet re se qyteti shpaloste tendencën të zhvillohej nga lindja, ashtu sikundër edhe kompleksi i institucioneve të kultit katolik zgjerohej asaj ane, duke e ndarë qytetin përgjysmë sipas përkatësisë fetare (lagjet myslimane nga perëndimi e ato katolike nga lindja). Nuk është e qartë se ku banoi vetë Simini. Studiuesi Bedeni mendon se ai mund të ketë banuar në zonën e ndërmjetme mes asaj myslimane e katolike, aty ku pak më vonë fillon të ngrihet qendra e re tregtare e njohur si “Dugajtë e reja” (akoma sot ekzistuese, por mungon simboli i saj, “Truma e dugajëve të reja”). E nëse diçka e tillë do të provohej, do ta përforconte më tepër perceptimin e Siminëve mbi bashkëjetesën fetare në Shkodër, si vlerë e trashëgimisë sonë jomateriale.

Në periferinë lindore të qytetit gjendet Varreza e Rrëmajit, unikale në llojin e vet në vendin tonë, arsye për të cilën është shpallur monument kulture në vitin 2007. Varreza të besimit katolik, familjare, ndërtime me karakter monumental i përkasin gjysmës së dytë të shekullit XIX, në kohën kur Shkodra kishte marrë zhvillim të dukshëm. Shumë prej varreve janë ideuar e arkitektuar nga Kol Idromeno. Janë të dekoruara me ornamente të stilit neoklasik dhe shpesh edhe me skulptura prej mermeri, kolona mermeri, me kapitule si dëshmi e madhësisë së familjes së cilës i përkasin. Materialet e përdorura, si: granit, mermer, çimento, pjesë metalike

---

antike që përmbante, por për motive urbanistike (zgjerim rruge) në vitet 1960 u shkatërrua. Qemeri i derës dhe harku i sipërm i saj ishin prej guri të latuar. Anash saj dy dritare qorre. Oborri i mbjellë me manjolë, hurma dhe lule gjithfarë ngjyrëshe, pusi i madh prej guri me dekoracione dhe lugu i gurtë për larje. Shkallët e hyrjes të gurta me parmakë të punuar. Çardaku prej druri, tavanet me thurje në formë rombesh që përmbajnë lule pesëgjethëshe të daluara. Trapazani me dritare romboidale dhe në mes kafazlije. Oxhaku madhështor me dy rosona sipër, dhomë miqsh për të cilën flet edhe Edith Durham në *Brenga e Ballkanit*. Pas prishjes, oxhaku dhe punime të tjera artistike u dërguan në shtëpinë muze të patriotit Luigj Gurakuqi.

Suma, Terezina (2003), *Familja Suma, histori, traditë, etikë*, Florimont, fq.72.

<sup>20</sup> Harta tipografike britanike e Shkodrës (1913).

me ganxha janë të një cilësie të lartë.<sup>21</sup> Kryesisht përdoren gurë vendi për të formuar një shkëmb si dëshmi e të qenit autoktonë familje shkodrane (rasti i familjes Çeka - Suma). Karakteristike është larmia arkitekturale dhe ornamentale që i jep vlerë artistike kësaj varreze, por pa anashkaluar atë historike, sepse aty prehen korifejtë e artit, kulturës e shkencës mbarëkombëtare.

### KONKLUZIONE

Gjurmimi i personazheve historike që shfaqen në kujtimet e udhëtarëve e piktorëve të huaj që vizituan Shkodrën në shekullit XIX ndihmon në rindërtimin e mozaikut të një Shkodre të dikurshme që koha e ka prishur dhe dëmtuar. Ata janë personazhe historikë e kulturorë, fati i të cilëve ndërthurej së bashku duke prodhuar art e kulturë për qytetin. Gjithashtu, ato përbëjnë referenca bibliografike me vlerë mbi jetën zakonore dhe vështrimin antropologjik të Shkodrës së asaj kohe, mbi kryqëzimin e kulturave, besimeve fetare dhe komuniteteve të huaja në jetën e qytetit që la gjurmë në trashëgiminë tonë kulturore materiale dhe jomateriale, mbi jetën diplomatike të Shkodrës, e cila asokohe mikpriste përfaqësitë e shteteve të mëdha evropiane.

Një libër kujtimesh, i thjeshtë në dukje, evokon shumë ngjarje e personazhe dhe mund të shërbejë si një guidë për promovimin kulturor të qytetit. Shumë nga objektet e evokuara në ditarët e udhëtimit apo letërsinë e mirëfilltë nuk ekzistojnë sot, prandaj analiza e këtyre teksteve, është apel për institucionet kulturore politikëbërëse në nivel lokal e qendror. Një pllakatë ndihmon në rindërtimin e identitetit tonë kulturor. Sepse identiteti ndërtohet edhe nga vendet që ne vizitojmë.

Nëse iu referohemi studiuesve vendas dhe mendimeve të tyre rievokimi i këtyre vlerave të mëdha historike, kulturore të Shkodrës është me shumë rëndësi. Pikërisht këto përshkrime të këtyre personaliteteve kanë shumë vlerë dhe në ditët e sotme, pasi secili prej nesh ka mundësinë të mësojë diçka të re përse i përket vlerave kulturore të qytetit tonë dhe natyrisht këto informacione janë me vlerë si për turistët e huaj, po ashtu dhe ata vendas, veçanërisht për brezin e ri. Përbën një kartëvizitë të sigurt që shoqëron dhe promovon vendin tonë në arenën ndërkombëtare, por gjithashtu është një ndër hallkat më të rëndësishme të ekonomisë së vendit. Jo në vend të mbylljes, por të ideve për të ndërtuar një qasje ndryshe ndaj të shkuarës, kulturës, historisë, trashëgimisë sonë në tërësi. Disa ide që

---

<sup>21</sup> Dibra, Zenepe (2018), *Qyteti që lindi nga një kështjellë*, Lezhë, Botimet Fishta, fq. 209.

kërkojnë vetëm vullnet pozitiv për të shkruar e për të mos e harruar atë që lamë pas, sepse pa të djeshme nuk ka kurrë të ardhme.

#### BIBLIOGRAFI:

1. Bedeni, Lucian (2021): Foto-Studio "Marubbi" shpi themelue në 1856: (Pietro Marubbi dhe lindja e studios së parë fotografike në Shqipëri), Tiranë.
2. Dibra, Zenepe (2018): *Qyteti që lindi nga një kështjellë*, Lezhë, Botimet Fishta.
3. Hafizi, Alma, *Shkodra e Siminëve gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX*, në "Revista FGJH" revistë shkencore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, nr.5/2022, ISSN 2664-7346.
4. Lear, E. (2008): Edward në Shqipëri. Ditar udhëtimesh 1848-1849. Tiranë, Plejad.
5. McKercher, B., & Du Cros, H. (2002): Cultural tourism: The partnership between tourism and cultural heritage management. New York: Routledge.
6. Mihaçeviq, L. (2006): *Nëpër Shqipëri 1883-1907. Mbresa udhëtimiti dhe etnografi*. Tiranë: Enti botues "Gjergj Fishta".
7. Nushiq, Branislav (2021): *Nga Kosova deri në bregdetin Adriatik. Shënime udhëtimiti nëpër viset shqiptare në vitin 1894*, Naimi.
8. Parruca, A. (2013): *Shkodra. Bastion i qytetërimit shqiptar*. Tiranë: Shtypshkronja ILAR.
9. Qvick, Ullmar (1998): *Shkodra në botimet e vizitorëve suedezë në "Seminari i dytë ndërkombëtar "Shkodra në shekuj", 22-23 qershor 1995, vëllimi I*.
10. Saraçi, Alvin (2018): *Tregtia adriatike e Shkodrës me Venecien në shekujt XVII dhe XVIII*, Tiranë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë.
11. Simini, Giacinto (2021): *Një patriot leçez në Shqipërinë osmane*, përkth. nga origj. Alma Hafizi, Tiranë, Berk.
- Suma, Terezina (2003): *Familja Suma, histori, traditë, etikë*, Florimont.
12. Timothy, D. J. (2011): Cultural heritage and tourism: An introduction. Channel View Publications.

### Shkodra in the notes of some authors

#### ABSTRACT

Shkodra has been mentioned and recognized over the centuries as one of the most valuable centers of Albania in terms of culture, tradition, economy, and historical values it embodies. Therefore, the presentation of our city through cultural and literary tourism is a window reflecting the light of development that this urban space has had over the years.

Albania, especially Shkodra, has sparked the interest of various personalities in the fields of politics, culture as well as the interest of local and foreign authors over the years. Thus, by relying on the writings and experiences of various travelers, we want to present the old city of Shkodra so that its cultural heritage is not forgotten.

Literature and literary texts are important keys to the development of cultural tourism through reflections and descriptions of the city of Shkodra by various travelers. Through texts since ancient times, we manage to capture feelings and experiences through their perspectives, thus, distinguishing the first steps of the development of our city. By exploring the connections between the city and literature, Shkodra has the opportunity for the development of literary tourism, which would enrich the city culturally and economically. Literature can play a decisive role in creating the physical and cultural image of the city for readers, motivating and encouraging both local and foreign tourists to materialize this image into a possible destination.

This paper aims to highlight the advantages of cultural and literary tourism predisposed towards thematic tourism aiming to attract tourists from different countries and of different ages with the specific purpose of enhancing the cultural image of the city of Shkodra. Not only we see foreign tourists as the main target group, but we also aim to increase the interest of local tourists, simultaneously, so that the practice of domestic tourism gets significantly larger.

**Keywords:** City development, city promotion, cultural heritage, literature, literary tourism.

Andreas DUSHI  
Gjovalin SHKURTAJ

## MARCIA, ROMANI I PARË NË GJUHËN SHQIPE

Dom Ndoc Nikaj, personaliteti i shumanshëm i fundit të shekullit XIX dhe fillimit të të XX-it, i njohur për historinë, letërsinë, biznesin dhe meshtarinë e tij, filloi të shkruante qysh herët, pak pas të njëzetave. Libri i tij i parë, “Vakinat e Kishës”, u botua më 1888 dhe libri i dytë, “Marcia o kshthenimi n’filles t’vet”<sup>1</sup> më 1892, duke vënë kështu gurin e parë në historinë e romanit në gjuhën shqipe. Vetëm pas 21 viteve, autori iu rikthye prozës së gjatë, me “Shkodra e rrethueme”, për të mos u ndalur më. Një pjesë prej romaneve të tij janë botuar, ndërsa dorëshkrimet e pjesës tjetër presin në koleksionet e Arkivit të Shtetit.

Pra, Nikaj filloi si historian, vijoi si romancier, pastaj si studiues, hartoi abetare e libra ushtrimesh për gjuhën, qe dramaturg, u mor me biznes dhe shërbeu si meshtar. Secili prej dimensioneve të kësaj jete mund të jetë objekt i një studimi më vete me kapituj që i përgjigjen çdo libri apo çasti të

---

<sup>1</sup> Te Nikaj, Ndoc “Kujtime të një jete së kalueme”, “Onufri”, Tiranë, 2016, fq. 50, Nikaj shkruan: “Unë fillova me shkruë “Vakinat e Kishës” qi me ndimen e Pieter Dodmasejt mbujta me e shtypë në Shtypshkrojen e Propagandës së Romës në vjeten 1888. Mbas atij libri, në shtypshkrojen e Jezuitve në Shkoder shtypa ma të parin roman “Marsia ose Kështenimi në fillesë të vet”. Këta kjene botime të bame prej meje në kohën e xhakonis e qi kjene fillesa e botimeve [të] mija.

Botimin e librit të parë “Vakinat e Kishës”, atë Gjergj Fishta e përmend edhe në poezinë satirike “Kontrata” e cila, përtej ironisë dhe satirës, na jep disa të dhëna interesante si p.sh. tirazhin e atij botimi:

*E, për mos m'e tjerrun hollë,  
Ndigio 'i herë se ç'i ka ndodhë  
Me një liber shqyp Dom Ndocit  
Liber shqyp, po, mje n' palë t'kocit  
Don Ndoc Nikaj, si xhakue,  
Historin e Kishës pat shkruë  
E me ndihmë të Dodmaseut,  
(Qi asht bamirsi i gjith ktij dheut,)  
E botoi, s' dijk kú n' Europë,  
Jo ma shum, veç n' pësquind copë,  
Edh' e qiti, ndigio 'i fjalë!  
Jo m'e shitun, por m'e falë.  
Por, a e din sâ vjet kanë shkue  
Q' prej se libri kje botue,  
Der qi s' falnit u mbarue?!*

jetës së tij, prandaj duke mos dashur të shpërndahemi në shumë fusha, do të ndalemi vetëm te qenia e tij si romancier, veçanërisht në rastin e romanit të tij të parë “Marcia o kshtenimi n’filles t’vet”.

Paçka se kishte romane të shkruara nga autorë shqiptarë në gjuhë të huaj, si “Dashuria e Talatit me Fitneten” e Sami Frashërit, botuar në turqisht më 1872 apo “Sofia Kominiate”, i lënë në dorëshkrim nga Françesk Santori<sup>2</sup>, historia e prozës së gjatë në gjuhën shqipe zë fill pikërisht me *Marcia*-n.

Në *Historia e Letërsisë Shqipe* botuar në vitin 1959 nga *Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë* dhe hartuar nga një redaksi me në krye Dh. Shuteriqi lexojmë:

*Për sa i takon novelës së gjatë dhe romanit, i pari që na ep diçka shqip është Ndoc Nikaj, me një roman të vogël të përshtatur nga Italishtja, “Marcia e kshtenimit n’fillesë t’vet” (1892), vepër që e merr temën nga fillimet e kristianizmit.*<sup>3</sup>

Henrik Lacaj më 1963 shkruan se *Nikaj [...] punon e punon me ngulm sidomos në hartimin e romaneve. Pa dyshim Nikaj asht i pari në letërsinë tonë dhe një nga të paktët prozator që del me një grumbull veprash të këtij lloji... Vlen për t’u vu në dukje se Nikaj me romanin “Marcja” hap ciklin e pjesëve të tjera të këtij llojit, ndonëse ka një distancë të madhe vjetësh midis këtij të parit dhe të tjerëve.*<sup>4</sup> Lacaj shkruan edhe se ky roman ishte një sukses që i kënaqi lexuesit<sup>5</sup> duke përforcuar atë çfarë shkruhet me rastin e pesëdhjetë vjetorit të meshtarisë së Nikajt, se romani *kje këndue me shumë andje e dishir prej djelmnisë*<sup>6</sup> dhe se autori është *nji nder shkrimtarët ma të lexueshëm të vendit t’onë.*<sup>7</sup>

Të një mendjeje se *Marcia* është romani i parë shqiptar janë edhe Rexhep Qosja<sup>8</sup> dhe Aurel Plasari<sup>9</sup>.

Nëse të gjithë studiuesit e lartpërmendur bien dakord për këtë fakt, ata

<sup>2</sup> Shih. Elsie, Robert, “Histori e letërsisë shqiptare”, përkth. ang. Abdurrahim Myftiu, “Dukagjini” Tiranë -Pejë 1997, fq. 200-201.

<sup>3</sup> “Historia e letërsisë shqipe”, përg. Instituti i Historisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1959, fq. 551.

<sup>4</sup> Lacaj, Henrik, “Dom Ndoc Nikaj (1864 – 1951), Shënime mbi jetën dhe veprat”, “Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës (seria e shkencave shoqërore), Tiranë, 1963, fq. 189-190.

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> “Në 50-vjetorin e meshtarisë së Dom Ndoc Nikajt”, shkrim redaksional, “Hylli i Dritës”, nr. 7, 1938, fq. 384.

<sup>7</sup> “Pesëdhjetëvjetori i Meshtarisë së D. Ndoc Nikajt”, shkrim redaksional, “Cirka”, vjeti III, nr. 51 - 52, 31 gusht, 1938, fq. 227.

<sup>8</sup> Shih. Qosja, Rexhep, “Historia e Letërsisë Shqipe - Romantizmi I”, “Toena” 2000.

<sup>9</sup> Shih. Plasari, Aurel, “Trembëdhjetë infraksionet e Dom Ndoc Nikajt” në “Shqipëria, zgjim i dhimbshëm”, Tiranë, 1991, fq. 83 - 84.



ndahen për vitin kur romani u botua.

Viti më i hershëm i përmendur është 1889, më së pari në shkrimin redaksional<sup>10</sup> të “Hylli i Dritës” me rastin e 50 - vjetorit të meshtarisë së Nikajt<sup>11</sup> ku renditen të gjitha veprat e autorit. Edhe Karl Gurakuqi, pak vjet më vonë ruan të njëjtën renditje<sup>12</sup>. 1899 na e japin si vitin e botimit të parë edhe Lacaj, Qosja dhe Plasari. Por pavarësisht kërkimeve tona, nuk e kemi gjetur dot një kopje të këtij botimi. Mund të ngrihet dyshimi mos redaksia e *Hyllit* gabon dhe të tjerët citojnë vazhdimisht atë gabim, por kjo duket e çuditshme, pasi ai shkrim botohet në gjallje të autorit. Duhet mbajtur parasysh edhe se Lacaj në artikullin e tij, bën edhe një përshkrim të shkurtër të veprës duke thënë *shkrimtari ynë nxori romanin e shkurtë, por mjaft tërheqës “Marcja”, me të cilin tregoi se ishte një përkthyes apo përshtatës i mirë dhe se gjithnjë mbrenda sferës fetare dinte të zgjidhte subjekte mjaft të kandshme nga grumbulli i romaneve, që flasin mbi martirizimet e të krishterëve në shekujt e parë të salvimeve*<sup>13</sup>. Kështu, ai na bën të besojmë se nuk i është referuar vetëm shkrimeve të mëhershme për Nikajn, por edhe e ka pasur në dorë veprën me këtë vit botimi. Kjo përforcohet edhe nga fakti se në tekstin e përgatitur prej *Institutit të Historisë dhe Letërsisë* më 1959, për *Marcia-n* jepet si vit botimi 1892 dhe arsyeja na çon të mendojmë se Lacaj, po mos ta kishte pasur veprën fizike në dorë, do t’i ishte referuar edhe atij studimi. Po ashtu, sërish në një shkrim me rastin e pesëdhjetë vjetorit të meshtarisë së Nikajt, shkruhet ... *“Vakinat e Kishës” qi u botue në vjetin 1888 në Shtypshkronjën e Propagandës në Romë. Nji vjet mbrapa botoi romancin e vogël “Marcia” që u lexue me shum andje prej së rijsh*<sup>14</sup>. Por prapëseprapë, duke mos e pasur në dorë një kopje të këtij viti botimi, mund të thuhet se kemi të bëjmë me një fantomë.

Robert Elsie<sup>15</sup> dhe Arshi Pipa<sup>16</sup> janë të mendimit se viti i botimit të parë të romanit është 1892. Të njëjtin vit ka edhe kopja më e hershme e

<sup>10</sup> Aurel Plasari në “Trembëdhjetë infraksionet e Dom Ndoc Nikaj” ngre dyshimin për autorësinë, duke thënë *mendimi im është se i përket penës së At Anton Harapit dhe unë si të tijin do ta cek.*

<sup>11</sup> “Në 50 - vjetorin e meshtarisë së Dom Ndoc Nikajt”, art. cit. fq. 390.

<sup>12</sup> Gurakuqi, Karl, “Ndoc Nikaj (1864) “Shkrimtarët Shqiptarë – pjesa II”, në “Shkrimtarët Shqiptarë, Pjesa II”, botim i Ministris s’Arsimit, Tiranë, 1941, fq. 94.

<sup>13</sup> Lacaj, Henrik, “Dom Ndoc Nikaj...”, art. cit., fq. 185.

<sup>14</sup> “Pesdhetvjetori i D. Ndoc Nikajt”, shkrim redaksional, “Gazeta shqipëtare”, 1938, 27 gusht, fq. 2.

<sup>15</sup> Elsie, Robert, vep. cit., fq. 200.

<sup>16</sup> Pipa, Arshi, “Letërsia Shqipe: Perspektiva Shoqërore”, përkth. Myftar Gjana, “Princi”, Tiranë, 2013, fq. 185.

kësaj veprë në fondin e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë<sup>17</sup> e cila gjendet në katër ekzemplarë. Ky botim pasqyrohet edhe te bibliografia e Legrandit, *Bibliographie albanaise* me nr. 557 si dhe te Manek etj., *Albanesische Bibliographie* me nr. 14/1892. Kopje nga ky botim, shtypur në Shtypshkronjën e së *Papërlyemes* kemi pasur në dorë.

Te zëri i *Marcia-s*, Legrand shton: *Ky roman i shkurtër është botuar vetëm në njëqind kopje, siç më është thënë në letrën e tij të datës 20 maj 1899 nga Faik Bej Konica, i cili mori këtë detaj nga autori vetë.*<sup>18</sup>

Më 1893, vepra ribotohet. Përveç vitit në frontespis, është identike me paraardhësen. Disa kopje të saja, të cilat mundëm t'i konsultojmë, gjenden në fondet e BKSh (me nr. 159 te Bibliografia e Vozgës). Ky botim, me vitin 1893 pasqyrohet si botimi i parë dhe i vetëm i veprës "Marcia" në katalogun e botimeve të së *Papërlyemes*, përgatitur prej Luigj Shestanit dhe i mbetur në dorëshkrim<sup>19</sup> si dhe në studimin e Markus W. E. Peters "Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë..."<sup>20</sup>

Zgjidhja për çështjen e vitit të botimit gjendet në vetë fondin arkivor të lënë nga Nikaj, që është pjesë e Arkivit të Shtetit. Është e njohur mania e tij për t'i ripunuar veprat, sikurse ndodh me "Vakinat e Kishës" që 26 vjet pas botimit të parë, del me titullin "T'nollmet e Kishës. Ç'më kohë t'vjetra e deri n'tashmet", "Shtypshkroja Nikaj", Shkodër, 1914 apo me "Historija e Shqypniës. Ç'më kohë t'vjetra e deri m'tashmet" botuar për së pari më 1902 dhe për së dyti, më 1917, sërish në shtypshkronjën e tij.

Faksimili i mëposhtëm autorial nga Nikaj na bën të qartë se ai filloi ta ripunonte edhe *Marcia-n*, por procesi u ndërpre në një pikë dhe në dorëshkrim mbetën vetëm dy kapitujt e parë të librit.

Sikurse shohim, autori e qartëson vetë vitin e botimit duke na thënë se romani u botua më 1892 dhe se në këtë rast, pra të dorëshkrimit që kemi para syve, kemi të bëjmë me një përsëritje nga autori të atij teksti. Ndonëse, ç'është e vërteta, mes kapitullit të parë të *Marcia-s* dhe këtij dorëshkrimi, ndryshimet janë shumë të mëdha, thuajse thelbësore, ndryshe nga sa ndodh me rastin e dy botimeve të "Vakinat" apo "Historia" në të cilët, autori vetë


<sup>17</sup> Shih. Vozga Ramazan, "Libri shqip 1555-1912 në fondet e Bibliotekës Kombëtare", nr. 153, BKSh, Tiranë, 2010.

<sup>18</sup> Legrand, Émile, "Bibliographie Albanaise", ribot., "Botime Françeskane", Shkodër, 2011, fq. 182.

<sup>19</sup> Një kopje e këtij dorëshkrimi është dhuruar pranë BKSh nga familjarët dhe mban titullin "Katalogu i librave të botuem nga shtypshkroja 'Zoja e Papërlyeme' t'etënve jezuit në Shkodër prej vjetit 1871-1928".

<sup>20</sup> W. E. Peters, Markus, "Shtëpia botuese më e vjetër në Shqipëri dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare, arsimin dhe kulturën", përkth. Emond Malaj, "Shoqata e Jezuitëve", Tiranë, 2016, fq. 480.

na thotë se ndryshimet janë kryesisht në rrafsh gjuhësor:



*Kshtu edhe m'ket blëe t'Nollmesh, sikursë nder gjith shkrimet t'ona, kena kerkue me shporrë ato shkronja qi duken e ianë t'teperme...*

*Saa per nduer t'shkrimit t'fialve, per deri m'sot, mundena me thanë qi askush nuk mundet me gjikue e me prozhmue tietrin, pse deri m'tash nuk âsht shestue nji fillce shkrimit qi t'n'a diftoinë per njimënd sî do t'shkruhet fiala.<sup>21</sup>*

### Romani

“Marcia o kshtenimi n'filles t'vet” tregon historinë e një paganeje, shërbestare në tempullin e perëndeshës

Vesta e cila, si gjithë shërbestaret e tjera, virgjërinë e kishte të shenjtë. Ajo rridhte nga një familje e njohur dhe e pasur, por që fëmijë, i qe dorëzuar tempullit. Ngjarjet ndodhin në vitet e para pas Krishtit, kohë kur akoma feja po përhapej nëpërmjet udhës apostolike.

Perandori, për një krim të pakryer, dënon vëllain e saj, Severin, me vdekje, por ai arrin të arratiset dhe, para se të lërë atdheun, vendos të shkojë e të takojë të motrën. Ishte një nga netët në të cilat ajo duhet të ruante zjarrin që të mos fikej në tempullin ku shërbente. Sapo sheh të vëllain, Marcia del dhe e përqafon. Por biseda zgjat aq sa zjarri fiket e për më tepër, njerëzit e shohin duke përqafuar një burrë.

Gjyqi vendos ta gjykojë dhe për këto krime, e dënon me vdekje, duke e varrosur për së gjalli në një guvë të nëndheshme. Aty i lënë vetëm pak ujë dhe bukë sa të shtyjë për një ditë. Teksa ishte në agoni, sheh mirazhin e një engjëlli që vjen dhe e shpëton. Në fakt ishte shoqja e saj, Prudenzia bashkë me të motrën, Preseidën dhe të tjerë njerëz, të njohur e të panjohur që kishin përqafuar krishtërimin. Ato e strehojnë dhe Marcia fillon të njohë Krishtin nëpërmjet tyre.

Pas një kohe të shkurtër, pagëzohet dhe kërkon që bashkë me të tjerët, t'u shërbejë të krishterëve, në atë kohë të salvuar, të burgosur dhe të dënuar nga pushteti i Romës. Me anë të rryshfetit, Presedia e të tjerët arrinin të

<sup>21</sup> Nikaj, Ndoc, “T’ nollmet e kishës”, “Nikaj”, Shkodër, 1914, fq. 14.

futeshin në burgjet ku vuanin apo prisnin vdekjen të krishterët dhe t'i ngushëllonin, t'i ushqenin apo t'u jepnin ndonjë ndihmë tjetër.

Në një prej atyre ditëve, në një qeli, Marcia sheh të shpërfytyruar vëllain e saj dhe vendos ta ndihmojë e ta shpëtojë. Ai, nga ekzili kishte njohur Krishtin dhe qe kthyer për të shpërndarë fjalën e tij në Romë. Kur del në gjyq, nën tortura të tmerrshme i kërkojnë të mohojë Krishtin, por Severi nuk pranon. Gjatë torturave, atij i del gjak dhe e motra, me një façetë, ia fshin. Gjyqtari pyet kush është ajo dhe Marcia i thotë: "Jam motra e Martirit!". Gjyqtari e dënon edhe atë me vdekje, sipas një dënimi të zakonshëm në atë kohë kundër të krishterëve: Në një arenë me luanë të uritur. Ajo vdiq dhe u varros në katakombet romane.

Romani synon kështu të tregojë vuajtjet e të krishterëve të parë dhe gatishmërinë e tyre për t'u sakrifikuar për Krishtin; po ashtu, ai rrëfen edhe mënyrën e jetesës së fshehtë të të krishterëve (që deri në vitin 313 ishin të paligjshëm në Perandorinë Romake) dhe konvertimin e paganëve në të krishterë, vëllazërinë e bashkësive të krishtera dhe përmasat e jashtëzakonshme të dashurisë së tyre dhe mizorisë së romakëve.

### **Dramatizimi i veprës**

Në fillimet e viteve '20, zhanri i dramës në Shqipëri po nxirrte krye ngadalë, me brishtësi. Secila dramë ishte një kontribut jo i vogël për pasurimin hap pas hap të kësaj forme të re artistike, pak të njohur dhe tepër të pëlqyer nga publiku. Ishte kohë pra, kur nuk kishte mirëfilli dramaturgë, ndaj personalitete të angazhuar në të tjera fusha të shkrimit, ndonjëherë shkruanin edhe drama. Mes tyre ishte edhe dom Ndoci i cili, subjektin e romanit të tij "Marcia" e kthen në dramë me titull *Motra për vllan* dhe e boton në vitin 1924. Drama ka tetë të dukuna (skena) dhe qysh në mbititull, sqarohet se është një *Çfatime teatrore për varza*, pra për shkollat apo institutet vajznore të kohës.

Personazhet e romanit portretizohen më mirë në dramë, marrin karakteristika më konkrete dhe diskutimet e bisedat i qasen më natyrshëm gjuhës së zakonshme të popullit, duke u vënë re edhe një shkëputje e lehtë prej asaj mahnitjeje hyjnore e frymëzuese që lexojmë në faqet e romanit. Po ashtu, tematika lëviz; nga një vepër e kushtuar sakrificës për Zotin nëpërmjet martirizimit të të krishterëve të parë, tani kemi të bëjmë me një vepër ku tregohet deri në ç'pikë mund të arrijë sakrifica e motrës për të vëllanë, dhe ky variant i tekstit është shumë më larg atij origjinar pasi, sikundër e thamë më lart e do ta sqarojmë në vijim, kemi të bëjmë me një roman që nuk është tërësisht krijim vetjak i autorit, por përshtatje dhe

ritregim i një teksti pararendës.

### Origjina e tekstit

Në frontespicin e romanit sqarohet *E citi n'giuhë sçyptare D. Nnoz Njkai*. Po ç'domethënë “e çiti”? Nuk është e zakonshme si formë shprehjeje, përktheu, përshtati, solli po, por çiti? Gjithsesi, duke bërë këtë sqarim, autori tregohet krejt i hapur me lexuesin, ndryshe nga të tjerë autorë të kohës e të mëvonshëm.<sup>22</sup>

Kjo fjalë na bindi se në fakt, nuk kishim të bënim me një tekst tërësisht origjinal të autorit, se burimi për shkrimin e këtij libri vinte nga diku dhe tani na mbetej të zbulonim edhe burimin, edhe qasjen e autorit në të.

Nëse subjekti tregonte jetën e një martireje të vërtetë të krishtërimit, pra rrëfimin e jetës së një shenjtë, çka ishte subjekti i një pjese të madhe të librave të botuar në ato vite, atëherë patjetër martirja me emrin Marcia do të gjendej në indeksin e *Martyrologium Romanum*, vepra përmbledhëse e të të gjithë martirëve të kishës katolike romane. Pavarësisht kërkimeve tona në disa prej botimeve, nga më të hershmet e referencialet, deri te më të vonat, nuk mundëm të gjenim një martire me emrin dhe fatin e personazhit tonë. Pastaj kërkimin e orientuam duke pasur parasysh datën e martirizimit, të treguar në fundin e librit ku përshkruhet rrasa e varrit të Marcias në katakombet e Romës: dymbëdhjetë prill. Asnjë nga të krishterët e martirizuar atë datë të ndonjë viti nuk ndante histori të njëjtë me personazhin. Vajtëm akoma më larg: Në kohën kur ndodhin ngjarjet në roman, në Romë funksiononte kalendari julian. Konvertuam datën 12 prill të kalendarit julian në gjegjësen e tij të kalendarit gregorian, pasi e *Martyrologium Romanum* u botua pas këtij ndryshimi, por sërish nuk qe një kërkim i frytshëm.<sup>23</sup>

Hoqëm dorë nga ideja se kishim të bënim me një personazh të vërtetë historiko-fetar dhe, duke mbajtur parasysh faktin se shpesh në vitet e para të krishtërimit, fate të vërteta rrëfeheshin nëpërmjet personazhesh të

<sup>22</sup> Shih. Plasari, Aurel “Traditë letrare, historizëm, estetizëm”, “Studime Albanologjike”, 2008/2, fq. 14. Në të, Plasari tregon dy poezi të atë Vinçens Prennushit nuk janë krijime, por përkthime. Kështu, në rastin e “Grueja Shqyptare” kemi të bëjmë me diçka mes një përkthimi të lirshëm, një adaptim të shthurur të poezisë “La donna italiana” të poetit Giuseppe Regaldi, dhe se origjinalin e poezisë “Burri Shqyptar” e gjejmë me titull “I martiri di Palermo” të po të njëjtit autor.

<sup>23</sup> Ky ndryshim ndodhi pikërisht para botimit të *Martyrologium Romanum*. Ai ndryshon me dhjetë ditë nga paraardhësi. Më 1582, 4 tetori u ndoq menjëherë nga 15 tetori. Kështu 12 prilli julian i konvertuar në kalendarin gregorian do të jepte datën 23 prill.

trilluara pasi mungonte mundësia për një dokumentim historik, por ngjarja kalonte e rrëfyer gojë më gojë, kërkuam ta gjenim mes të tilla teksteve edhe origjinarin e romanit të Nikajt. Dhe pasi kërkuam në katalogjet e pjesës më të madhe të bibliotekave evropiane, ramë në gjurmët e atij materiali.

Bëhet fjalë për librin *Marcia la vestale; Raconto Storico; dei primi tempi del cristianesimo* shkruar nga Enrico Mastracchi, botuar në Firence më 1875. Në frontespice, po ashtu, tregohet se kemi të bëjmë me një reduktim të variantit frëng i cili nuk përmendet me titull origjinal, ndaj nuk e identifikua dot. Të njëjtën metodë, atë të reduktimit ndjek edhe Nikaj me variantin e Mastracchi-t, duke na dhënë në shqip një libër më pak voluminoz për nga përmbajtja.

Meqë nuk e kemi të identifikuar tekstin frëng, nuk mund ta dimë dot nëse metodika e punës së Mastracchi-t ka përfshirë edhe doza origjinaliteti në vepër, por nga ai variant të i mëvonshmi i Nikajt po, autori i ri, *xhakue* sikurse thotë vetë te kujtimet e veta<sup>24</sup>, i jep vetes të drejtën për një dozë të arsyeshme kreativiteti. Ndryshimi tërësor ose ritregimi me fjalët, shprehjet dhe stilin e tij prej shkrimtari të pjekur tanimë, duket se ka qenë dëshira e mëvonshme e autorit.

## PËRFUNDIME

I botuar në vitin 1892, *Marcia* mbetet romani i parë në gjuhën shqipe, sjellë nga dom Ndoc Nikaj. Aty trajtohet jeta e një shërbestareje pagane në tempullin e perëndeshës Vesta në shekullin I pas Krishtit. Në këtë roman, Nikaj realizon një ritregim të një teksti pararendës, *Marcia la vestale; Raconto Storico; dei primi tempi del cristianesimo* shkruar nga Enrico Mastracchi dhe botuar në vitin 1875.

Drama *Motra për vlla* bën që për herë të parë në letërsinë shqipe të shfaqet dukuria e “shtegtimit të subjektit”, ku subjekti i romanit *Marcia* kthehet në subjekt dramatik.

Nën kujdesin e Andreas Dushit, *Marcia* është ribotuar nga shtëpia botuese “Onufri” pas 131 vitesh.

---

<sup>24</sup> Shih. Nikaj, Ndoc, “Kujtime të një jete së kalueme”, “Onufri”, Tiranë, 2016, fq. 10.

**BIBLIOGRAFI:**

- Nikaj, Ndoc “Kujtime të një jete së kalueme”, “Onufri” Tiranë, 2016.
- Elsie, Robert, “Histori e letërsisë shqiptare”, përkth. ang. Abdurrahim Myftiu, “Dukagjini” Tiranë-Pejë 1997.
- Qosja, Rexhep, “Historia e Letërsisë Shqipe – Romantizmi I”, “Toena” 2000.
- Plasari, Aurel, “Trembëdhjetë infraksionet e Dom Ndoc Nikajt” në “Shqipëria, zgjim i dhimbshëm”, Tiranë, 1991.
- Gurakuqi, Karl, “Ndoc Nikaj (1864) “Shkrimtarët Shqiptarë – pjesa II”, në “Shkrimtarët Shqiptarë, Pjesa II”, botim i Ministrisë së Arsimit, Tiranë, 1941.
- Pipa, Arshi, “Letërsia Shqipe: Perspektiva Shoqërore”, përkth. Myftar Gjani, “Princi”, Tiranë, 2013.
- Vozga Ramazan, “Libri shqip 1555-1912 në fondet e Bibliotekës Kombëtare”, nr. 153, BKSh, Tiranë, 2010.
- Legrand, Émile, “Bibliographie Albanaise”, ribot., “Botime Françeskane”, Shkodër, 2011.
- W. E. Peters, Markus, “Shtëpia botuese më e vjetër në Shqipëri dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare, arsimin dhe kulturën”, përkth. Emond Malaj, “Shoqata e Jezuitëve”, Tiranë, 2016.
- Nikaj, Ndoc, “T’ nollmet e kishës”, “Nikaj”, Shkodër, 1914.
- Krasniqi, Bajram: Poetika e romanit historik shqiptar, Instituti i Albanologjisë Prishtinë 1985.
- Puka, Gëzim; Çuni, Gjovalin: Parathënie e romanit “Fejesa n’ djep a se Ulqini i marrun” Shtëpia botuese “Diti&Oli”, Ulqin, 2017.
- “Historia e letërsisë shqipe”, përg. Instituti i Historisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1959.
- Lacaj, Henrik, “Dom Ndoc Nikaj (1864 – 1951), Shënime mbi jetën dhe veprat”, “Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës (seria e shkencave shoqërore), Tiranë, 1963.
- “Në 50-vjetorin e meshtarisë së Dom Ndoc Nikajt”, shkrim redaksional, “Hylli i Dritës”, nr. 7, 1938.
- “Pesëdhjetvjetori i Meshtarisë së D. Ndoc Nikajt”, shkrim redaksional, “Cirka”, vjeti III, nr. 51-52, 31 gusht, 1938.
- “Pesëdhjetvjetori i D. Ndoc Nikajt”, shkrim redaksional, “Gazeta shqipëtare”, 1938, 27 gusht.
- Plasari, Aurel “Traditë letrare, historizëm, estetizëm”, “Studime Albanologjike”, 2008/2.

**Marcia, the first novel in the Albanian language*****ABSTRACT***

The novel “Marcia, ase kshtenimi n’filles t’vet” (Marcia, or the Cristianity at Its Beginning), first published in 1892, is the first novel to be published in the Albanian language. It was prepared by Dom Ndoc Nikaj, based on a preceding text in Italian, the subject of which Nikaj retells.

This article presents the original source text while also examining the characteristics of Nikaj's “Marcia” as well as the journey of its subject from the novel genre to another genre, that of drama, where the author remains the same.

Additionally, thanks to Nikaj's authorial manuscripts, the date of the first publication is clarified, thereby correcting an incorrect year that had been offered as the publication date during the author's lifetime.



**Sereta KOPERAJ**  
**Bendis KRAJA**

## **LËVIZJA KAÇAKE GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE (NË VITET 1916-1918). LUFTA DHE DIPLOMACIA ME AUSTRO-HUNGAREZËT**

Fillimi i Luftës së Parë Botërore do ta gjente Shqipërinë në një situatë tejet të trazuar. Shteti i ri shqiptar, “*një pëllëmbë i gjerë dhe dy pëllëmbë i gjatë*” (siç quhej me një ironi të trishtë nga gazeta *Përlindja e Shqypnjes*, për shkak të mbetjes jashtë kufijve të tij të gjysmës së territoreve shqiptare), në tri vitet e para të ekzistencës së tij kishte përjetuar një paqëndrueshmëri politike dhe socialekonomike, kufij të pasigurt, një krizë komplekse që vinte si rezultat i kryengritjeve dhe rebelimeve të njëpasnjëshme. Sikur të mos mjaftonte kjo, territoret shqiptare, edhe pse në dukje periferike e neutrale për interesat e Fuqive të Mëdha, shumë shpejt do të ktheheshin në një shesh lufte ku do të përplaseshin sërish interesat e synimet për hegjemoni në të gjithë bregun lindor të Adriatikut dhe më gjerë në Ballkan.

Perandoria e Austro - Hungarisë do të shfaqej që në fillim si “aktori kryesor”<sup>1</sup>, por edhe shtetet e reja ballkanike e shihnin luftën si një rast të ri për të përmbushur synimet e tyre, duke i shndërruar krahinat shqiptare në arena të përgjakshme të luftës. Lufta e Madhe, ndryshe nga mjaft territore të tjera ku ajo “luhej”, në viset shqiptare nuk do të sillte vetëm beteja ushtrish, por edhe bastisje, masakra dhe spastrime etnike ndaj popullatës civile. Ky realitet i ri do të konfiguronte edhe të ashtuquajturën “lëvizje kaçake”, e cila edhe sot e kësaj dite mund të konsiderohet si një prej formave më të qarta të reagimit kombëtar shqiptar të periudhës së pavarësisë. Kjo lëvizje, e cila zuri fill që me luftërat ballkanike në mbrojtje të territoreve dhe popullsisë shqiptare, tani do të ndeshej me pushtues të rinj, ndërsa armiqtë e vjetër do t’i kërkonin bashkëpunim. Megjithëse lëvizja kaçake, në të shumtën e rasteve ishte pa ndonjë lidhje të brendshme e pa ndonjë qendër drejtuese, ajo kishte liderët e saj, ndër të cilët do të spikaste Azem Galica.

Jemi përqendruar pikërisht te kjo periudhë trevjeçare (1916-1918) të lëvizjes kaçake, sepse (për mendimin tonë) paraqet një prej periudhave më dinamike, por edhe më komplekse, për faktorin shqiptar, sidomos përsa i

---

<sup>1</sup> Krisztián Csaplár-Degovics, *Austro-Hungarian Colonial Ventures: The Case of Albania*, në *Hungarian Historical Review*, vëll. 11, nr. 2, 2022, f. 273 - 274.

përket orientimit që duhej mbajtur në lidhje me të ardhmen e shtetit shqiptar, në plan të ngushtë, por edhe të kombit në një plan më të gjerë.

Ajo që të bën përshtypje, është se lëvizja kaçake, sidomos ajo pjesë e saj e drejtuar nga Azem Galica, ndryshe nga shumë elementë të tjerë nacionalistë e grupe patriotike të kohës, do të mbante ndaj forcave austro-hungareze vetëm një qëndrim, atë të rezistencës së armatosur. Një qëndrim i tillë mbetet ende edhe sot e kësaj dite një prej pikave më të diskutueshme në historiografinë shqiptare mbi zhvillimet e Luftës së Parë Botërore në territoret shqiptare, pasi siç shprehet studiuesi dhe shkrimtari Jusuf Buxhovi në veprën e tij “Kosova 1912-1945” (citoj) “*Lëvizja kaçake u ballafaqua me realitete të dyfishta*”<sup>2</sup>. Nëse kjo lëvizje kishte filluar si ballafaqim i armatosur ndaj masakrave serbe, në 1916 realiteti kishte ndryshuar, armiqtë e deridjeshëm ishin thyer keqas dhe vendi sundohej nga një ushtri tjetër.

Në përgjithësi, edhe para fillimit të Luftës, rrethet patriotike shqiptare prisnin shumë nga Austro-Hungaria, e cila në Konferencën e Londrës, kishte dalë në mbrojtje të pavarësisë së Shqipërisë dhe kundër copëtimit të territoreve që kishin qenë të banuara nga një shumicë popullsie shqiptare.

Prandaj, që me mësymjen e forcave austro-hungareze në Ballkan dhe futjen e tyre në territoret shqiptare, një pjesë e konsiderueshme e faktorit politik shqiptar kishin parë te perandoria dualiste jo një pushtues, por ardhjen e një Fuqie të Madhe që mund të ndikonte për mirë në interesat e shqiptarëve.

Prania e forcave ushtarake austro-hungareze, kryesisht në pjesën veriore të vendit në 1916, kishte filluar të ushqente shpresa të mëdha se në mbarimin e luftës së Madhe, nëse aleanca Vjenë - Berlin do të fitonte, Perandoria e Austro-Hungarisë do të bënte jo vetëm rimëkëmbjen e pavarësisë, por edhe do të rishikonte çështjen e kufijve të shtetit shqiptar, duke përfshirë edhe territoret e banuara nga shqiptarët etnikë, kryesisht ata të Kosovës.

Në këtë këndvështrim mund të kuptohet qartë edhe përkrahja që grupe patriotësh shqiptarë filluan t’u jepnin autoriteteve ushtarake austro-hungareze. Pikërisht në këtë kohë, mjaft prej këtyre të fundit, do t’u kërkonin shqiptarëve jo vetëm të mos i kundërshtonin e të mos reagonin ndaj forcave ushtarake dhe administratës austro-hungareze, por edhe t’i ndihmonin ata (siç ishte rasti i thirrjes së bërë nga Luigj Gurakuqi dhe Preng Bibdoda popullit të Shkodrës në kapërcyellin e viteve 1916-1917)<sup>3</sup>,

<sup>2</sup> Jusuf Buxhovi, *Kosova 1912-1945*, Prishtinë, 2022, f. 162.

<sup>3</sup> Lef Nosi, *Dokumente historike për me i shërbye historisë sonë kombëtare*, Elbasan, 1924, f. 18.

sidomos pas shpalljes së autonomisë.

Në mjaft rrethe patriotësh filloi të sendërtohej ideja për krijimin e një shteti të përbashkët shqiptar, se vetëm fitorja e Austro-Hungarisë mund të ndryshonte kufijtë e vendosur padrejtësisht më 1913. Madje vetë Vjena do të kujdesej që të krijonte këtë aureolë të protektores së shqiptarëve dhe interesave të tyre. Jo rastësisht, në janar të vitit 1917, pas shpalljes së autonomisë, në Shkodër do të riqarkullonte një memorandum që Syrja Bej Vlora i kishte bërë disa vite më parë ministrisë së jashtme austro-hungareze në të cilin shkruhej: *“Siç e di mirë shpirti i bashkatdhetarëve të mi shqiptarë, do të favorizohemi nëse biem nën protektoratin e Austro-Hungarisë, nëpërmjet krijimit të një krahine autonome, sepse për momentin nuk kemi pjekurinë e nevojshme për të krijuar një Shqipëri të pavarur, preferojmë Austro-Hungarinë mbi çdo fuqi tjetër të huaj. Edhe shtresat më të ulëta të popullit tonë e dinë se deri në çfarë pike qeveria austro-hungareze i respekton fetë dhe zakonet tona”*<sup>4</sup>.

Për më tepër, shqiptarëve u ishte njohur mbajtja e flamurit të tyre kombëtar dhe hapja e shkollave në gjuhën shqipe.

Atëherë me të drejtë mund të shtrohet njëherë pyetja: pse lëvizja kaçake vijonte të luftonte kundër tyre, pse Azem Galica *“nuk ua ndau grykën e pushkës”*?<sup>5</sup> Pse reagimi i Azem Galicës dhe i çetës së tij nuk do të ishte i njëjtë me atë të atdhetarëve të tjerë brenda kufijve të shtetit shqiptar, por do t’i konsideronte si pushtues edhe austro - hungarezët? A ishte kjo lëvizje pa drejtim, e pastrukturuar, që vepronte dhe luftonte fshehurazi dhe që nuk kishte lidhje me aktivitetin politik e diplomatik që zhvillohej përreth?

Në fakt, po t’i bëjmë një analizë situatës ushtarake dhe politike të kësaj periudhe do të shohim se qëndrimi dhe veprimi i kësaj lëvizjeje, e sidomos i Azem Galicës ka qenë më i orientuari, dhe koha i dha të drejtë jo vetëm se fituan forcat e Antantës, por edhe se synimet e planet e Ballhausplatz-it (kancelarisë austro-hungareze) për Shqipërinë dhe shqiptarët nuk ishin të tilla siç i perceptonin mjaft qarqe politike dhe patriotike shqiptare.

Madje, që në vitet e para të Pavarësisë së Shqipërisë, perandoria kishte luajtur një lojë të rrezikshme në lidhje me shtetin shqiptar. Në mënyrë të paqartë, Austro-Hungaria kishte miratuar një monark të dobët dhe joekspert si Princ Widi, me shpresën për të krijuar një pretekst për të

<sup>4</sup> HHStA, (Politisches Archiv), PA I: k. 473, Fol.100; Syrja Vlora, Kujtime: Nga fundi i sundimit Osman deri në Luftën e Vlorës, Tiranë, 2013, f. 81.

<sup>5</sup> Ajet Haxhiu, Shota dhe Azem Galica, Tiranë, 1976, f. 49.

ndërhyrë ushtarakisht<sup>6</sup>; kishte ndalur mbështetjen financiare si pjesë e detyrimeve ndërkombëtare nga Konferencat e Londrës të viteve 1912-13 dhe nuk mbajti një rol aktiv në zgjidhjen e krizave dhe rebelimeve të viteve 1914-1916 në Shqipëri, pavarësisht se e kishte konsideruar detyrën e saj si mbrojtëse të shtetit të ri shqiptar<sup>7</sup>.

Por edhe me fillimin e Luftës Botërore, pas pushtimit të territoreve shqiptare, Perandoria hungareze nuk ishte e qartë se çfarë synimesh kishte për të ardhmen e Shqipërisë. Në Vjenë, që më 1916 ekzistonin dy strategji mbi Shqipërinë dhe shqiptarët. Njëra, ajo e ministrisë së jashtme, hartuar nga Baroni von Burian, synonte një protektorat që do të ndihmonte për të ngritur një shtet shqiptar, i cili do t'i kundërvuhej influencës sllave, por edhe asaj italiane. Një shtet që do të mbahej vetë, por që do të kishte mbështetjen perandorake në diplomacinë ndërkombëtare. Strategjia e dytë, ishte ajo e hartuar nga shefi i shtabit të shtatmadhorisë, Josef Conrad von Hötzendorf, për të cilin një Shqipëri e pavarur nuk ishte e qëndrueshme. Në një rast të tillë kontrolli austro-hungarez mbi këtë zonë do të kishte qenë *de facto* vetëm në letër. Për këtë arsye, shtabi i luftës argumentonte një aneksim të plotë. Çdo zgjidhje tjetër konsiderohej prej tij si *reductio ad absurdum* të arsyeve pse Monarkia kishte hyrë në luftë<sup>8</sup>. Të dyja linjat u ndoqën në terren, duke mbajtur një protektorat mjaft të çuditshëm gjysmushtarak dhe gjysmëcivil<sup>9</sup>, në zonat e pushtuara të Shqipërisë në vitet 1916-1918.

Kësaj duhet t'i shtohet edhe një faktor tjetër që kushtëzoi lëvizjen kaçake t'i kundërvihet ushtrisë austro-hungareze: aleatja ballkanike e kësaj të fundit, Bullgaria. Kosova ishte ndarë më dysh: nga njëra anë austro-hungarezët e nga ana tjetër forcat bullgare<sup>10</sup>. Ndryshe nga territoret që administroheshin nga austriakët, aty ku kishin shkelur trupat bullgare nuk kishte ndonjë ndryshim me serbët. Jo vetëm që nuk lejoheshin simbolet kombëtare, si flamuri, administrata civile nga vendasit, por kësaj i shtohej

<sup>6</sup> Teodora Toleva, *Der Einfluss Österreich-Ungarns auf die Bildung der albanischen Nation*, Routledge, 2013, f. 116.

<sup>7</sup> Marvin Benjamin Fried, *The Cornerstone of Balkan Power Projection: Austro-Hungarian War Aims and the Problem of Albanian Neutrality, 1914–1918*, në *Diplomacy & Statecraft*, nr. 31, 2020, f. 434.

<sup>8</sup> Miklós Komjáthy, *Protokolle des Gemeinsamen Ministerrates der Österreichisch-Ungarischen Monarchie (1914–19)*, Budapest 1966. Dokumentacioni është i dt. 4. 1. 1916, f. 374 -381.

<sup>9</sup> Anastas Bezha, *Austria-Hungary and the Albanian Project A Comparative Case Study: Between support and imperialism*, f.150.

<sup>10</sup> Martin Valkov, *When Bulgaria and Austria-Hungary were Neighbors: Agreements and Disagreements on the New Bulgarian Western Border, 1915–1918*. Në revistën “Research Center for the Humanities”, Budapest, 2020, f. 240.

edhe forma represive dhe terrori që ushtrohej ndaj popullsisë së pambrojtur. Gjendja e vështirë e shqiptarëve nën pushtimin bullgar në Kosovën Lindore dhe qëndrimet e xhandarmërisë austro-hungareze për çarmatosjen me çdo kusht të kryengritësve të cilët nuk pranonin t'i dorëzonin armët, do të çonin lëvizjen e Azem Galicës në një fazë të re. Më 1917, në Radishevë ai do të bashkonte forcat e veta me çetat e Drenicës që drejtoheshin nga Shaqir Smaka, duke u kthyer në një forcë serioze që tashmë i krijonte probleme reale të dy palëve austro-hungareze dhe bullgare.

Këtu ia vlen të përmenden edhe përpjekjet austro-hungareze për të ngritur regjimente ushtarake shqiptare që do të luftonin përkrah atyre perandorake. Që në fund të vitit 1915, kur perandoria habsburgase filloi të shihte si problem burimet njerëzore për frontin e luftës, u përpoq të ngrinte trupa me ata popuj të cilët ishin nën sundimin e saj. Në Ballkan përpjekjet u fokusuan te shqiptarët dhe boshnjakët. Tentativa e parë ishte me Hasan Prishtinën, por që nuk u realizua<sup>11</sup>, por nëse i referohemi dokumentacionit austriak të asaj periudhe na del se përpjekje të tilla janë bërë edhe me drejtuesit e lëvizjes kaçake. Sipas Shtabit të Përgjithshëm, në raportin e oficerit dhe më pas historianit ushtarak *Hugo Kerchnawe*, theksohet përfshirja dhe përdorimi i kaçakëve, e më pas përpjekjet për rekrutim të gjeneral Gilardit në zonat e Prizrenit dhe Pejës.

*“Është e kuptueshme që në këto rrethana janë bërë përpjekje për të përdorur burimet njerëzore të vendit për qëllime thjesht luftarake, jo si çlirimtarë, por si aleatë, duke përmbushur në të njëjtën kohë dëshirat luftarake të popullsisë vendase. Në këtë mënyrë, ne duhet të qetësojmë fillimisht elementët shqetësues si komitët dhe kaçakët, e t'i përdorim ata kudo ku mund të shprehin shpirtin e tyre luftarak në një mënyrë të përshtatshme për perandorinë”<sup>12</sup>.*

Por mesa duket plane të tilla, qoftë ai i 1915, qoftë ai i 1916 nuk funksionuan. Maksimumi u ngritën vetëm trupa xhandarmërie të cilat kujdeseshin për rendin, por që nuk merrnin pjesë në operacionet luftarake.

Armiqësia me austro-hungarezët do të vazhdojë deri në fund. Kështu, gjatë vitit 1918, kur një pjesë e forcave austro-hungareze ishin në tërheqje e sipër, te vendi i quajtur *“Prroni i keq”*, pranë Pejës ata do të binin në pritën e kaçakëve shqiptarë që drejtoheshin nga Azem Galica. Rreth 1000 robërit e kapur do t'i dorëzoheshin trupave franceze të gjeneral Esperisë që kishin filluar ofensivën e tyre nga Selaniku. Në hulumtimet arkivore që kemi bërë kemi ndeshur një fakt interesant. Në hartat e

<sup>11</sup> ÖStA KA, NFA, KK XIX. Korps, K. 2574, February 1, 1916; A. Bezha, *Albanian Troops in the Austro-Hungarian Army during World War I*, f.150.

<sup>12</sup> Hugo Kerchnawe, *Militärverwaltung in Montenegro und Albanien*, 304.

operacioneve ushtarake të forcave austro-hungareze përgjatë gjysmës së dytë të vitit 1918,<sup>13</sup> me të kuqe (siç i shënonin trupat armike) shfaqet edhe një forcë tjetër: banditët shqiptarë (duke i etiketuar kështu çetat shqiptare që luftonin kundër tyre në Kosovë).

Me këtë parashtrim të shkurtër, i cili prek disa pika dhe ngjarje komplekse, u munduam të paraqesim konsistencën dhe orientimin e një lëvizjeje që veproi në rrethana të tilla, ku përballë kishin pushtues me ushtri dhe polici të organizuar, me shtete që kishin diplomaci dhe institucione të përgatitura që më parë për gjithfarë manovrimesh.

Jo rrallëherë, bashkëkohësit e tyre dhe studiues të mëvonshëm janë munduar ta gjykojnë lëvizjen kaçake dhe drejtuesit e saj duke u mbështetur në këndvështrimet e faktorëve patriarkalë, në rudimente të organizimit të feudalëve vendorë apo fiseve dhe bajraqeve, por diçka duhet të kemi parasysh se orientimi dhe busulla e tyre ishte vetëm një: atdheu i bashkuar. Azem Galica dhe luftëtarët e tij ishin të gatshëm për ta mbrojtur atdheun me çdo çmim. Këtë e treguan edhe në vitet në vijim.

Azem dhe Shote Galica janë personazhet historike që simbolizojnë lidhjet e forta të Shkodrës me Kosovën. Në dimrin e vitit 1920, kur Azemi dhe Shota erdhën në Shkodër, sipas mjaft burimeve të asaj kohe, qytetarë të shumtë kishin dalë t'i pritnin. Madje, do të kishte edhe rivalitet ndër familjet e mëdha qytetare se kush do t'i mirëpriste heronjtë e Kosovës. Shkodra, përveç Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës dhe strehimit të refugjatëve që shpërnguleshin nga lufta do të fiksonte në foto Shotën dhe Azemin në Studion e Marubëve (siç thuhet e vetmja foto e vërtetë e çiftit Azem dhe Shote Galica), duke siguruar përjetësimin jo vetëm të heroizmit, por edhe imazhit të tyre.

---

<sup>13</sup> Das Kriegsjahr 1918; vëll. VII. Me suplemente. Bëhet fjalë për hartat e datave 6 tetor 1918 dhe 4 nëntor 1918.

**BIBLIOGRAFI:**

- Bezha, Anastas: *The Rise of a National Army or a Colonial One? Albanian Troops in the Austro-Hungarian Army during World War I*, në *Hungarian Historical Review* 11, nr. 1, 2022.
- Bridge, Francis Roy: *Tarde Venientibus Ossa. Austro-Hungarian Colonial Aspirations, 1913–1914.* *Middle Eastern Studies* 6, nr. 3, 1970.
- Buxhovi, Jusuf: *Kosova 1912-1945*, Prishtinë, 2022.
- Clayer, Nathalie: *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar: Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*. Tiranë, 2012.
- Fundić, Dušan: *Austro-hungarian imperial project and its rivals (1912-1914)*, në "The Balkans in the Age of New Imperialism and Beyond", Bucharest, 2019, f. 59 - 62.
- Fried, Marvin: *Austro-Hungarian War Aims in the Balkans during World War I*, Palgrave, NY, 2014.
- Haxhiu, Ajet: *Shota dhe Azem Galica*, Tiranë, 1976.

**The Kaçak movement of Azem Galica during the First World War (in the years 1916-1918). War and diplomacy with the Austro-Hungarians.****ABSTRACT**

Since the outbreak of the First World War, the Albanian territories, although seemingly peripheral and neutral for the interests of the Great Powers, would turn into a battlefield where the interests and goals for hegemony would collide on the entire eastern coast of the Adriatic and wider in the Balkans. In addition to Austria-Hungary, the new Balkan states also saw the war as a new opportunity to fulfill their goals, transforming the Albanian provinces into bloody arenas of war, which, unlike many other territories where it was "played", there would not only be army battles, but also raids, massacres and ethnic cleansing against the civilian population. The article aims to present and analyze the developments that took place in the Albanian territories during the years 1916-1918, especially that of Kosovo and northern Albania. Referring to the Kaçak movement led by Azem Galica, especially in the area of Peja during this period, the dynamism of the developments of the Albanian factor towards the warring forces stands out. The fighters of A. Galica were among the first to make the most serious resistance to the Austrian and Bulgarian troops, but seeing

the changes of the dualist empire towards the Albanians, especially in the preservation of national identity, the Kaçak movement changed its attitude, turning the target, now against neighboring chauvinist armies. Subsequent events would show that the leaders of this movement had been quite clear in diplomatic movements and military actions, having a single goal of protecting and uniting the Albanian territories.



Sokol AXHEMI

## LËVIZJET MIGRUESE DHE DINAMIKA E ZHVILLIMIT TË ZONAVE RURALE NË SHQIPËRI

### *Hyrje*

Zhvillimi i zonave rurale në Shqipëri është shoqëruar me një dinamikë mjaft intensive gjatë periudhave të ndryshme kohore. Një dinamikë e tillë ka qenë e ndikuar dhe vazhdon të jetë nën efektin e mjaft faktorëve interesantë natyrorë, ekonomikë dhe humanë, për të cilët është e nevojshme dhe e domosdoshme jo vetëm të evidentohen, por edhe të studiohen dhe analizohen në mënyrë të detajuar. Në varësi të tyre janë krijuar tipologji të veçanta të zonave rurale, klasifikime shkencore të identifikimit të tyre, si dhe organizime dhe ndarje administrative specifike. Një situatë e tillë është prezente pothuajse në tërësinë e ndarjeve administrative të vendit tonë, pra të bashkive të Shqipërisë. Vlerësojmë se mjaft evidente shfaqen tiparet e dinamizimit të problematikave të ndryshme që këto njësi administrative bartin në vetvete, si të karakterit social, demografik, ekonomik, administrativ.

Në tërësinë e faktorëve ndikues të zhvillimeve që kanë prekur në evolucionin e tyre zonat rurale, një ndikim shumë të rëndësishëm dhe mjaft efektiv kanë pasur zhvillimet e popullsisë. Në këtë drejtim duhet të vlerësojmë raportet që kanë bashkëshoqëruar ecurinë e zonave rurale në raport me shtesat natyrore të popullsisë (dedikuar ndryshimeve të shfaqura ndërmjet dimensioneve të lindshmërisë dhe vdekshmërisë), numrit të popullsisë në vite, strukturave të popullsisë, evolucionit të vendbanimeve etj. Një raport mjaft i shprehur dhe ndikues ka qenë edhe ai që lidhet me rolin dhe kontributin e lëvizjeve migruese që kanë bashkëshoqëruar zhvillimin e zonave rurale në vendin tonë. Ndonëse të tipeve dhe llojeve të ndryshme, këto lëvizje migruese, kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në mjaft prej zhvillimeve sociale, ekonomike dhe administrative të zonave rurale. Në mjaft raste ato kanë identifikuar edhe tipologjitë zhvillimore të tyre për dekada të tëra. Mjaft interesant shfaqet roli i tyre, në mënyrë të veçantë pas viteve 1990, ku lëvizjet migruese afektuan dhe “tronditën” tërësisht edhe ekzistencën e vetë zonave rurale.

Në materialin shkencor që po paraqesim kemi orientuar këndvështrimin e hulumtimit tonë shkencor në një analizë të përgjithshme

të raporteve ndërmjet rolit të lëvizjeve migruese në kuadër të ndikimit që ato kanë luajtur në evolucionin e zonave rurale, sidomos gjatë periudhës së tranzicionit në vendin tonë. Jemi ndaluar në analizën e faktorëve ndikues që luajtën rol në lindjen dhe zhvillimin e migrimit të zonave rurale, tipet dhe llojet më të përhapura të lëvizjeve migruese, origjinën dhe destinacionin e tyre në kuadrin e shpërndarjes gjeografike, efektet bashkëshoqëruese të tyre në zonat rurale të vendit tonë. Në material kemi paraqitur edhe disa tabela dhe të dhëna statistikore, të cilat konkretizojnë mjaft prej çështjeve që kemi hulumtuar. Në përfundim të materialit tentojmë të evidentojmë disa konkluzione në lidhje me tendencën për të ardhmen e zhvillimit të këtyre zonave rurale.

### **Lëvizjet migruese dhe zonat rurale në vendin tonë. Faktorët ndikues dhe roli i tyre**

Tërësia e faktorëve që kanë bashkëshoqëruar zhvillimin e zonave rurale në vendin tonë, ka pasur një ndikim të rëndësishëm në çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimet e popullsisë së këtyre hapësirave sociogjeografike. Në këtë drejtim, në mënyrë të veçantë, duhet evidentuar roli dhe kontributi i shtesës natyrore të popullsisë së vendosur në këto zona rurale, si dhe lëvizjet migruese, kryesisht të brendshme dhe të jashtme. Bashkëpunimi ndërmjet tyre ka bërë të mundur edhe shfaqjen e dinamikave mjaft interesante gjatë zhvillimeve në periudha të ndryshme kohore, të hapësirave sociogjeografike të zonave rurale në Shqipëri. Raportet zhvillimore ndërmjet dy elementeve (shtesës natyrore dhe lëvizjeve migruese) në mjaft raste janë shoqëruar me efekte qartazi të drejtpërdrejta dhe tepër ndikuese në vetë fizionominë e zonave rurale në vendin tonë. Në varësi të tyre kemi pasur rritje apo pakësim të numrit të popullsisë, depopullim, rritje apo “stanjacion” të vendbanimeve, zhvillim ekonomik intensiv apo degradim të strukture ekonomike bujqësore apo blegtorale, fuqizim apo rënie të infrastrukturës së shërbimeve të ndryshme sociale, praninë e problemeve sociale të spikatura, lindjen dhe zhvillimin e konflikteve të larmishme sociale, kryesisht me funksionin social të pushtetit etj.

Konsultimi me statistikat e shumta që lidhen me shtesën natyrore të popullsisë në vite për Shqipërinë, kanë evidentuar një shtesë natyrore të lartë në zonat rurale, në raport me ato urbane, deri në dekadën e parë të tranzicionit. Nga ana tjetër, një intensitet të lartë ndikues, kanë pasur lëvizjet migruese të popullsisë të orientuara drejt vendosjes së tyre në mjaft prej zonave rurale të vendit, ku në mjaft prej tyre, para viteve '90

orientoheshin grupe sociale të veçanta të popullsisë dhe kategori sociale specifike, për t'u vendosur dhe populluar zonat rurale, në njësi administrative të ndryshme nga jugu në veri dhe nga lindja në perëndim, sipas një planifikimi të centralizuar dhe të organizuar. Një pjesë e grupeve sociale të rinjve nga zonat e ndryshme urbane të Shqipërisë, profesione të mësuesisë, mjekësisë, agronomisë, veterinarisë, pylltarisë, minierave etj., u orientuan dhe u vendosën në mjaft prej zonave rurale të Shqipërisë. Mund të përmendim në këtë drejtim Valiasin, Krrabën në Tiranë, Martaneshin në Bulqizë, Kelmendin në Malësinë e Madhe, Lukovën, Ksamilin në Sarandë, Gjeganin në Pukë, Shishtavecën në Kukës etj.

Vlerësojmë se analiza në funksion të rolit dhe kontributit të faktorëve ndikues në lindjen dhe zhvillimin e lëvizjeve migruese në zonat rurale duhet ndarë në kuadrin e zhvillimeve kryesore që ka kaluar vendi ynë, nga të cilat janë ndikuar dhe prekur edhe zonat rurale. Në mënyrë të veçantë tiparet zhvillimore të përgjithshme të tyre shprehin një ndarje qartazi të evidentuar me ndryshimet e ndodhura në vendin tonë në vitet 1990. Prandaj, edhe analiza jonë i referohet këtij kufiri kohor duke tentuar të japë në mënyrë të përgjithshme edhe kontributet reale të faktorëve ndikues. Vlerësojmë se deri në vitin 1990 faktorët kryesorë migrativë të orientimit të vendosjes së popullsisë në zonat rurale të vendit, për Shqipërinë në tërësi, kanë qenë të planifikuara, të përcaktuara, të organizuara, të drejtuara dhe josporadike. Rolin kryesor e ka pasur funksioni social i pushtetit, i cili nëpërmjet orientimeve të ndryshme dhe direktivave politike realizonte zhvendosjet e grupeve të ndryshme sociale të popullsisë, drejt zonave rurale. Një lëvizje e tillë e kontrolluar e popullsisë ishte prezente në tërësinë e zonave rurale të organizimit administrativ të Shqipërisë së para 1990-s.

Jemi të mendimit se në kuadrin e faktorëve ndikues mbeten themelore ata ekonomikë, socialë dhe politikë. Ndonëse duhet të përmendim se në raport me secilin prej këtyre faktorëve vërejmë një dinamizim mjaft të shprehur në periudha të ndryshme kohore. Një gjë e tillë është e ndikuar nga një sërë zhvillimesh të popullsisë dhe të vetë shoqërisë shqiptare para 1990-s dhe gjatë periudhës së tranzicionit. Në varësi të këtyre zhvillimeve ka ndryshuar edhe vetë thelbi, përmbajtja dhe roli i këtyre faktorëve migrativë. Para 1990-s këta faktorë mbeten determinantë në faktin e rolit që ata patën dhe luajtën në drejtim të nevojës dhe domosdoshmërisë së zonave rurale për të pasur në "gjirin" e tyre, grupe dhe kategori sociale që afektonin drejtpërdrejt zhvillimin ekonomik dhe social të tyre. Pas 1990-s, gjatë periudhës së tranzicionit mungon një qasje e tillë, për shkak të zhvillimeve demokratike që ndodhën në vendin tonë, pushimit të

funksionimit të një lëvizjeje të organizuar dhe të një politike të centralizuar në zhvillimet e popullsisë, duke bërë të mundur lindjen dhe zhvillimin e lëvizjes së lirë të popullsisë, njerëzve, individëve dhe grupeve sociale, pjesë e zonave rurale, të cilat sollën edhe dinamizimin mjaft aktiv të vetë rolit, përmbajtjes dhe tipareve të lëvizjeve migruese të tyre. Studiuesit Gedeshi & Jorgoni në analizën e tyre në kuadrin e një studimi të Komisionit Evropian vlerësonin se *“Kolapsi i sistemit socialist, hapja e menjëhershme e vendit dhe transformimi radikal e kaotik i ekonomisë u shoqëruan me migrim masiv të popullsisë në kërkim të një të ardhmeje më të mirë, qoftë diku tjetër brenda Shqipërisë apo jashtë saj. Me të vërtetë, migrimi i brendshëm u zhvillua gjithashtu me të njëtin intensitet, kryesisht nga zonat malore dhe verilindore të vendit drejt zonave bregdetare dhe qendrave kryesore urbane.”*

Roli dhe kontributi i faktorit ekonomik i lëvizjes migratore drejt zonave rurale para 1990-s, konsistonte më tepër në drejtim të nevojës dhe domosdoshmërisë që këto hapësira sociogeografike kishin në sektorë të ndryshëm të zhvillimit rural. Më tepër, vëmendja, ishte e përqendruar në dy drejtime kryesore; duhet të përmendim fuqinë punëtore (krahun e punës) në bujqësi dhe blegtori, e më të kufizuar në pylltari, e fragmentuar dhe e përqendruar në zona të veçanta ku kishim praninë e resurseve natyrore pyjore, ashtu siç dhe në kuadrin e nevojës për kuadrin e kualifikuar në këta sektorë përkatës. Në këtë kuadër ky faktor ekonomik merrej në konsideratë nga funksioni social i pushtetit, i cili në mënyrë të planifikuar dhe të organizuar me anë të iniciativave apo udhëzimeve të veçanta orientonte dërgimin e grupeve të ndryshme sociale të popullsisë të vendoseshin në zonat e ndryshme rurale të Shqipërisë së para 1990-s. Nën efektin e këtij faktori ekonomik kemi prezencë të lëvizjes së popullsisë nga njësi të ndryshme administrative të vendit drejt zonave rurale të veçanta. Megjithatë vlerësojmë se në mjaft raste roli dhe kontributi i faktorit ekonomik shfaqet në bashkëpunim dhe ndërlidhje të ngushtë me faktorin social.

Ajo çfarë duhet vlerësuar në rolin e faktorëve të këtyre lëvizjeve migruese është elementi social apo nënvizimi i faktorit social, i cili lidhet me diversitetin e vetë përmbajtjes së lëvizjeve migruese që orientoheshin drejt zonave rurale. Këtu duhen vlerësuar motivet në drejtim të fushës së veprimtarive profesionale, për të cilat kishin nevojë zonat rurale. Në këtë diversitet duhet të përfshihen fushat kryesore ekonomike rurale të tilla, si: bujqësia, blegtorja, pylltaria etj. Por krahas tyre kemi edhe fushën e shërbimeve sociale të tilla, si: arsimit, shëndetësia, kultura, sporti etj. Një diversitet i tillë i faktorit social luajti rol të rëndësishëm edhe në drejtim të

grupeve sociale dhe kategorive sociale të popullsisë që migronin apo zhvendoseshin drejt zonave rurale të ndryshme të Shqipërisë. Vlen të përmendim faktin e migrimit, jo vetëm të grupeve sociale të të rinjve, të cilët aktivizoheshin për punët në bujqësi, blegtori apo pylltari. Krahas tyre kishim praninë edhe të mjaft kategorive sociale të profesioneve të tilla, si: agronomia, veterinaria, inxhinierët pyjorë etj., të cilët patën një rol dhe kontribut të rëndësishëm në vetë zhvillimin e zonave rurale. Nga ana tjetër, diversiteti i ndikimit të faktorit socialmigrator në këto zona rurale, në të cilat kërkohej nevoja dhe domosdoshmëria e shërbimeve arsimore, shëndetësore, infrastrukture sociale, kulturore e sportive, patën ndikim në lindjen dhe zhvillimin e lëvizjeve migruese të kategorive sociale specifike, si: mësuesit, mjekët, sportistët, punonjësit e artit dhe të kulturës etj.

Nën ndikimin e faktorëve kryesorë, siç janë ata ekonomikë dhe socialë, mund të shprehemi se patëm një prezencë të shpërndarjes në forma dhe dimensione të ndryshme të popullsisë në zona të ndryshme rurale të vendit. Ndonëse kemi një ruajtje të ekuilibrave normalë të migrimit të njësitë e ndryshme rurale në kuadrin e strukturave profesionale, ndaj të cilave shprehej nevoja dhe domosdoshmëria e tyre, sidomos agronomia, veterinaria, arsimi, shëndetësia, arti dhe kultura. Në disa zona të tjera rurale kemi një vendosje apo migrim më intensiv të popullsisë. Në mënyrë të veçantë në fuqizimin e mjaft zonave të reja rurale dhe atyre me fizionomi më të zhvilluar dhe me rol të rëndësishëm në zhvillimin bujqësor e blegtoral të vendit. Lindja dhe zhvillimi i zonave të reja rurale të tilla, si: Ksamili, Lukova në Sarandë, me potenciale të rëndësishme bujqësore, sa i përket agrumeve, Valiasit e Krrabës në Tiranë, lidhur ngusht me prezencën e minierave pranë tyre, Kelmendit në Malësinë e Madhe dhe Valbonës në Tropojë, lidhur ngusht me pylltarinë etj., vërejmë se ka një lëvizje migruese më të madhe të numrit të popullsisë. Madje në disa prej tyre u stimulua edhe ndërtimi i vendbanimeve për të ndikuar në popullimin e tyre. Rast konkret paraqiten sidomos zonat rurale të sipërpërmendura, siç ishin Ksamili dhe Lukova.

Krejt e ndryshme paraqitet roli dhe kontributi i faktorëve ekonomikë, socialë dhe politikë, pas ndryshimeve demokratike të ndodhura në vendin tonë pas 1990-s. Lindja dhe zhvillimi i lëvizjes së lirë të njerëzve dhe individëve të ndryshëm ndikoi dukshëm edhe në migrimin e popullsisë rurale. Popullsia banuese e zonave rurale, ashtu si pjesa tjetër e popullsisë shqiptare, u ndje e lirë për të lëvizur pa barriera, duke u orientuar për t'u vendosur kryesisht drejt zonave urbane të Shqipërisë. Mjaft i spikatur, krahas migrimit të brendshëm, njëkohësisht, shfaqet edhe migrimi i jashtëm. Grupet sociale të popullsisë banuese rurale zinin një peshë

specifike të rëndësishme. Sidmos një gjë e tillë u pa shumë prezente drejt destinacioneve të tilla ndërkombëtare, siç ishin: Greqia, Italia dhe Franca dhe Gjermania.

Është e domosdoshme të nënvizojmë faktin se tërësia e faktorëve migrues të sipërpërmendur u diversifikua qartazi në përmbajtjen e tyre. Tashmë faktorët ekonomikë, socialë dhe politikë evidentoheshin në kuadrin e një botëkuptimi dhe filozofie të re, krejtësisht të ndryshme nga ajo e para viteve 1990. Mungesa e vendeve të punës me të ardhura produktive individuale dhe familjare, mungesa e një jetese që siguronte mirëqenien e tyre, ndikuar edhe nga reformat e ndryshme nën okelion “socialiste”, të cilat nuk sollën rezultate premtuese për ekonomitë familjare të zonave rurale, kufizmet e jetës sociale dhe lirive politike dhe ekonomike, nxitën një lëvizje të tillë intensive migratore në të dy drejtimet e sipërpërmendura, specifikisht zonat urbane të Shqipërisë në kuadrin e migrimit të brendshëm dhe destinacionet kryesisht evropiane në kuadrin e migrimit të jashtëm

### **Dinamika e faktorëve të lëvizjeve migruese në kuadrin e evolucionit të zonave rurale**

Lëvizjet migruese në zonat rurale janë shoqëruar me një dinamikë mjaft të shprehur dhe me ndikim në vetë zhvillimin e zonave rurale në Shqipëri. Jemi të mendimit se një dinamikë e tillë duhet parë në lidhje të ngushtë me vetë evolucionin që pësuan motivet apo faktorët migrativë të popullsisë rurale në vendin tonë, me periudhën kohore të shfaqjes dhe ndodhjes së tyre, me tipologjitë dhe llojet e evidentuara të këtyre lëvizjeve migruese, si dhe me efektet bashkëshoqëruese në tërësinë e hapësirave sociogeografike rurale. Vetëm nën këtë metodologji analizimi do të jemi në sinkron të dhënies në mënyrë të qartë të tipareve që bashkëshoqëruan dinamikën e lëvizjeve migruese apo zhvendosjeve të popullsisë rurale të vendit tonë. Nga një vështrim i përgjithshëm i kësaj dinamike të faktorëve të lëvizjeve migruese që u shfaqën në hapësirat sociogeografike rurale të Shqipërisë, gjatë periudhave kohore të ndryshme, mund të evidentojmë disa tipare apo karakteristika të veçanta.

**Së pari**, dinamika paraqitet mjaft e shprehur në vetë motivet e lëvizjeve migruese. Këto motive apo faktorë të migrimit pësuan një evolucion të konsiderueshëm thelbësor në vetë përmbajtjen e tyre. Para viteve ‘90 ato ishin nën ndikimin dhe peshën e rolit të rëndësishëm që duhet të luanin për ecurinë dhe zhvillimin e këtyre zonave rurale, duke i parë ato, si mundësi të ushtrimit të aktivitetit të tyre funksional jetësor dhe profesional. Në efektin dhe ndikimin e një politike të centralizuar dhe të

planifikuar në patëm zhvendosje të popullsisë që ishte orientuar për t'u zhvendosur drejt zonave rurale. Ato ishin të "detyruar" të migronin drejt zonave rurale, në të cilat ishin të pranishme mundësitë për punësim e jetesë, si dhe njëkohësisht të jepnin ndihmesën e tyre për zhvillimin ekonomik të vendit në këtë sektor të ekonomisë, siç ishte bujqësia. Në të njëjtën kohë, lëvizjet migruese të vetë popullsisë banuese të zonave rurale, të cilat zhvendoseshin kryesisht drejt zonave urbane apo njësisive të tjera administrative rurale, ishin mjaft të kufizuara dhe vetëm të centralizuara, gjithnjë nën efektin e ndikimit të faktorëve të kombinuar ekonomikë dhe socialë. Motivet kryesore shfaqeshin vetëm për efekte punësimi, shkollimi apo elemente të tjera sociale, siç ishin lidhjet martesore.

Ndërsa pas 1990-s kemi një ndryshim të dukshëm të rolit dhe ndikimit të këtyre motiveve apo faktorëve migrativë. Vendosja e një sistemi demokratik me liri ekonomike dhe lëvizjeje, kalimi në ekonominë e tregut, liberalizimi i tij, këndvështrimi objektiv dhe real i situatës së zhvillimeve rurale në vendin tonë dhe në hapësirën sociogjeografike rurale banuese të tyre, bëri të mundur edhe një analizë të gjendjes sociale dhe ekonomike të tyre, duke i ndërgjegjësuar se ishin vetë aktorët ata që duhet të vendosnin për fatin, jetën, profesionin, ekonominë, vendbanimin dhe punësimin e tyre. Tashmë është e njohur situata ekonomike dhe zhvillimi i sektorit të bujqësisë, deri në fillimin e viteve 1990, ndikuar edhe nga reformat e ndryshme të ndërmarra gjatë viteve 1945-1990, të cilat patën një ndikim të kufizuar në drejtim të mirëqenies dhe efekteve pozitive në ekonominë e familjeve banuese në hapësirat sociogjeografike rurale. Një gjë e tillë bëri të mundur që flukset migrative rurale të vinin gjithnjë e në rritje pas 1990-s, duke u orientuar të vendoseshin në destinacione të tjera sinkron mundësive për një jetesë dhe ekonomi më të mirë, më cilësore, më produktive dhe dobiprurëse për individët dhe familjet, pjesë përbërëse të hapësirave sociogjeografike rurale.

**Së dyti**, është interesante nga pikëpamja studimore periudha kohore e evidentimit të këtyre lëvizjeve migruese në hapësirat sociogjeografike rurale të vendit tonë. Kufiri ndarës i viteve 1990 paraqitet më i rëndësishmi për ndryshimet e transformimet e dimensioneve të mëdha që pësuan zonat rurale në tërësinë e zhvillimeve të tyre, në aspektet e zhvillimeve të popullsisë, veçanërisht ndikuar nga lëvizjet migruese. Por dinamika e lëvizjeve migruese, përfshirja dhe ecuria e popullsisë në to, pra në drejtim të hapësirave sociogjeografike rurale të Shqipërisë, ndjek një evolucion divers gjatë periudhave të ndryshme kohore të vetë zhvillimit të njësisive administrative rurale, të popullimit dhe të jetës që zhvillohej në to. Në këtë drejtim, ndikim të konsiderueshëm patën edhe faktorët historikë dhe

politikë, në rolin dhe kontributin që ato luajtën, sidomos në drejtim të zhvillimeve historike, politike, administrative, të popullsisë dhe të vetë evolucionit të vendbanimeve të zonave rurale në Shqipërinë e periudhave të ndryshme. Ajo çfarë duhet përmendur dhe nënvizuar lidhet me zhvillimet intensive, që mjaft prej këtyre zonave rurale patën në tërësinë e periudhës kohore që varion nga 1945-1990.

Riorganizimet e ndryshme territoriale - administrative, të dhënat e marra nga regjistrimet e popullsisë dhe të banesave gjatë kësaj periudhe dhe vjetarët e shumë statistikorë, përforcojnë mendimin se krahas shtesës natyrore të popullsisë, ndikim të rëndësishëm në këto zona rurale kanë luajtur edhe zhvendosjet e popullsisë apo lëvizjet migruese. Pavarësisht flukseve të tyre të pabarabarta në zona të ndryshme rurale ndikuar nga numri i popullsisë banuese në to, karakteri dhe fizionomia ekonomiko-strukturale - rurale e tyre, iniciativave dhe orientimeve politike të funksionit social të pushtetit në periudha të ndryshme, nevojave të evidentura etj., duket qartazi, se prekja nga lëvizjet migruese nën motivimin ekonomik, social, politik dhe historik, është prezente në to. Një gjë e tillë e bën mjaft interesante analizën e detajuar në drejtim të kësaj dinamike migratore.

**Së treti**, dinamika e zhvillimit të lëvizjeve migruese në zonat rurale të Shqipërisë, është e lidhur ngusht edhe me rolin dhe kontributin e faktorëve gjeografikë, ekonomikë, socialë dhe politikë në drejtim të shfaqjes së tipeve dhe llojeve të ndryshme të migrimit. Tipologjitë kryesore klasifikuese të migrimit i ndeshim në tërësinë e lëvizjeve migruese që prekën hapësirat socio-gjeografike rurale të Shqipërisë, gjatë periudhave të ndryshme kohore. Prandaj dinamika e tyre paraqitet interesante, sepse nën ndikimin e faktorëve apo motiveve të migrimit, janë evidentuar si migrimet e brendshme, ashtu edhe ato të jashtme, si migrimet individuale, ashtu edhe ato familjare, si migrimet e përhershme, edhe ato të përkohshme, si migrimet spontane, ashtu edhe ato të organizuara. Dinamika paraqitet e spikatur për faktin se edhe ndikimi i tërësisë së faktorëve motivues ka qenë tepër divers gjatë evolucionit migrativ të vetë këtyre zonave rurale.

Nën dinamikën e këtyre faktorëve kemi prezencën e lëvizjeve migruese, sidomos të brendshme, individuale, të organizuara, në shfaqjen e migrameve të përkohshme dhe të përhershme deri në vitin 1990. Ndikuar nga politikat zyrtare të kohës, migrimi i jashtëm, shfaqej sporadik dhe në raste tejet të kufizuara në individë dhe grupe sociale të veçanta, të klasifikuara për kohën në “armiç” të pushtetit. Ndërsa nën efektin e faktorëve të mësipërm të motiveve të migrimit, pas viteve ‘90 shfaqet krahas tipeve të tjera të migrimit edhe ai i jashtëm ndikuar nga ndryshimet demokratike që u shfaqën e Shqipërinë e pas 1990-s. Madje duhet të



theksojmë se migrimi i jashtëm në mënyrë graduale po paraqitet gjithnjë e me dominant në drejtim të zhvendosjeve të popullsisë nga zonat rurale. Në mënyrë të veçantë bashkëshoqërimi i tij, jo vetëm me migrimin individual, por sidomos me atë familjar, gjë që ka rritur në mënyrë të dukshme fluksin migrativ rural të hapësirave të ndryshme sociogeografike rurale të Shqipërisë, gjatë periudhës së tranzicionit. Destinacionet kryesore të orientimit të tyre janë për t'u vendosur drejt shteteve të tilla, si: Greqia, Italia, Franca, Gjermania, Britania e Madhe etj. Jemi të mendimit se nën ndikimin e faktorëve tepër dinamikë të migrimit, mjaft i shprehur është paraqitur edhe migrimi i brendshëm i popullsisë rurale të vendit tonë, i cili është orientuar për t'u vendosur kryesisht drejt zonave urbane të tilla, si: Tirana, Durrësi, Shkodra, Fieri, Elbasani etj.

**Së katërti**, mjaft evident për të pasqyruar dinamikën e lëvizjeve migruese në zonat rurale, paraqitet edhe këndvështrimi i efekteve që bashkëshoqëruan këto migrime. Faktorët dhe motivet e këtyre lëvizjeve migruese nxitën zhvillime të ndryshme sociale, ekonomike në hapësirat sociogeografike rurale të origjinës së tyre. Në mënyrë të spikatur ato evidentohen në dinamizimin e elementëve përbërës të popullsisë rurale, në drejtim të vendbanimeve prezente në këto zona rurale të Shqipërisë, në dimensionet e zhvillimeve të sektorëve ekonomikë të zonës rurale respektive, në të cilat ndodhën këto lëvizje migruese, në vetë hapësirën sociogeografike etj. Në një vështrim të përgjithshëm mund të evidentojmë faktin e rritjes së popullsisë banuese rurale e ndikuar sidomos nga shtesa natyrore e lartë dhe me ndikim më të kufizuar të migrimit të popullsisë, deri në vitin 1990. Ndërsa pas 1990-s evidentojmë efekte të rëndësishme të dinamikës së popullsisë, që shprehen më së tepërmi në drejtim të rënies në vazhdimësi të numrit të përgjithshëm të popullsisë banuese rurale në vendin tonë, në raport jo vetëm me vetë numrin e përgjithshëm të popullsisë banuese para viteve 1990, por edhe në totalin e përgjithshëm të raportit urban/rural të Shqipërisë së pas 1990-s. Njëkohësisht mjaft të shprehura duken rëniet qartazi në lindshmëri dhe shtesë natyrore të njësive administrative rurale, pothuajse në të gjitha hapësirat sociogeografike rurale të Shqipërisë, shfaqjen e problematikave serioze të deformimeve të strukturave gjinore dhe moshore të popullsisë, rritje të moshës mesatare dhe plakje të popullsisë rurale, depopullim të mjaft njësive administrative rurale dhe ndër to edhe shfaqjet e braktisjes totale të tyre. Tipologji të tilla i ndeshim të shprehura qartë në mjaft njësi administrative të bashkive kryesore të Shqipërisë, por ndër më evidentet shfaqen në ato të Dibrës, Kukësit, Hasit, Tropojës, Korcës, Ersekës, Devollit, Gjirokastrës, Elbasanit etj. Një grup gazetarësh shqiptarë, të cilët analizuan situatën migrative në

mjaft prej njësive administrative, pjesë të bashkive kryesore në vendin tonë, vlerësojnë ndër të tjera se “*Emigrimi jashtë Shqipërisë, por edhe migrimi i brendshëm kanë zbrazur fshatra të tërë në mbarë vendin. 160 mijë shqiptarë janë larguar nga viti 2019 deri në 2022, pjesa dërrmuese e të cilëve kanë ikur për t’u punësuar. Në fshatin Tren në Devoll nga 300 familje sot janë prezente vetëm 70 prej tyre, në fshatin Martine në Fier nga rreth 150 familje, sot rreth 70 % e tyre janë larguar, fshati Kolesjan në Kukës nga rreth 800 banorë, sot janë afro 200 banorë, fshati Pusi i Thatë në Kukës nga rreth 45 familje, sot tërësisht i braktisur...*”

Nën efektin e këtyre lëvizjeve migruese kemi prezencën edhe të dinamizimit të hapësirës sociogjeografike. Ndërsa në njësi të veçanta kemi prezencën e lindjes dhe zhvillimit të vendbanimeve të reja, shprehje e drejtpërdrejtë e ndikimit të remitancave të ardhura nga popullsia rurale migratore, në njësi të tjera kemi braktisje të vendbanimeve. Mjaft diverse paraqitet situata e zhvillimit ekonomik të këtyre zonave rurale. Nën efektin e lëvizjeve migruese, depopullimit e braktisjes së këtyre zonave rurale, në mënyrë graduale, diku e mjaft intensive, diku tjetër ka një zbehje të sektorëve të bujqësisë dhe blegtorisë, duke ndikuar në mënyrë të dukshme në vetë fizionominë e këtyre njësive administrative rurale. Gjithnjë e më tepër po vihet re tendenca e mosshfrytëzimit të tokës bujqësore, limiteve rënëse të produkteve blegtorale etj., të cilat janë shoqëruar edhe me lindjen dhe zhvillimin e mjaft problemeve sociale të vetë popullsisë banuese rurale. Nga ana tjetër, edhe mungesa e vëmendjes së funksionit social të pushtetit lokal dhe atij qendror në drejtim të disa prej hapësirave sociogjeografike rurale të vendit, në mënyrë të veçantë, në aspektet e shërbimeve sociale dhe infrastrukture, kanë nxitur në mënyrë aktive vetë prezencën e mjaft çështjeve problematike funksionale jetësore të këtyre zonave rurale.

## KONKLUSIONE

Duke analizuar me vëmendje tërësinë e një evolucioni të tillë të lëvizjeve migruese në zonat rurale të vendit tonë, kemi tentuar të japim edhe disa konkluzione. Paraqitja e këtyre konkluzioneve shfaqet si një reflektim evident i ndryshimeve të prezantuara në mjaft prej komponentëve kryesorë gjeografikë të zonave rurale në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë spikasin evidentimi i këtyre konkluzioneve në çështjet dhe tematikat, të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e popullsisë dhe të vendbanimeve të këtyre zonave rurale, në Shqipëri.

**Së pari**, kemi mendimin se gjatë tërësisë së zhvillimit të hapësirave sociogjeografike rurale të vendit tonë, lëvizjet migruese kanë qenë

prezente. Madje roli dhe kontributi i tyre paraqitet mjaft divers dhe tepër i rëndësishëm në periudha kohore të ndryshme. Lidhur ngusht me këto periudha edhe tipologjia e tyre është shfaqur në forma dhe dimensione mjaft të larmishme. Një rol të spikatur kanë luajtur faktorët dhe motivet e migrimit, ku veçanërisht evidentohen ato ekonomike, sociale dhe politike. Nën ndikimin e këtyre faktorëve kemi praninë e zhvendosjeve nga më të larmishmet në hapësirat e ndryshme sociogjeografike rurale të Shqipërisë.

**Së dyti**, konstatojmë në mënyrë mjaft të qartë se një kufi i rëndësishëm kohor, siç është ai i vitit 1990, me ndryshimet demokratike të pranishme në Shqipëri, ka gjeneruar qartazi një ndryshim dhe transformim të dimensioneve të mëdha në tërësinë e zhvillimit të popullsisë dhe vendbanimeve të zonave rurale. Një gjë e tillë ka bërë të mundur edhe ndikimin e konsiderueshëm në formë dhe përmbajtje, në impakte dhe efekte, të vetë lëvizjeve migruese të këtyre zonave rurale, të motiveve dhe faktorëve mjaft të larmishëm të evidentuar.

**Së treti**, motivet apo faktorët migrues ndikues në evolucionin e zonave rurale shfaqen mjaft dinamikë gjatë periudhave të ndryshme kohore. Vlerësojmë shfaqjen e tyre nën konturet klasifikuese tradicionale të migrimit të brendshëm dhe atij të jashtëm, të migrimit të përhershëm dhe atij të përkohshëm, të migrimit spontan dhe atij të organizuar, të migrimit individual dhe atij familjar. Shprehemi, se në mjaft raste, vlerësojmë një kombinim dhe dinamikë të ndërthurur të mjaft prej këtyre tipeve të migrimit në tërësinë e zonave rurale të vendit tonë. Nën ndikimin e tyre popullsia e këtyre zonave rurale është shoqëruar me ndryshime tepër të shprehura dhe mjaft sinjifikative të evidentuara sidomos në drejtim të numrit të saj të popullsisë, tek strukturat e saj përbërëse moshore, gjinore, profesionale, sociale, në raportet e shteses natyrore, vendbanimet etj.

## BIBLIOGRAFI

- Axhemi, Sokol (2020): *Qasja urgjente drejt ndërmarrjes së politikave kombëtare migratore. Ide dhe argumente*, Buletini shkencor, seria e shkencave shoqërore, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
- Axhemi, Sokol (2022): *Lëvizjet migruese në zonat urbane të vendit tonë. Dinamika e faktorëve ndikues*, Buletini shkencor, seria e shkencave shoqërore, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
- Beqiri, B. & Braho & Thano, K., *Fshatrat “fantazmë” të Shqipërisë, emigrimi dhe papunësia lënë vërtetë të moshuarit*. Shqiptarja.com.Tiranë 25 shkurt 2024.
- Duri, V. & Ruspi, G. (2019): *Emigrimi i jashtëm i popullsisë në territorin e Qarkut Gjirokastrë*, Studime gjeografike, Nr.22, Tiranë.
- Dragot, E. & Hoxha, D. (2008): *Identifikimi i zonave më të prekura nga emigracioni dhe migracioni i kthimit në Shqipëri. Profili i migrantëve të kthyer*. IOM.Studim,

projekt,Tiranë.

- Gedeshi, Ilir & Jorgoni, Elira (2012): *Ndikimi social i emigracionit dhe migrimit rural-urban në Evropën Qendrore dhe Lindore*, Komisioni Evropian, Përmbledhje ekzekutive për Shqipërinë,Tiranë.
- Krymbi, Ervis (2019): *Migrimi i brendshëm dhe transformimet në territorin e bashkisë Shkodër*, Studime Gjeografike, Nr.2,Tiranë.
- Nikolli, P. & Draçi, B., (2019): *Ndikimi i emigracionit në plakjen e popullsisë së Shqipërisë pas viteve 1990*, Studime gjeografike, Nr.22, Tiranë.
- Sinani, A. & Dhromaj, A. (2019): *Migrimet në hapësirën rurale të bashkisë Gjirokastër*, Studime Gjeografike, Nr.21,Tiranë.

### **Migratory movements and the dynamics of development of rural areas in Albania**

#### ***ABSTRACT***

Among the influencing factors of developments that have affected rural areas in their evolution, population developments have had a very significant and effective impact. In this direction, we must evaluate the reports that have associated the progress of these rural areas in relation to the natural additions of the population (dedicated to the changes shown between the dimensions of birth and mortality), the number of the population in years, population structures, the evolution of settlements, etc. . A very expressed and influential report has also been related to the role and contribution of migratory movements that have associated the development of these rural areas in our country. These migratory movements, although of different types and types, have had a direct impact on many from the social, economic and administrative developments of these rural areas. In many cases, they have also identified their developmental typologies for decades. Quite interestingly, their role stands out, especially after the 1990s, which completely affected and "shocked" the very existence of these rural areas.

In the scientific material that we are presenting, we have focused our scientific research on a general analysis of the relationships between the role of these migratory movements in the framework of the influence they have played in the evolution of rural areas, especially during the transition period in our country. We have stopped in the analysis of the influencing factors that play a role in the birth and development of migration in these rural areas, the most widespread types and types of these migratory movements, their origin and destination in the context of geographical distribution, their accompanying effects in rural areas in our country. In the material, we have also presented some tables and statistical data, which concretize many of the issues we have researched. At the end of the material, we try to highlight some conclusions regarding the future trend of the development of these rural areas.

**JETA SHKENCORE****KONFERENCA SHKENCORE NDËRUNIVERSITARE*****"Arbëreshi Shkodran Leonardo de Martino"*****(në 100-vjetorin e ndarjes nga jeta)**

Më 15 dhjetor 2023, u zhvillua konferenca shkencore ndëruniversitare me temë "*Arbëreshi shkodran Leonardo de Martino*", në kuadër të 100-vjetorit të ndarjes nga jeta të këtij personaliteti të rëndësishëm të kulturës dhe historisë shqiptare. Aktiviteti u organizua në bashkëpunim midis Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Provincës Françeskane Shqiptare dhe Njësisë për arbëreshët, arvanitët dhe arbeshët. Punimet e konferencës u mbajtën në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", në auditorin 1.

Ky aktivitet shkencor mbledhi një gamë të gjerë studiuesish dhe akademikësh, të cilët trajtuan në detaje jetën dhe veprimtarinë e Leonardo de Martino, një figurë e shquar e Arbëreshëve të Italisë, i cili jo vetëm që ka dhënë kontribute të rëndësishme për kulturën dhe gjuhën arbëreshe, por gjithashtu ka lënë gjurmë të pashlyeshme në lëvizjet patriotike shqiptare dhe në krijimtarinë letrare të shekullit XIX.

Temat kryesore të konferencës përfshinë:

- Jeta dhe veprimtaria e Leonardo de Martinos: Kumtuesit analizuan jetën e tij si një intelektual dhe klerik që kontribuoi në zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare. Studimet historike u përqendruan në lidhjet e tij me lëvizjet për pavarësinë e Shqipërisë dhe kontributet e tij për zhvillimin e identitetit kombëtar shqiptar.
- Veprat letrare dhe poetike: Leonardo de Martino u njoh si një poet dhe shkrimtar i shquar. Prezantimet theksuan rëndësinë e veprave të tij në ruajtjen dhe në zhvillimin e gjuhës dhe të letërsisë arbëreshe. Poezitë e tij, si dhe përkthimet e tij të rëndësishme, u trajtuan në kontekstin e letërsisë shqiptare dhe ndikimit të tij në letrat shqipe.
- Kontributet e tij për arbëreshët e Italisë dhe për shqiptarët. Në konferencë u analizua thellësisht kontributi i De Martinos për përforcimin e ndërgjegjes kombëtare të arbëreshët, si dhe ndikimi i tij

në gjeneratat pasuese për ruajtjen e identitetit kulturor dhe gjuhësor të arbëreshëve.

- Lidhjet e tij me lëvizjet për pavarësinë e Shqipërisë. Një pjesë e rëndësishme e kumtesave u përqendrua në rolin e Leonardo de Martinos në mbështetjen e lëvizjeve patriotike shqiptare, dhe angazhimin e tij në çështjen kombëtare, duke kontribuar përmes shkrimeve dhe aktivitetit të tij si një mbrojtës i çështjes shqiptare.

Konferenca shërbeu si një hapësirë e rëndësishme për të diskutuar dhe për të thelluar njohuritë mbi këtë figurë të rëndësishme historike, duke nxjerrë në pah trashëgiminë e pasur intelektuale dhe kulturore që Leonardo de Martino la pas. Gjithashtu, aktiviteti u vlerësua për mundësinë që ofroi për të bashkuar studiuesit nga fusha të ndryshme në një dialog shkencor produktiv mbi rolin e arbëreshëve në historinë dhe në kulturën kombëtare shqiptare.

### **KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE** **“Qyteti i shtypit të pavarësisë (1913-1920)”**

Më 3 maj 2024, pranë Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, u mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare me temën “Qyteti i shtypit të pavarësisë (1913-1920)”, një aktivitet që mbledhi studiues të shquar nga fusha të ndryshme akademike, brenda dhe jashtë vendit, për të trajtuar një periudhë të rëndësishme në historinë e medias dhe të shtypit shqiptar.

Në qendër të konferencës ishte analiza e shtypit shqiptar gjatë periudhës pas shpalljes së pavarësisë, duke theksuar rolin jetik të qytetit të Shkodrës si një qendër e rëndësishme e prodhimit dhe e shpërndarjes së shtypit në periudhën 1913-1920. Gjatë kësaj periudhe të pasigurt historike, shtypi shqiptar luajti një rol vendimtar në përhapjen e ideve të pavarësisë dhe në konsolidimin e identitetit kombëtar.

Temat kryesore të konferencës përfshinë:

- Roli i Shkodrës si qendër e shtypit kombëtar. Kumtuesit trajtuan mënyrën se si Shkodra u shndërrua në një vatër të rëndësishme për shtypin shqiptar pas shpalljes së pavarësisë, duke pasur një ndikim të thellë në politikën dhe në kulturën kombëtare të asaj kohe.

- Botimet dhe periodikët e periudhës. U diskutuan gazeta dhe revista të njohura të kohës, të cilat shërbyen si platforma për intelektualët dhe patriotët shqiptarë, duke nxitur përhapjen e ideve kombëtare dhe duke ndihmuar në informimin e publikut për zhvillimet e kohës.
- Ndikimin e shtypit në lëvizjen kombëtare. Prezantimet vlerësuan ndikimin e shtypit në mobilizimin e shqiptarëve për çështjet kombëtare dhe për krijimin e një ndërgjegjeje kolektive për rëndësinë e mbrojtjes së pavarësisë dhe integritetit territorial të vendit.
- Sfidat dhe vështirësitë e shtypit në kohë lufte. Një tjetër aspekt i trajtuar ishte presioni dhe censura ndaj shtypit gjatë Luftës së Parë Botërore dhe përpjekjet për të mbajtur të gjallë zërin e pavarësisë nëpërmjet gazetave dhe botimeve të tjera, pavarësisht sfidave të mëdha ekonomike dhe politike.

Konferenca kontribuoi në një diskutim të thellë dhe të pasur mbi historinë e shtypit shqiptar, duke ndihmuar në ndriçimin e mëtejshëm të rëndësisë së medias si një faktor kyç në konsolidimin e shtetit të ri shqiptar pas shpalljes së pavarësisë. Ky aktivitet shërbeu gjithashtu si një platformë për të bashkuar studiues dhe ekspertë nga fusha të ndryshme, duke përçuar një vlerësim të thellë për rolin e Shkodrës dhe shtypit në historinë kombëtare.

### KONFERENCË SHKENCORE

#### “**Át Donat Kurti (1903-1983) - vjollca e letrave shqipe**”

Më 9 dhjetor 2023, Provinca Françeskane Shqiptare në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhësisë, Departamentin e Letërsisë dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike, të Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, organizuan Konferencën shkencore “**Át Donat Kurti (1903-1983) - vjollca e letrave shqipe**”. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të 120-vjetorit të lindjes së kësaj figure poliedrike.

Veprimtaria u hap nga Atë Vitor Demaj, O.F.M. Përshëndetën aktivitetin: Arqipeshkvi i Shkodrës, Imzot Angelo Massafra; Provinciali, P. Pashko Gojçaj; zëvendësrektorja e Universitetit të Shkodrës, prof. as. dr. Paulina Guli.

Konferenca i zhvilloi punimet në dy seanca paralele, të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

*Në seancën e Gjuhësisë, që u drejtua nga prof. dr. Aljula Jubani e prof. as.*

dr. Orjeta Baja, u mbajtën 10 kumtesa: **Prof. dr. Artan Haxhi – Prof. dr. Alfred Çapaliku:** *Át Donat Kurti dijëtar i Kombit*; **Prof. as. dr. Orjeta Baja – Dr. Át Vitor Demaj:** *Vëzhgime filozofiko-gjuhësore të veprës “Në rrugen e plepavet” të Át Donat Kurtit*; **Prof. dr. Aljula Jubani:** *Át Donat Kurti, martiri i “kangve në lavd të komit”*; **Prof. dr. Mimoza Priku:** *Vitaliteti etnogjuhësor përmes veprës “Në rrugen e plepavet” të Át Donat Kurtit O.F.M.*; **Prof. as. dr. Evalda Paci:** *Atë Donat Kurti O.F.M. në një dimension mjeshtëror të shqipëruesit të tekstit biblik*; **Prof. as. dr. Majlinda Bregasi:** *365 rrëfime nga viti 1977 prej një barakeje të Shkodrës. Kujtimet e Át Donat Kurtit nga perspektiva e akteve gjuhësore*; **Dr. Karmen Lazri – Dr. Zamira Shkreli:** *Pader Donat Kurti dhe terminologja gjuhësore (Sipas përkthimit nga gjermanishtja të tekstit mësimor “Gramatika latine” hartuar prej gjuhëtarit dhe filologut August Scheindler)*; **Dr. Anisa Kosteri – Doc. Bora Logu:** *Toponime dhe antroponime me vlerë në veprën e Atë Donat Kurtit*; **Dr. Erzen Koperaj:** *Gramatika e Át Donat Kurtit dhe gramatikat shqipe në dialektin gegë*; **Dr. Lisandri Kola – Phd. Kandidate Aristeja Kola:** *Mbi përgatitjen e botimit të Testamendit të Rí (Blëni I) përkthye nga Át Donat Kurti.*

*Në seancën e Letërsisë*, që u drejtua nga prof. dr. Kujtim M. Shala e prof. as. dr. Arben Prendi, u mbajtën 9 kumtesa: **Prof. dr. Sabri Hamiti:** *Át Donat Kurti simbas Át Zef Pllumit*; **Prof. dr. Kujtim M. Shala:** *Át Donat Kurti - Autori i përrallave*; **Prof. as. dr. Arben Prendi:** *Át Donat Kurti folklorist*; **Prof. dr. Ledri Kurti:** *Provinca françeskane, një udhë drejt formimit të ndërgjegjes kombëtare dhe dijes së një kombi (II) përmes kontributit studimor e dëshmuës të Át Donat Kurtit*; **Prof. as. dr. Arbnora Dushi:** *Krahasime mbi praktikën e regjistrimit dhe të botimit të këngëve epike: Palaj-Kurti dhe Elias Lönnrot*; **Prof. as. dr. Edmond Malaj:** *Historia e Provincës Françeskane Shqiptare nën dritën e hulumtimeve të Át Donat Kurtit*; **Dr. Ermira Aliaj:** *Elemente impaktesh kërkimesh shkencore që mundëson vepra e Át Donat Kurtit*; **Dr. Isida Hoxha:** *Publicisti Kurti mes kolonave të shtypit dhe të kulturës*; **Ma. Ndue Ukaj:** *“Kangtari i dashtnis” i Át Donat Kurtit. Poezia si etikë dhe estetikë.*

Në fillim të aktivitetit, në Bibliotekën “Át Gjergj Fishta”, u promovuan 7 vepra të Atë Donat Kurtit, dorëshkrimet e të cilave u ekspozuan për publikun në një ekspozitë që qëndroi e hapur 9 – 16 dhjetor 2023

### KONFERENCA NDËRKOMBËTARE

#### *"Pikëtakime kulturore në arealin ballkanik"*

Më datë 11 dhjetor 2023, në Bibliotekën Shkencore të Universitetit të



Shkodrës “Luigj Gurakuqi” u mbledhën bashkë studiues të Ballkanit Perëndimor në Konferencën Ndërkombëtare *"Pikëtakime kulturore në arealin ballkanik"*. Tematikat kryesore që u trajtuan ishin nga: kultura si ndërmjetësim dhe urë zhvillimi në Ballkanin Perëndimor; etnogjuhësia dhe debati shkencor rreth saj; historia e panjohur e rrugës së famshme Skadarlija në Beograd; mundësitë për të integruar lokalen tek diskursi i gjerë i integritit rajonal etj.

Rektorja e Universitetit të Shkodrës, prof. dr. Rajmonda Këçira, përshëndeti të pranishmit dhe përgëzoi organizatorët e kësaj konference: Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakultetin e Shkencave Shoqërore, Departamentin e Gjuhësisë, Departamentin e Letërsisë, në bashkëpunim me Fakultetin Filologjik të Universitetit të Beogradit dhe Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës.

### **TAKIM INFORMUES RRETH PROJEKTIT**

#### ***"Edukimi është çelësi i suksesit"***

Më 16 tetor 2023, në ambientet e Bibliotekës Shkencore të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” u organizua takimi informues rreth projektit *"Edukimi është çelësi i suksesit"*. Projekti është një bashkëfinancim i MAS dhe USH në lidhje me politikën e ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë. Përfitues të projektit janë studentët, stafi akademik dhe ai administrativ i USH-së, si dhe i gjithë komuniteti i kërkuesve shkencorë të rajonit. Projekti është hartuar nga Departamenti i Historisë në kuadër të finalizimit të programit të ri të përbashkët të studimit "Trashëgimi kulturore" që do të fillojë vitin e ardhshëm akademik. Ky program studimi është një diplomë e dyfishhtë nga dy universitete: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe Universiteti i Salentos, Itali.

### **SEMINARI ME TITULL**

#### ***"Xhubleta midis së shkuarës dhe së ardhmes"***

Më 14 dhjetor 2023, në Auditorin A3 të Universitetit, u organizua seminari me titull: "Xhubleta midis së shkuarës dhe së ardhmes" projekt i AICS Tirana, në bashkëpunim me IKR-në (Instituti i Kërkimeve Rurale) dhe Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Në këtë seminar, në të cilin u kërkua të sensibilizohet opinioni publik e ai shkencor kombëtar e ndërkombëtar për një vlerë unike, siç është xhubleta, Departamenti i Historisë u përfaqësua me një kumtesë të prof. dr. Nertila Ljarja.

**AKTIVITETI*****“Ekspeditat mësimore gjatë viteve”***

Më 22. 12. 2023, në Bibliotekën Shkencore të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Departamenti i Historisë organizoi aktivitetin me titull “Ekspeditat mësimore gjatë viteve” në formën e ekspozitës me foto dhe video të realizuara gjatë zhvillimit të ekspeditave mësimore.

Praktika mësimore në terren ka qenë një pjesë e pandashme e procesit dhe e programeve mësimore “Histori” dhe së fundi “Histori dhe trashëgimi kulturore”, të realizuara nga Departamenti i Historisë. Pedagogët e departamentit të Historisë, prof. dr. Nertila Ljarja, dr. Bendis Kraja dhe dokt. Anelmo Spahija, kumtuan rreth rëndësisë që ka ky aspekt në formimin e studentëve të programeve tona.

**TAKIMI STUDENTOR*****"Trashëgimia jonë kulturore, mbrojmë të kaluarën për të ardhmen.  
Xhubleta në UNESCO"***

Më 20 dhjetor 2023, në Bibliotekën Shkencore të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” u zhvillua takimi studentor *"Trashëgimia jonë kulturore, mbrojmë të kaluarën për të ardhmen. Xhubleta në UNESCO"* me studentët e programeve të studimit që mbulon Departamenti i Historisë.

Ky takim kishte në fokus një nga objektet më të rëndësishme të trashëgimisë sonë kulturore. Në qendër të takimit ishte biseda me studiuesen Rita Shkurtaç Kalaj, e cila u fokusua në rëndësinë e ruajtjes së identitetit të xhubletës.

**AKTIVITET MBI PLATFORMËN ONLINE*****"VisitShkodër"***

Më 29 prill 2024, në ambientet e Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” u zhvillua aktiviteti i përbashkët në mes të studentëve që ndjekin programet e studimit, të cilat i mbulojnë Departamenti i Informatikës dhe ai i Historisë.

"VisitShkodër" është një platformë online e ideuar për zhvillimin dhe informimin digjital për Rajonin e Shkodrës. Kjo faqe ka si synim prezantimin e territorit të Shkodrës, si nga ana kulturore dhe turistike, ashtu edhe nga ana e shërbimeve dhe e aktiviteteve që ofrohen.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte që me anë të punimeve të përbashkëta të realizuara në projekte që lidhen me trashëgiminë kulturore, të nxitet një përjasje ndërdisiplinore. Studentët mund të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të integrojnë aftësitë e tyre me ato të disiplinave të ndryshme.

### **PROMOVIMI I LIBRIT** *“Ora e Kosovës”*

Më 24 prill 2024, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore si bashkorganizues zhvilluan promovimin e librit “Ora e Kosovës” me autor prof. dr. Fatmir Sejdiu. Për rëndësinë e këtij botimi, mes të tjerëve, foli në këtë aktivitet prof. dr. Nertila (Haxhia) Ljarja. Në fund të takimit përshëndeti dhe shprehu falënderimet e tij të përzemërta, autori i librit, prof. dr. Fatmir Sejdiu.

### **KONFERENCA STUDENTORE**

#### *“Gjeografia për të gjithë”*

Në kuadrin e javës së Ditës së Tokës, më 25 prill 2024, në Bibliotekën Shkencore të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi, Departamenti i Gjeografisë organizoi një konferencë studentore dhe një workshop me tematikë nga fusha e gjeografisë.

1. **Konferenca Studentore** - U prezantuan tema nga studentë mbi aspekte të ndryshme të gjeografisë dhe të turizmit, duke përfshirë:
  - Lugina e Valbonës dhe vlerat e trashëgimisë natyrore;
  - Hartografimi i resurseve turistike për Bashkinë Lezhë;
  - Marrëdhëniet ndërkufitare Shqipëri-Mali i Zi dhe zhvillimi i turizmit;
  - Aspektet e hartës së parë të Shqipërisë me toponimastikë në gjuhën shqipe;
  - Vlerat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Bashkinë Shkodër;
  - Rreziqet natyrore në Bashkinë Lezhë.

2. **Workshop:** me pjesëmarrjen e gjerë të mësuesve të lëndës së gjeografisë, në këtë workshop u diskutua roli i disiplinës së gjeografisë në kurrikulat arsimore, me prezantime nga akademikë dhe pedagogë, me tematikë, si:

- Struktura e programeve të Departamentit të Gjeografisë;
- Rëndësia e gjeografisë si shkencë multidisiplinare;
- Sfidat për mësuesit e gjeografisë në përshtatjen me kurrikulat mësimore në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë.

### PROMOVIMI I VEPRAVE

#### *“Odeon” dhe “Kolë Thaçi – shtetari poet”*

Më 31 maj 2024, Universiteti i Shkodrës organizoi një aktivitet të veçantë kushtuar promovimit të dy veprave me rëndësi të madhe për kulturën dhe letërsinë shqiptare: **“Odeon”** nga prof. dr. Alfred Çapaliku dhe **“Kolë Thaçi – shtetari poet”**. Kjo ngjarje ishte rezultat i një bashkëpunimi frytdhënës ndërmjet Fakultetit të Shkencave Shoqërore (FSHSH), Fakultetit Ekonomik (FE), dhe Fakultetit të Drejtësisë (FD), në partneritet me Qendrën e Studimeve Albanologjike (QSA), e cila luajti një rol kyç në realizimin e këtij projekti.

Aktiviteti nderoi figurën shumëdimensionale të Kolë Thaçit, një personalitet i shquar si shtetar dhe poet, si dhe kontributin letrar të prof. dr. Alfred Çapalikut, një prej studiuesve dhe krijuesve të njohur të letrave shqipe.

Përmes këtyre dy veprave, *“Kolë Thaçi shtetari poet”* dhe *“Odeon”*, u pasqyrua puna e palodhur dhe angazhimi për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore shqiptare, gjithashtu u vu në pah punëtorja e frytshme e prof. dr. Alfred Çapalikut, i cili na paraqitet gjithnjë me vlera e kontribute të veçanta në fushë të letërsisë.

QSA u bë pikë takimi për bashkëpunimin mes fakulteteve dhe përçoi vlerat e larta akademike e kulturore përmes një pune të përbashkët.


Në këtë promovim u falënderuan të gjithë kolegët dhe bashkëpunëtorët që kontribuan në realizimin e këtij aktiviteti, si dhe Universiteti i Shkodrës për mbështetjen e vazhdueshme në promovimin e punës shkencore të kërkuesve dhe të studiuesve. Universiteti mbetet një përkrahës i fortë i dijes dhe i kulturës shqiptare, duke nxitur zhvillimin e kërkimeve që pasurojnë

trashëgiminë tonë kombëtare.


Ky aktivitet synoi të ishte një frymëzim për studiuesit, studentët dhe dashamirësit e kulturës shqiptare, duke sjellë në vëmendje rëndësinë e ruajtjes dhe të pasurimit të trashëgimisë sonë përmes studimeve dhe botimeve që reflektojnë identitetin tonë kombëtar.

### B O T I M E


1. **Prof. dr. Alfred Çapaliku, Prof. dr. Blerta Dragusha, Prof. as. dr. Elidiana Bashi, Dr. Ermira Alija, Prof. as. dr. Florian Bjanku, Dr. Isida Hoxha, Dr. Yllka Rupa, *Kolë Thaçi - Shtetari poet*, Monografi, Shkodër, 2024, 234 f.**



2. **Prof. dr. Alfred Çapaliku, *Odeon*, Studime letrare, Shkodër, 2024, 167 f.**



3. **Prof. dr. Tefë Topalli**, *Krestomaci e Albanologjisë I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022, 1668 f.



4. **Messina G, Kopliku Bresena, Libër** – (2024) *21-st Century landscape sustainability, development and transformations: geographical perceptions* <https://iris.unime.it/handle/11570/3301029>



**GRADA DHE TIUTJ TË FITUAR GJATË VITIT 2023-2024**

**Zamira Shkreli** fiton titullin “Profesor i asociuar”, me vendim nr. 275, të datës 30. 01. 2024 të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të Universitetit të Tiranës.

**Bresena Koplaku** fiton titullin “Profesor i asociuar”, me Vendim nr. 340, të datës 25. 03. 2024 të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të Universitetit të Tiranës.

**ISSN 2221 – 6855**

*Doli nga shtypi dhjetor, 2024 – tirazhi 120 kopje – Formati 176 x 250 mm.  
Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës  
“Luigj Gurakuqi”*